

LEFTER DILO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

949.65

050

**DRITË
QË
ÇANTE
ERRËSIRËN**



949.65

850.

LEFTER DILO

**DRITË
QË ÇANTE
ERRËSIRËN**



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

PARATHËNIE

E pandërprerë mbeti lufta e popullit tonë nëpër dekada e nëpër shekuj me armë e me penë. Edhe në mërgim ku u vendosën, punuan e u munduan pa pushim për Atdheun e robëruar patriotët tanë; hodhën themelet e para të shoqërive, të klubeve patriotike, të gazetave të para nëpër kontinente. Flasin vetë titujt e shoqërive, apo titujt e gazetave, që nga «Shqypeja e Shqypnies», «Drita» e gjer të «Shkopi», «Sopata» e të «Rrufeja» etj.

Nën ndikimin e këtyre klubeve dhe shoqërive dhe nga puna dhe lufta këmbëngulëse e masave popullore dhe e elementeve patriotë e përparimtarë brenda vendit, të cilët pa marrë parasysh rreziqet që u kanoseshin, në kushte tepër të vështira të pushtuesit osman dhe shovinistëve fqinj, si në shumë krahina të Atdheut edhe në Gjirokastrë u ngritën shkollë, shoqëri, klube, lidhje e rrethe letrare, me synim t'i dilnin zot mëmëdheut, shkollës shqipe, kulturës shqiptare, që t'i ringjallnin atë dhe t'i zhvillonin më tej, për ta çuar ndërgjegjen kombëtare në një shkallë më të lartë.

Këto klube, shoqëri, shkollë e lidhje nuk i ngritën në këmbë paraja e parësisë, por thërrimet e mu-

ndi i vegjëlisë, i patriotëve tanë brenda e jashtë Shqipërisë, i çetave kryengritëse, që luftonin me armë në dorë për ta bërë Shqipërinë të lirë e të pavarur, që siç thotë shoku Enver Hoxha «qenë në të njëjtën kohë pasurim dhe zhvillim i mëtejshëm sasior e cilësor i gjithë veprimtarisë së mëparshme të të parëve tanë të lavdishëm»¹). Klubet e shoqëritë që ishin vatër përpjekjesh patriotike në ndeshjet e ashpra me armiqtë e brendshëm e të jashtëm dijtën të qëndronin trimërisht. Klubet e shkollat shqipe patriotët tanë i kishin vendosur t'i mbanin vetë, të pastërta, luftarake me karakter thjesht patriotik. Ata bëjnë thirrje të veçanta për këtë qëllim duke shkruar «se donin të zbukuronin e të lulëzonin vendin e bukur me dituri»²).

Klubet e Gjirokastrës, dhe shoqëritë e saj, tok me ato të Tepelenës, Delvinës, Përmetit, të Progona-tit dhe të të gjithë vendit bënë përpjekje të parresh-tura kundër synimeve të armiqve, në një kohë kur mësuesit e patriotët e parë punonin jo vetëm për tea-trin, por edhe për muzikën, edhe për bandat e para. Ndërsa në Gjirokastrë nuk u lejua një bandë e tillë muzikore, në Vlorë qeveritarët turq kishin urdhëruar të mos dëgjohesh këngë shqipe³), të mbyllesh gjith-ashtu «Lokali i Llambi Kafexhiut, sepse aty këndo-heshin këngë shqip»⁴), në Korçë në shtator 1909 go-

1) Nga përshëndetja e shokut Enver Hoxha e 24 majit drejtuar popullit të Gjirokastrës, «Zëri i Popullit», datë 25 maj 1977.

2) Gazeta «Bashkimi i Kombit», Manastir, 14 Kollozhek 1910.

3) «Shqypeja e Shqypnisë», 27 shtator 1910.

4) «Liri e Shqipërisë», 9 shtator 1911.

diteshin me thikë «djemtë e bandës së Lirisë».

Ndriqeshin e persekutoheshin themelues shkolash e klubesh si Kadri Gjata, Nuçi Naçi, Andrea Konomi etj. Por këta e vazhduan me ngulm punën dhe veprimtarinë e tyre në fund.

Po kështu vepruan armiqtë edhe kundër patriotëve të Gjirokastrës dhe ish-qarkut të saj edhe në vitet e mëvonshme, kundër demokratit revolucionar Avni Rustemi, i cili është iniciator i disa shoqërive dhe klubëve.

Kundër veprimtarisë së tij dhe të bashkëpunëtorëve të këtij revolucionari u ngritën feudalët reaksionarë turkomanë, duke i cilësuar «të dëmshëm e të rrezikshëm klubet, si shkaktarë gjithashtu të prishjes së perandorisë turke»¹).

Me vendosjen e diktaturës së Zogut, në dhjetor të vitit 1924, si kudo në vendin tonë, edhe në Gjirokastrë u mbyllën edhe shoqëritë, po kështu edhe klubet demokratike. Megjithatë prushi mbeti i ndezur dhe afshi i tij nuk mund të shuhej megjithë shtypjen e egër, të regjimit antipopullor.

1) AQRPSSH - Fondi i Kryeministrisë Nr. 99/16 dt. 10.X.1921.

KLUBET — VATRA TË ZJARRTA PATRIOTIKE

Për çlirimin e vendit, për lirinë, pavarësinë dhe diturinë punuan parreshtur patriotët tanë, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Emrin «Drita» i dhanë ata revisitet së vitit 1884 në Stamboll, një nga bashkëpunëtorët e së cilës ishte edhe patrioti nga Selcka e Gjirokastrës, Pandeli Sotiri. «Drita» e quajtën ata klubin e tyre të parë të «Bashkimit të Gjirokastrës», në nëntor 1908; «Drita» emëruan shkollën qendrore fillore të vitit 1917; «Drita» e quajtën gazetën demokratike të viteve 1920-1924. Po me këtë emër quhej edhe shoqëria e tyre e themeluar nga të mërguarit gjirokastritë në SHBA, «Drita» e emëruan gjithashtu patriotët gjirokastritë shoqërinë arsimore kulturore të Gjirokastrës, të dhjetorit 1920, ku punoi Avni Rustemi me shokë.

Për t'ju kundërvënë klubit politik «Drita» që u formua më 5 nëntor 1908, e që drejtohej nga Hysen Hoxha, armiqtë ngritën dy klube të tjerë, atë të xhonturqve, dhe atë të shovinistëve grekë.

Veprimtaria patriotike e klubit «Drita» i verbonte pushtuesit dhe veglat e tyre.

Në mars të vitit 1909 prefekti i Gjirokastrës, shkoi për të parë gjoja mësimoren «Liria» dhe klubin «Drita», të dy në një godinë përdhese. Klubi

kishte simbol të vetin midis të tjerave edhe dy shqiponja të pirografuara, me ngjyra të bukura, në një copë të kuqe.

Andrea Konomi shkruante midis të tjerash në një letër se ndërsa kryetari i klubit qëndronte poshtë simbolit, asnjëherë prefekti nuk guxoi të rrinte përballë tij, «se kjo shenjë veçse shqiptarët gëzon, të tjerët i helmon, i handakos, i fundos në det të zi, po të hedhin sytë mbi të. Simboli do t'i mbjellë oftikën këtij prefekti të egër»¹⁾. Ai shkruante gjithashtu se xhonturqit nuk janë veçse turqit e vjetër, se «klyshi i bardhë dhe klyshi i zi janë po bijtë e bushtrës»²⁾.

Klubi «Drita» e filloi punën si një qendër kulturore-arsimore për të grumbulluar në një organizatë demokratike shtresa të ndryshme që të punonin njëkohësisht edhe për mësimoret e para shqipe, në qytet, në rreth dhe në qarkun e Gjirokastrës. Njëpër njëpër klubit «Bashkimi» të Manastirit, më 5 gusht 1908, vijnë në vendin tonë mbi 2000 libra shqip nga Bukureshti.

Klubi «Drita» i Gjirokastrës u drejtua në fillim nga Petro Poga, ndërsa nga viti 1909-1913 nga Hysen Hoxha, anëtar i vjetër i «Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare». Sekretari i klubit dhe anëtar i pleqësisë ishte mësuesi Thoma Papapano. Anëtarë të tjerë ishin patriotët Idriz Guri, Elmaz Bocja, Veli Hashorva. Selami Vehbiu, Sali Bixho, Shemsho Hajro etj.

1) AQRPSSH Fondi Jani Vruho. Letër dt. 19.2.1909, nr. 50.108.

2) AQRPSSH — Fondi J. Vruho, dt. 19.2.1909, nr 50, 106.



Simboli i klubit «Drita» (1908-1913)

Klubin «Drita» dhe shkollën e mbajtën shtresat dhe vegjëlja e qytetit, intelektualët përparimtarë, ndërsa «kadilerët e Gjirokastrës — siç shkruan një anëtar i klubit — që kishin trastat plot me flori, gjer sot s'kanë ndihmuar fare». Megjithatë, klubi së bashku me shkollën u mbajtën pa ndihmën e tyre.

Klubi «Drita» kishte edhe kantonizmin (statutin) e tij, ku përcaktoheshin qartë pikësynimet që ai kishte, për të hapur mësonjëtoje në fshatra e në qytet, për të zhvilluar folklorin popullor, për të shkruar mu-

zikën e vendit, për të pastruar gjuhën shqipe nga fjalët e huaja etj.

Lidhur me anëtarësinë në klub thuhej që «për t'u bërë shok i plotë në klub, anëtari duhet të jetë 20 vjeç, nga çdo komb e nga çdo fe, vetëm të jetë njeri i ndershëm»¹⁾.

Në këtë kanonizëm bëhej fjalë për bibliotekën e klubit, për përtëritjen e pleqësisë që do të bëhej me vota të fshehta, se anëtarët e klubit ishin të barabartë, se përpara tij të drejtat i kishin të njëjta etj.

Me përkrahjen e këtij klubi, me 4 prill 1910, u çel shkolla shqipe në Labovën e Madhe. Të tjera shkolla u hapën në Libohovë, Dëshnicë, Përmet, Hotovë, Kuqar, Tepelenë, etj.²⁾

Anëtarët e tij përballonin me trimëri kërcënimet dhe provokacionet e klubit të xhonturqve, ose më mirë «të klubit të kumarxhinjve», si e quante atë populli me përbuzje.

Armiqtë arritën gjersa të ngrenë dorën dhe të vrasin patriotë si Kadri Gjata (Kumbaro), kryetar i klubit patriotik e luftarak të Janinës, më 12 korrik 1912, duke e kryer këtë vrasje me dorën e tradhtarit Jani Puteci, komandant i çetave të andarteve, agjent i shovinistëve grekë³⁾, dënuar nga vetë populli me vargjet e tij⁴⁾.

1) Kanonizma e klubit «Drita», faqe 5.

2) Fondi QKMGJ. Dosja nr. 2.

3) Gazeta «Drita», 9 gusht 1912. Artikull nga Muço Qulli, publicist patriot nga Leskoviku.

4) Rapsodi popullor e stigmatizon tradhtarin me vargjet: O Putec, o qen i zi / Ka trima në Shqipëri / që për njëzet e dy / të përvëlojnë si mi.

Pas vrasjes së patriotit Kadri Gjata, pleqësia e klubit «Drita» të Gjirokastrës mori masa për mbrojtjen e jetës së Hysen Hoxhës të Thoma Papapanos¹⁾ dhe të aktivistëve të tjerë, që kërcënoheshin prej pushtuesit dhe sahanlëpirësve të tyre, prej tradhtarëve.

Kjo manifestohej, sidomos, në mbrojtjen që u bënte populli i Gjirokastrës patriotëve të këtij rrethi. Këmbëngulëse dhe energjike ka qenë mbrojtja, që i ka bërë klubi alfabetit të gjuhës shqipe me shkronja latine, duke luftuar ata më fanatikët, që kërkonin alfabetin me shkronja turko-arabe. Klubi «Drita» mbrojti anëtarët e vet, që goditeshin si heretikë nga reaksioni, për shkak se punonin për shkollat shqipe dhe për shkronjat latine.

Klubi bëhet gjithashtu organizuesi i teatrit shqip, duke dhënë shfaqjen e parë më 23 shtator 1909, aq sa një gazetë e Korçës, duke botuar një korrespondencë nga Gjirokastra, tregon se megjithëse natën e parë që u dha shfaqja ra zjarr në një shtëpi në lagjen Pallorto, përsëri pak veta e lanë atë shfaqje përgjysmë²⁾. Një zjarr i brendshëm, një etje për teatër, për dituri i mbante ata të mbërthyer në vënd, me sytë të skena, të ulur në sheshin para mësimores «Liria» (sot shehi i Obeliskut).

Shfaqje teatrale u dhanë në Delvinë dhe në Janinë, nga patriotë që punonin në këto qytete, nga studentë që vijonin mësim, etj.

Në shtator 1909, klubi «Drita» i Gjirokastrës dërgon përfaqësuesit e vet Thoma Papapanon dhe Andrea Konomin në Kongresin e Elbasanit, ku u

1) Kujtime nga Mësuesi i Popullit Thoma Papapano.

2) Gazeta «Korça». Korçë, 15 vjeshtë e dytë 1909.

morën vendime të rëndësishme për shkollat, për kulturën kombëtare, për të ardhmen e vendit tonë.

Klubi «Drita» u bë një qendër e rëndësishme për edukimin patriotik të rinisë së asaj kohe.

Pushtimi grek i Gjirokastrës më 16 mars 1913, ndërpret veprimtarinë legale të klubit, por nuk ndërpritet veprimtaria e fshehtë patriotike të popullit dhe të patriotëve.

Veprën e këtyre patriotëve e shikojmë në ngri-tjen e shoqërisë patriotike «Vëllazëria», më 23 nën-tor 1919; në prag të Kongresit të Lushnjës, të Luftës së Vlorës, etj. Përveç kësaj 260 anëtarët e klubit «Drita» do të vazhdojnë të përpiqen për gjuhën, për kulturën kombëtare dhe fjala e tyre do të përhapet e do të lerë gjurma të pashlyeshme në masat e po-pullit të qytetit të Gjirokastrës në këtë periudhë të vështirë. Prandaj edhe anëtarët e këtij klubi fi-tuan simpatinë e qytetarëve.

Klubi i Gjirokastrës në veprim të përbashkët me klubin «Toskëria» të Tepelenës, me atë të Lesko-vikut, Filatit, Libohovës etj. punoi në fushën politike, kulturore, arsimore, teatrale, duke synuar kudo të goditen klubet e turqve të rinj. Ata u bënë vatra të zjarrta për përhapjen e mësimi të gjuhës shqipe dhe të kulturës kombëtare.

Klubi i Filatit, p.sh. me anë të një letre që mban datën 12 shkurt 1909, kërkon udhëzime nga klubi qendror i Manastirit për gjendjen e krijuar në Konispol e në Delvinë, për ndjekjet e bëra nga au-toritetet turke dhe nga shovinistët grekë. Si përgjigje për këtë relacion, klubi i Manastirit njoftonte në më-nyrë të prerë «se meqë u kishte ardhur thika në koc-

kë, patriotët shqiptarë me armë në dorë, duhej të mbronin të drejtat dhe nderin e tyre»¹⁾).

Kontribut të çmuar për forcimin e klubeve të Konispolit e të Delvinës dha organizatori i çetave kryengritëse, patrioti Namik Delvina, i cili i gjallëroi ato, i bëri vatra të kulturës sonë, qendra për organizimin e shfaqjeve të para teatrale etj. Në klubin e Filatit, Ninatit, Koskës, Janjarit etj. zhvilloheshin edhe mësimet. Kështu ato ishin kthyer në shkolla shqipe.

Klubi i Filatit punonte edhe me ushtarët shqiptarë, që ishin thirrur nën armë. Më 9 mars 1910, 160 veta, nën ndikimin e tij politik dezertojnë nga radhët e ushtrisë turke dhe këta të gjithë me dyfek në dorë zunë zyrat e telegrafës dhe u lidhën me Myfit bej Libohovën, deputetin e Gjirokastrës. Au u dha ushtarëve patriotë këtë përgjigje: «që të presin dhe të rrinë urtë»²⁾. Por kjo përgjigje nuk i qetësoi ushtarët. Ata i njihnin mirë këta sahanlëpirës që i shërbenin pushtuesit. Myfit bej Libohovë dhe shokët e tij gjithnjë predikonin durimin. «Prisni, prisni, thonin, do të vijë koha kur ne do të veprojmë»³⁾. Duke mos u mashtruar nga taktika djallëzore e bejlerëve të shitur, këta ushtarë shqiptarë sulmuan turqit, duke plagosur 9 prej tyre⁴⁾.

«Kjo ishte përgjigjja që populli ynë u jepte turqve të rinj» — thuhet në këtë dokument⁵⁾.

Përparimi i këtij klubi vlerësohet edhe nga

1) Fondi QKMGJ.

2) Fondi QKMGJ. Kujtime të Musa Demit, fq. 7.

3) Po aty.

4) Po aty.

5) Fondi QKMGJ.

diplomatët e huaj që ishin akredituar në Janinë. Njëri prej tyre dr. Ranxi, shkruante në një raport dërguar qeverisë së tij, se «klubi «Drita» ka filluar jetë të re dhe sot ai ka më tepër anëtarë se çdo tjetër, si myslimanë, ashtu dhe të krishterë, se klubi grek ka pësuar një krizë që me dorëheqjen e kryetarit të tij»¹⁾.



Klubi «Bashkimi»

1) Fondi QKMGJ.

KLUBI NË PROGONAT

U ÇELI LONË KETU KLUBI "ARBERIA" NJË LULË I
SËMËR NË MËS-TË KOPËSHIT KOMBËTAR, I PËN-
SHËMBËTUR NGA DASA-PROGONATAS. BE NGA
SULIT ME KETA FJALE:

GEZUREMI PËR ÇELJEN E KLUBIT "ARBE-
RIA" DHE THËRRËSIM "ARËETE GJITHA-
SHOPIË ME SHKRIMIN KOMBËTAR

ZQJNA BOKORËRISË

Klubi në Progonat

Përpjekje për ngritje të një klubi politik u bënë edhe në Leskovik me interesimin e popullit të qytetit. Puna e bërë bie në sy të armiqve, të turqve të rinj, të bejlerëve, të cilët ndërhyjnë me nxitjen e shovinistëve grekë, për ta mbyllur atë. Ishin bejlerët e Leskovikut, të cilët duke patur çifligje e interesa të tjera në Greqi, për të mos prishur lidhjet e mira qeveritare greke, ndërhyjnë dhe e mbyllën¹⁾.

Kjo masë shkaktoi hidhërimin e përgjithshëm të popullit të atij qyteti, që ngriti zërin kundër agjentit të turqve të rinj, Arif Hiqmetit, i cili

1) Gazeta «Besa», nr. 11. Stamboll 26 janar 1909.

i luftoi me tërbim klubet dhe shkollat tona. Me urrejtje e shikoi këtë fytyrë populli ynë, me urrejtje shkroi edhe kur ai vdiq në korrik 1914. Një publicist shqiptar shkroi për të: «Ngordhi Arif Hiqmeti në Shkup, pas një operacioni»¹⁾.

Janina ishte një qendër e përpjekjeve për gjuhën amtare, për kulturën, teatrin shqip etj. Qysh në shtator 1908 zhvillohet një mbledhje e gjerë në Janinë me Kadri Gjatën, Bajo Topullin për themelimin e një «shoqërie shqiptare», aq sa kronisti patriot shkruante se «nuk ishte parë ndonjë herë një punë kombiare e tillë»²⁾ Këtu foli për gjuhë e dituri Bajo Topulli, i cili «përcaktoi gjendjen e Shqipërisë dhe nevojën e madhe që ka kjo për lulëzimin e gjuhës, t'asaj gjuhe q'është sot si një lule e bukur në mes të ferravet!»³⁾.

1) «Liri e Shqipërisë». Sofje, 31 korrik 1914.

2) Liria». 11 vjeshtë e dytë 1908, fq. 2.

3) Po. aty.

MËSIMORJA SHQIPE «LIRIA»


Ashtu si në të gjithë vendin tonë edhe në krahinën e Gjirokastrës, në periudhën e errët mesjetare të pushtimit osman, patriotët punuan e luftuan me pushkë e me penë për të hapur shkollat shqipe.

I tillë është patrioti Vangjel Meksi, i cili që në vitin 1818, në ato kushte aq të rënda kishte hartuar një gramatikë shqip, njëkohësisht kishte përcaktuar një alfabet dhe një drejtshkrim të saj, që krahas shkronjave greke, në përkthime përdori edhe shkronjat latine. Këtë vepër albanologët e vjetër e cilësojnë si «një minierë të çmueshme për punimet gramatikore të Ksilanderit e të Hahn-it»¹⁾.

Po kështu në periudha të tjera punuan vëllezërit Anastas e Spiro Çelo, Abdulla Konispoli, Muhamet Kuçuku e të tjerë gjirokastritë, që e shkruanin gjuhën amtare me shkronja arabe ose latine, por me fjalë shqipe. Janë Vaja, më 1862 hartoi një fjalor më tri gjuhë, me shkronja latine.

Nga viti 1870, pesë alfabetë janë përdorur vetëm në ish-qarkun e Gjirokastrës, ai i Hormoves, i Vangjel Meksit, i Labovës së Madhe, i Haçan Tahsinit, i cili thoshte se «Shqiptarët janë një komb

1) Xhevat Lloshi. «Studime filologjike» nr. 4, Tiranë 1973.



i veçantë¹⁾, prandaj duhet të ketë gjuhën e tyre, si dhe alfabeti i Nikolla Çakos, i cili qysh më 1879 shkruante poezi luftarake patriotike me vlerë.

Të frymëzuar nga këto përpjekje, gjirokastritët ashtu si gjithë populli ynë i shikonin me urrejtje të thellë shkollat turke, ku nxënësit detyroheshin «të qëndronin nëpër postiqe ose mindere të ndyra, ku në krye të dhomës së mësimit ishin disa shkopinj e fellakaja, veglat e vetme të edukatës turke», sikurse shkruan Abdyl Frashëri në një studim për arsimin gjatë sundimit otoman, duke shtuar «se radhët prej dërrase ku qëndronin djemtë ishin formuar nga mbeturinat e varkës së Noes»²⁾.

Populli gjirokastrit qysh në vitin 1832 ka kërkuar shkolla, sikurse tregohet në raportin e një konsulli, i cili shkruan se «Ndonëse shqiptarët janë një popull pa libra e pa shkollë në gjuhën amtare, megjithatë nuk përjashtohet që ata të ngrihen për shkolla shqipe»³⁾.

Në fakt ata ishin ngritur dhe do të vazhdonin të ngriheshin. Një nga këta ishte edhe Koto Hoxhi nga Qestorati. Si pjesëtar aktiv i Shoqërisë së Stambollit, dhe si pionier i arsimit kombëtar, dhe luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ai u ngrit kundër institucioneve fetare, kundër qeverisë osmane, kundër «sillogut kulturor epirot», të vitit 1871, kundër peshkopit Anthimi të Gjirokastrës dhe armiqve të tjerë të kombit shqiptar e të gjuhës shqipe.

Koto Hoxhi kishte shkuar që i ri në Stamboll,

1) Gazeta «Iris». Bukuresht, 10 dhjetor 1879.

2) QKM. Gjirokastrë.

3) Po aty.

ku aty me patriotë të tjerë shqiptarë, nisi të punonte pa u lodhur për çështjen kombëtare shqiptare. Ai bën përpjekjet e para për të hapur një shkollë shqipe në Gjirokastrë dhe bile hyri gjer në burgun e kalasë së Gjirokastrës, për të përhapur shqipen tek të burgosurit. Mbante lidhje të ngushta me Thimi Markon në Korçë, me patriotë të Egjiptit, Stambollit, Manastirit, që përpiqeshin për kombin dhe gjuhën shqipe.

Përpjekjet e tij për të hapur një shkollë shqipe në Gjirokastrë i vërteton mësuesi Thoma Papapano në kujtimet e veta, si dhe shtypi lokal më vonë.

Thoma Papapano shkruan se «Koto Hoxhi kishte përgatitur edhe vulën e shkollës; një shqiponjë dykrenare, ku poshtë saj ishin gdhendur fjalët: «Shkollë popullore»¹⁾. Por këto përpjekje nuk patën sukses dhe shkolla e porsahapur u mbyll sepse lufta e pushtuesve turq dhe armiqve të tjerë ishte e madhe.

Megjithatë Koto Hoxhi vijoi të punojë si mësues shetitës në qarkun e Gjirokastrës. Ai ishte mësuesi i Petro Nini Luarasit, i cili vijonte mësimet në normalen e Qestoratit.

Në një letër dërguar Mihal Haritoş në Nivan të Zagorisë Kotoja shkruante: «Na bie barra të kemi skoli (shkolla); kur nuk kemi fletë (zhurnal). Kemi lidhur fjalën për një skoli shqip, kam bërë gatitje, ... mëmëdhetarët e këtushëm e korçarët na ndihim...»²⁾.

Për këtë qëndrim të vendosur, patrioti Koto Hoxhi burgoset, në fillim në burgun e kështjellës së Gjirokastrës dhe më vonë në atë të Shtatë Kullave

1) QKM. Gjirokastrë.

2) QKM Gjirokastrë.

të Stambollit. Për veprimtarinë e tij patriotike shumëvjeçare, populli e ka përjetësuar në vargjet e veta me epitetet më të goditura.

Dy vjet pas vdekjes së Koto Hoxhit nga vuajtjet e burgjeve, më 1897 bëhen përpjekjet e tjera për një shkollë shqipe në Gjirokastrë. Nga një letër e Jani Vretos, që mban datën 12 prill 1897, dërguar Spiro Dines nga Bukureshti në Egjipt thuhet: «Informohemi se kërkuan ndë Argjirokastrë shkollë shqipe, po nuk u dha...»¹⁾.

Kalojnë rreth tetë vjet kur në Gjirokastrë, në lagjen «Dunavat», brenda në një shkollë në gjuhën turke, mësuesi patriot Mesud Çami çel një shkollë klandestine shqipe, për të cilën kronika e amzës shkruan midis të tjerave: «Meriton të përmendetë me mirënjohësi e me respekt ish-mësuesi i asaj kohe, z. Mesud Çami, i cili gjer më 1908, para lirisë tyrke, e kishte bërë shkollën një vatër atdhetarizmi, ku u mësonte, jo vetëm nxënësve të rritur të shkollës fshehurazi gjuhën shqipe, por edhe të tjerët nga jashtë merrnin mësim, libra e gazeta prej tij»²⁾. Kjo shkollë, sipas dokumentit është e vitit 1905³⁾. Përpjekje të mëdha bëhen qysh në fillimin e vitit 1908 për një vatër të re, për një mësimore sikurse do të jetë ajo me emrin «Liria». Në këtë periudhë në Gjirokastrë kishte ardhur Andrea Konomi, i dërguar nga patriotët e Egjiptit, në fillim si mësues i frëngjishtes, në gjysmëgjimnazin turk të Gjirokastrës.

1) Hysni Myzyri: Shkollat e para kombëtare shqipe. Tiranë 1973, fq. 124.

2) Fondi QKMGJ. Dosja për shkollën e vitit 1905, shkollë klandestine.

3) Po aty.

trës, por më tepër për të bashkëpunuar me kryengritësit shqiptarë dhe me mësuesit patriotë të këtij qyteti. Andrea Konomi hapi në këtë qytet një shkollë private shqipe ilegale në lokalitetin e një kafe-neje, sipër kodrës, në zemrën e qytetit, ku sot ngrihet Obelisku, që u quajt më vonë mësimorja «Liria»¹). Nxënës të kësaj shkolle kujtojnë edhe sot me respekt të veçantë Andrea Konomin. Këtë shkollë e ndoqën po këtë vit, më shumë zell djem zejtarrësh, nëpunësish të vegjël, qytetarë të varfër, që braktisnin shkollat turke e ato greke.

Një punë të madhe kreu në këtë shkollë mësuesi Thoma Papapano, tok me Basri Beqirin, Ilias Hoxhen, duke pasur në krah patriotë si Kapo Topulli, Shemsho Hajro etj. etj.

Andrea Konomi, duke parë dëshirën e zjarrtë të nxënësve për arsimin shqip, shkruan se «gëzimi i tij më i madh ishte kur shikonte ata se me ç'dëshirë dhe me ç'kujdes dëgjonin e mësonin «Historinë e Shqipërisë», «Historinë e Skënderbeut», librat e Sami Frashërit» etj.

Misionin si mësues ai me shokë e vinin përmbi të tjerët, duke thënë se nuk kishte gjë më të madhe për një atdhetar, se «sa të qënurit mësonjës kombiar»²).

Më shumë vullnet punoi në këtë shkollë edhe patrioti Ilias Hoxha, duke mbjell në zemrat e nxënësve dashurinë për folklorin tonë të pasur. Ai kishte aftësi të veçanta për recitimin bukur të var-

1) Informacion gojor nga ish-nxënës të shkollës.

2) AQRPSSH. Fondi i J. Vruhos, datë 19.II.1909 nr. 50106 dhe gazeta «Zgjimi i Shqipërisë» Janinë 15.II.1910, fq. 2.

gjeve popullore, që nxirrnin në pah trimërinë e patriotizmin e luftëtarëve të lirisë.

Shkolla «Liria», që në fillim, kishte karakter laik. Sa për sy e faqe, në programin e saj mësimor ajo përfshinte edhe mësimin fetar. Aty u mësoheshin nxënësve pjesë nga veprat e rilindasve tanë dhe për trimëritë e patriotëve të çetave kryengritëse dhe të martirëve të gjuhës amtare, si Papa Kristo Negovani e të tjerë.

Me lloj-lloj mënyrash vepruan kundërshtarët e arsimit e të kulturës sonë kombëtare për të penguar ecjen përpara të kësaj shkollë. Konsullata greke në qytet kërkonte të çelte një shkollë bujqësore, por plani i saj dështoi për shkak të kundërshtimit të vendosur të popullit e të patriotëve, ndërsa qeveritarët turq dhe klerikët e krishterë bënë presion për të ndaluar që të shkonin nxënësit e krishterë në shkollën shqipe, duke i kërcënuar ata me çkishërime e mallkime. Kundër kësaj propagande u ngritën mësuesit patriotë si Th. Papapano, Ilias Hoxha, Idris Guri etj.

Në ndihmë të tyre erdhën edhe patriotë të tjerë jashtë rrethit si Nuçi Naçi, që punonte në Janinë si redaktor i gazetës «Zgjimi i Shqipërisë». Ai denonconte klerikët reaksionar me këto fjalë: «Këta janë për të përhapur fenë e për të copëtuar mëmëdhenë»¹⁾. Nga ana e saj, zyra e arsimit turk duke parë se shkollat turke ishin zbrazur, kërkon që shkolla «Liria» të vihet në vartësinë e saj, duke vendosur që rrogat e mësuesve të paguheshin nga arka e shtetit.

Klubi «Drita» e refuzoi këtë veprim antikombë-

1) Fondi QKMGJ.

tar që kishte për qëllim të pengonte shkollën shqipe. Përsëri pushtuesit turq kërkojnë që drejtori të kishte diplomë universitare, duke ditur se Papapano me shokë kishin vetëm shkollë të mesme. Si kundërpërgjigje drejtimin e shkollës «Liria» e mori avokati Asaf Çipi, i cili më vonë u bashkua me çetat kryengritëse.

Edhe konsullata greke gjithashtu vazhdonte të pengonte shkollën shqipe, duke kërkuar që në programin e saj të vihej edhe gjuha greke, por edhe kjo u refuzua nga mësuesit.

Qeveritarët turq dukë parë se këtë shkollë nuk e vinin në vartësinë e tyre, kërkuar që Papapanoja «t'i shtrohej një provimi për gjuhën shqipe në Janninë». Papapanoja dha provimin, prandaj patriotët dhe bashkëpunëtorët e tij u gëzuan sepse kjo do të ishte për të mirën e vetë shkollës, dhe të klubit¹⁾. Duke e parë se dështuan edhe në këtë drejtim, armiqtë e kombit shqiptar u munduan ta largonin Papapanon nga mësuesorja «Liria» duke e emëruar në gjysmëgjimnazin turk të Gjirokastrës, por nuk mundën të realizonin qëllimin e tyre antishqiptar. Atëhere ata filluan të nxisnin elementin rreksionar proturk, të propagandonin kundër shkollës dhe kundër klubit. Mësuesi Basri Beqiri, duke e parë këtë veprim të dëmshëm të armiqve të mësimore, shkruante «se kadilerët, pronarët, arhondët, fajdexhinjtë mëndjeshkurtër s'pushonin së foluri kundër klubit»²⁾.

Por klubi dhe shkolla «Liria», të mbështetur «te djemtë shumë të flaktë, të ndezur për mësimin e

1) Fondi QKMGJ.

2) Po aty.

shqipes, të cilët edhe natën në gjumë ëndërrojnë për shkollën shqipe¹⁾, përparonte vazhdimisht, duke mos u vënë veshin të lehurave të atyre që e përçmonin mësimoren. Duke patur si synim përparimin e mëtejshëm të shkollës, mësuesit e saj punonin pa pushim, me parrullën «kemi nevojë të madhe e të shpejtë për dituri, për qytetëri, për mbrothësi të përgjithshme».

Armë e shëndoshë për përparimin e mësimores ishte edhe kënga patriotike. Ata dijtën të shfrytëzonin edhe folklorin, për të cilin flitet veçanërisht në Kanonizmen e klubit «Drita»²⁾. Mësuesi Ilias Hoxha që kishte grumbulluar një thesar poezish popullore shpesh shkruante në dërrasën e zezë të shkollës poezi popullore për kryengritësit popullorë:

*Mu te qaf' e Peshkëpisë
Lufton i bir i xhixhisë
Me taborret e Turqisë,
Balil-o Balil nuri!*


Ai kërkonte që nxënësit t'i mësonin përmendësh vargjet popullore, duke nxitur gjithashtu të mblidhnin folklorin e pasur. Lidhur me zhvillimin që po merrte folklori në këtë kohë mësuesi Andrea Konomi u raportonte kështu patriotëve në Egjipt, në shkurt 1909: «Në Gjirokastër djali pesë vjeçar është mbushur plot me ndjenja kombëtare... se djemtë po presin t'ju mësojmë shkrimin shqip³⁾» etj. etj.

1) «Liria», 6.2.1910.

2) Po aty.

3) Fondi i QKM Gjirokastër. Letër e A. Konomit, dt. 19.II.1909.

Lokali i shkollës «Liria» ziente deri në mbrëmje vonë nga nxënësit. Në mungesë të teksteve, mësuesit përdornin edhe një poligraf, për të përgatitur lëndët mësimore për të nesërmen, që sot ndodhet i ekspozuar në shkollën muze «Liria». Kishin në përdorim një abetare të dërguar nga patriotët shqiptarë të mërguar. Mësuesit kërkonin me anën letrash tekste shqipe nga shoqëritë patriotike të Bukureshit, të cilat shpesh edhe i ndihmonin¹⁾. Tekste shkollore dërgonte Nikolla Lako, Kristo Luarasi, Luigj Gurakuqi dhe klubi i Manastirit. Shkollës i dërgoheshin edhe fletore bukurshkrimi e vizatimi.



Klubi i Gjirokastrës «Drita»

1) Po aty.

Shkollës «Liria» në Fierkastër

6 hena	sqip	Kuran	tyrqiut	numëtoze	islori
6 matë	frëngjët	numëtoze	deskrone	tyrqiut	sqip
6 mirësi	tyrqiut	frëngjët	Kuran	deskrone	sqip
6 arytë	tyrqiut	sqip	numëtoze	diktim	sqip
6 stune	sqip	frëngjët	tyrqiut	islori	Kuran

Fierkastër. Prej vitit 1908 deri 16 Mars 1913.

Resorset: Dervet, Thoma Papapanos, Abaz Çipi, Rras Haxha, Basri
D. area Çipi, Harulla Harahi, Safet Çanols.

Orari i shkollës shqipe «Liria» (1908)

Disa nxënës të shkollës «Liria» vazhduan më vonë studimet e mëtejshme në Normalen e Elbasanit, siç qe rasti për shembull i Siri Shaplllos, të nxitur nga vetë prindërit e tij¹⁾.

Edhe më vonë armiqtë e shkollës shqipe «Liria» me lloj-lloj mënyrash vazhdonin të sabotonin punën e shkollës.

Ata, me pretekst se lokali nuk ishte i përshtatshëm, organizojnë dërgimin e një komisioni mjekësh në vend. Qeveritarët turq që kurrë nuk interesoheshin për shëndetin e popullit shqiptar, deshën të

1) Po aty.

tregonin se gjoja i shqetësonte fati i nxënësve, gjë që nuk ishte arsyeja e vërtetë.


Duke kuptuar djallëzinë e armiqve, mësuesit dhe gjithë anëtarët e klubit ngulën këmbë me anë të shtypit, të deputetëve të Gjirokastrës, të Hasan Prishtinës gjithashtu, që shkolla të njihej me dekret, se vetëm kështu, besonin ata, mund të sigurohej jeta e saj e rregullt. Kjo përgjigje u prit për shumë muaj me radhë gjersa u arrit njohja zyrtare e shkollës me anën e një dekreti të veçantë.

Mësuesit turq të tërbuar nga qëndrimi i vendosur i shkollarëve tanë, arritën gjer atje sa t'i cilësojnë «rebelë» nxënësit e shkollës shqipe. Bile ata, duke përfshirë edhe vetë drejtimin e gjysmëgjimnazit turk përdorën dhunën kundër mjaft nxënësve të mësimore «Liria». Ankimet e prindërve nuk sillnin asnjë ndryshim. Prandaj u bënë mjaft protesta nga ana e qytetarëve dhe nxënësve të qytetit të Gjirokastrës. Bile studentët e gjysmëgjimnazit turk i shfrytëzojnë këto ngjarje për të forcuar mësimin e gjuhës shqipe në shkollën e tyre. Ata kërkuan që «brenda tri ditëve të caktohej si mësues i shqipes në gjysmëgjimnazin turk Andrea Konomi, përndryshe gjuhën turke nuk do ta mësonin më»¹⁾.

Një ditë tjetër studentët përpara drejtorit të gjysmëgjimnazit turk deklamojnë vjershat me të zjarrta patriotike shqiptare, duke iu drejtuar me guxim atij: «Gjer tani ishim të lidhur, po këndeje e tutje do të këndojmë, gjersa të ngjiremi».

Për gjendjen e krijuar në këtë periudhë flet një relacion interesant i mësuesit Andrea Konomi, i cili

1) Fondi i QKQJ



Fletë — lavdërimi (bravurë) e shkollës shqipe «Liria» të
Gjirokastrës.

drejtorin e ardhur nga Janina e cilëson «një turk të
ndyrë, që nuk do ta shohë me sy mësuesin e shqi-
pes, (Andrea Konomi — L. D.) po që nuk ka ç't'ju
bëjë djemve, të cilët e duan atë shumë se deshnin
ta paguanin nga vetja e tyre, po ai nuk pranoi, duke
u thënë se nuk punon për para, por nga zemra»¹).

Studentët patriotë vazhduan të protestonin edhe
për mësimin e gjuhës frënge, të cilën gjer atëhere ua
jepte një mësues turk. Ata kërkonin që edhe mësi-
mi i gjuhës frënge të jepej nga Andrea Konomi, se
«ky frëngjishten ua kthen në shqip dhe se tjetër

1) Fondi i QKGJ

mësues nuk do të qasin përveç Andrea Konomit...»¹⁾.

Vetëkuptohet se qëllimi i studentëve ishte të hiqeshin nga shkolla mësuesit turq dhe se këta nuk mund të shkuleshin ndryshe nga detyra, që u kishte ngarkuar drejtorja e arsimit të Turqisë. Revoltën e studentëve na e jep të gjallë nëpërmjet të poezive, që ai hartonte në raste të tilla.

Viti 1911 ishte më i mbarë për shkollën edhe për klubin. Në këtë kohë lëvizja patriotike me armë ishte në rritje, dhe përfshinte disa krahina. Çetat kryengritëse vepronin fuqimisht edhe në ndihmë të lëvizjes arsimore e kulturore. Si pjesëtarë të këtyre çetave ishin edhe mësuesit patriotë Shuko Dalipi, Asaf Çipi të mësimores «Liria» e të tjerë. Ata morën pjesë edhe në mitingun e armatosur të Cepos, në korrik 1911, ku populli kërkoi një sistem të vetëm qeverimi, si në Jug, ashtu edhe në Veri.

Në këtë periudhë ndihmat e dhëna nga qytetarët arsimdashës të Gjirokastrës e forcojnë shkollën «Liria». Mjafton të kujtojmë faktin se në një llotari të hedhur në ndihmë të saj, në lokalitë e klubit, vetë Çerçiz Topulli jep 7 lira turke. Kështu pënen dhe shumë të tjerë²⁾. Në këtë ceremoni mallëngjyese Çerçiz Topulli u ngrit e foli shkurt, por hapur, duke treguar se «pushkën që kemi në duar e kemi edhe për shkollën, edhe për klubet dhe ne vetë do t'u dalim këtyre për zot»³⁾.

Dita e 14 prillit 1911, kur qeveria osmane detyrohet të njohë zyrtarisht shkollën «Liria» mbeti një ditë e shënuar për popullin e Gjirokastrës. Atë ditë

1) Fondi QKMGJ.


2) Gazeta «Korça». Korçë, 23.4.1912.

3) Informacion gojor nga Th. Papapano.

në sallën e klubit «Drita» organizohet një ceremoni ku flasin Asaf Çipi dhe Thoma Papapano. Një nxënës dymbëdhjetë vjeçar reciton poezinë e bukur «Shqipëria me bijt' e saj»¹⁾.

Njohja e shkollës «Liria» nga qeveria ishte përfundim i vendosmërisë, i patriotizmit dhe i luftës së popullit gjirokastrit dhe të të gjithë Shqipërisë, që ishin ngritur në këmbë për të fituar të drejtat e tyre.

Në këtë rast patriotët deklarojnë se «kjo njohje e shkollës do të jetë përngahëra e jo për pak kohë»²⁾,



Dhoma e klubit «Drita»

1) Fondi i QKMGJ.

2) Po aty.

ndërsa rapsodi popullor thur vargje duke kënduar:

*kurdoherë dhe si burra
u përpoqët për Shqiprinë
kush ka mend s'u harron kurrë,
se ju doni njerëzinë¹⁾.*

1) Gazeta «Zgjimi i Shqipërisë» Janinë, 16-29 maj 1911.

MËSIMORJA SHQIPE E LABOVËS SË MADHE

Djemtë e Labovës së Madhe luftuan me armë e me pendë kundër pushtuesve osmanë, për shkollën dhe gjuhën shqipe. Kjo luftë u përjetësua edhe nga rapsodi popullor me vargjet: «Kush e bëri proto fora?/ Kapedan Spiro Labova¹). Në fillim të këtij shekulli edhe në Labovë bëhen përpjekje për të çelur një mësimore shqipe. Kështu, tri javë pas mirtit të Gjirokastrës (shkurt 1910) kundër alfabetit turko-arab, në Labovën e Madhe, çelet shkolla e parë shqipe e fshatit, e përkrahur nga klubi «Drita» i Gjirokastrës dhe nga shoqëria «Përparimi», e cila zotohej të mbrojë atë mësimore të re²).

Fshatarët patriotë të Labovës u bënë mbështetja më e sigurtë e shkollës shqipe. Familje si Noçkaje, Xhavara etj. dërguan qysh në fillim fëmijët e tyre në këtë shkollë. Arsimdashësit e përkrahësit e parë të shkollës Lele Noçka, Ilija Noçka, Vasil Konomi, Nane Papajot Mexsi etj. përpiqen për të sjellë në shkollë, jo vetëm djem por edhe vajza, midis tyre

1) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) 1961 fq. 127.

2) Gazeta «Korça», 25 mars 1910.

Katerina Cicën me shoqe¹). Nxënës si Irakli Noçka kujtojnë me respekt mësuesit e tyre plot guxim, duke treguar se «nxënësit e kësaj shkollë me qelshet në kokë, këndonin këngën patriotike»/. Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë etj.²). Nxënësi labovit kujton xha Nanen «që i jipte shpirt shkollës»³) dhe poezinë «Zili paçin tradhtarët/ që s'të lënë të përparosh/ që ndalojnë punëtorët/ që në t'errët t'i të rrosh/...»⁴).

Fakti që fshatarët qëndruan trimërisht tregohet nga shtypi i kohës, ku shkruhet se «trimëresha Labovë është një pasqyrë në Labëri, ku gjithë mësojnë e këndojnë shqip»⁵). Fshatarë e mësues ngrihen kundër klerit të lartë me shumë guxim, duke treguar një urrejtje e përcmim për ta. Fshatarët labovitë i vunë gjoksin shkollës, luftuan armiqtë e mësimit shqip, qeveritarët, klerikët që, si në shumë vise të Shqipërisë, ishin vënë në krah të shkollave në gjuhë të huaj. Meritat e mësuesve të fshatit i vlerëson në kujtimet e tij patrioti Shemsho Hajro, që shkruan: «Mësuesit qëndruan të fortë si shkëmbi e të gjithë kërcënimet i hodhën tutje me neveri»⁶).

Arsindashës gjirokastritë si Izet Hoxha (Reso), i cili, kur u mbyll shkolla nga autoritetet osmane e nga ndërhyrja e klerit të lartë, deklaroi se jepte ko-

1) Kujtime me shkrim dhe gojore nga Mitro Meleqi e Dhimo Papajani.

2) Botim i Muzeut të Gjirokastrës. «Labova një rrezë mali...», 1960, fq. 14-15.

3) Po aty.

4) Gazeta «Lidhja Orthodhokse», 28 mars 1910.

5) «Zgjidmi i Shqipërisë», Janinë, 8.2.1910.

6) «Në gjirin e lëvizjes patriotike». Tiranë, 1962, fq. 83.

çekun e misrit, për të vijuar mësimi i shkollës shqipe të Labovës, duke treguar në këtë mënyrë hapur se ishte në mbrojtje të mësimit shqip, pa marrë parasysh ndjekjet që mund t'i bëheshin. Ai solidarizohet me fshatarët e Labovës dhe me mësuesit e fshatit¹⁾.

Populli ynë nuk kurseu as shtëpinë, as vatrën familjare, kur ishte puna për të çelur shkolla, që aty nxënësit dhe nxënëset të mund të mësonin abecënë e ëmbël të gjuhës amtare.

Vatrën familjare populli e përdori edhe si shkollë, edhe si dhomë mësimi, ndaj edhe e mbrojti kulturën e vet nacionale dhe gjuhën e vet, shkronjat në përdekada, trimërisht e me ballin lart²⁾.

Me hapjen e shkollës shqipe nga Labova e Madhe u larguan mësuesit grekë, të cilët ishin kundër përhapjes së gjuhës shqipe dhe silleshin barbarisht me nxënësit, «duke përdorur edhe shkopin prej thane» siç tregojnë nxënës labovitë në kujtimet e tyre³⁾.

Mësuesit patriotë punuan dhe përballuan persekutimet dhe çkishërimet që u bënë armiq të gjuhës shqipe. Ata qëndruan burrërisht përballë intrigave dhe iu përgjigjen armiqve me një punë më të organizuar dhe më të guximshme, jo vetëm me mbrojtjen e shkollës, por të të gjithë çështjes kombëtare. Duke patur përkrahjen e fshatit dhe të patriotëve të rrethit, ata bënë që në Labovën e Madhe të

1) «Labova një rreze mali çel shkollën shqipe...». Botim i Muzeut Historik të Gjirokastrës. Viti 1960, fq. 13.

2) Një e tillë ishte familja Noçkaje, që ndihmoi familjen e patriotit Papa Kristo Negovanit («Drita», 1 maj 1906, nr. 77).

3) Vangjel Karajani. «Naim Frashërit». Grac. Austri 1925, fq. 54.

NE KETE
VEND
FULOI TE
JARI DRITE
KUR HERE
TE PARE
NE FSHATRA
E DREHTIT
TONE
SHKOLLA
SHQIPE NE
4 PRILL 1910

Lapidari që përkujton shkollën shqipe të Labovës.

«mbijë trëndafili në një kopësht të bukur»¹). Edhe këtu, si në Gjirokastër, nxënësit u larguan nga shkollla greke dhe u vendosën në shkollën shqipe, ku mësohej vargu i Naimit, poezia e Çajupit, historia e Shqipërisë. Një shkollë zbrazej dhe një tjetër mbushesh me fëmijët e katundit. Në mes të tyre shquhej edhe një vajzë, Katua (Katerina), e mbiemëruar «shqiptarja», sikurse e thërrasin edhe sot labovitet këtë plakë patriotë. Përparimi i shkollës së Labovës e nxiti konsullin grek në Gjirokastër, t'i shkruante pleqësisë së fshatit se «pa u pëlqyer e pa u vendosur prej tij, nuk do të vihet asnjëri mësues»²).

Nga ana tjetër, peshkopi i Gjirokastres, deklaronte se çkishërimi nuk do të hiqej përderisa labovitet e akuzonin atë duke i thënë se «Peshkopi punon për interesin e Greqisë»³).

Armiqtë bënë çmos që të mbyllnin shkollën e Labovës. Por labovitet duke patur përkrahjen e patriotëve të Gjirokastres dhe të Korçës si dhe të «Lidhjes ortodokse» qëndruan trimërisht. Kur shkolla u mbyll nga ndërhyrja e pushtuesve turq dhe e shovinistëve fqinj, labovitet përsëri e hapën. Shtypi i asaj kohe shkruante kështu për vendosmërinë dhe patriotizmin e tyre:

«Në Labovë shqiptarizma përparon shumë mirë, grekomanët s'mund të shijnë si më parë»⁴).

Ndërsa patrioti Mihal Grameno, duke shkruar për ngjarjet e Labovës: «Trimëresha Labovë është

1) «Liria». Selanik, 19 qershor 1910.

2) «Lidhja ortodokse». Korçë, 22.3.1910.

3) Fondi QKMGJ.

4) Lidhja ortodokse. Korçë, 22 mars 1910.

një pasqyrë në Labëri, ku gjithë mësojnë e këndojnë shqip»¹⁾).

Labovitët ishin krenarë për shkollën e tyre, e cila u përshëndet nga Jani Vruho dhe nga A. Z. Çajupi, i cili midis të tjerave shkruante: «...Jam aty në mes të çunave të Labovës, për gëzimin e fshatit dhe për helm të armiqve tanë...»²⁾. Dërgojnë përshëndetje mësues patriotë të vjetër e të rinj nga i gjithë vendi si Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi, Mihal Grameno, punëtorë të mërguar në SHBA, që shkruajnë e «gëmbaçet, mbeten fort të pakë»³⁾.

Kurse një fshatar nga Sinanaj i Tepelenës harton vargje si këto:

*Katundi Tepelenës Labovë
mësuar që hapet shkollë
ju lumtë, o labovitë
që hapët shkollë e bëtë dritë
e provuat burrërinë
e nderuat Shqipërinë⁴⁾*

Rapsodi popullor u thotë tepelenasve të marrin shembull nga kjo shkollë fshati, të ngrihen, të ndihmojnë materialisht për këtë qëllim.

Në një letër plot frymëzim, përshëndet mësuesi i ardhshëm i Kaninës, Jani Minga, duke uruar «që shkolla si kjo të çelen pa frikë se mallkohemi, pa frikë se do të vuajmë, duke uruar të rrrojë Labova

1) Gazeta «Lidhja Ortodokse». Korçë, 22 mars 1910. nr. 15.

2) Fondi QKMGJ.

3) «Liria», 19.6.1910

4) «Dielli i Flamurit». Boston, 10.6.1910.

me shoqe dhe mësimoret të shumohen nga Kanina, në Çajup, në Tomorr e në Cukal¹⁾.

Frika e çeljes së shkollave të tjera në fshat bëri që armiqtë të mundohen ta mbyllin atë me çdo mënyrë, të bindur se «po shkoi miu në mjekër do të kalonte edhe qerrja»²⁾.

Lufta kundër klerikëve bëhej me këmbëngulje nga patriotët tanë, në mënyrë që synimet e tyre të mos realizoheshin. Mësuesit e kësaj shkolle vazhduan të punonin për gjuhën amtare edhe më vonë (pas viteve 1910-1912), duke mësuar fshehtas shqipen.

Edhe pas viteve 1920 kërkesat e fshatarëve gjithërokastritë për shkollë vazhduan. Ata ngrinin problemin e ngutshëm për arsim duke kujtuar ditët e zeza të robërisë otomane.

1) Fondi QKMGJ.

2) «Zgjimi i Shqipërisë», Janinë, 5 maj 1910.

MËSIMORE TË TJERA SHQIPE

Në vitet 1908-1910 dhe më vonë, edhe në Libohovë, bëhen përpjekje për të hapur mësimorën shqipe. Ky qytet, me shumë tradita patriotike, i kishte dalë me kohë në mbrojtje gjuhës dhe kultures sonë. Libohova para edhe pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dha kontribut në lëvizjen patriotike të atyre viteve. Qysh në vitin 1885 këtu ka «patur shumë njëzëz që kanë mësuar e kënduar gjuhën e tyre shqipe»¹).

Përpjekje, veçanërisht, bëhen në fillim të këtij shekulli nga djem të ri për të çelur shkollën shqipe. Edhe më të mëdha u bënë përpjekjet për një mësimore shqipe, në verë të vitit 1910. Sipas një dokumenti të kohës shikojmë se «disa djem shqiptarë çelën një shkollë shqip dhe u mblodhë një 75 nxënës»²).

Dokumenti tregon nga ana tjetër se shumë njëzëz u gëzuan për këtë sukses, ndërsa armiqtë u ngrihën kundër mësimores.

Është për t'u përmendur se në grupin e këtyre «djemve të Libohovës» bënte pjesë Avni Neimi

1) Konomi. «Liria», 30 vjeshtë e dytë 1910, Nr. 102.
2) Po aty.

(Avni Rustemi)¹⁾, Sherif Ruli etj. Në këtë iniciativë *shikohet dora e Avni Rustemit, që bashkë me shokë, në mes të terrorit do të hapë shkollë në Libohovë e do të mësojë gjuhën e ndaluar shqipe, duke ndezur zjarrin e patriotizmit, në të vegjël e në të rritur»²⁾. Avni Rustemi, në atë kohë ishte 15 vjeç, por atë nuk e ndalon mosha e re, që të hidhet në një veprimtari të zjarrtë. «Në çdo lëvizje kombëtare, Avniu ndodhej brenda — shkruajnë shokët e tij. Herë duke ndjekur mësimet e herë duke u hedhur në mes të çdo lëvizjeje»³⁾.*

Tok me Sherif Rulin, ish-mësues i shqipes në Kuqar të Përmetit, Avniu i siguron qytetit të lindjes një vatër të mësimit shqip. Por edhe këtu shikojmë se si parësia, bejlerët e klerikët ngrenë dorën kundër shkollës dhe kundër mësuesit të shqipes. Në dokumentin që mban datën 30 të vjeshtës së dytë 1910, midis të tjerave, për mësuesin Sherif Ruli shkruhet: «Mësonjësin me urdhër të prefektit të Gjirokastrës e prapsme nga puna dhe e thërrasin në Janinë, ku me urdhër të valiut dërgohet në Hotovë të Përmetit, tri orë larg prej këndeje, duke e ndarë nga shokët dhe nga nxënësit e vet. Edhe përpjekja për shkollë në verë të vitit 1910 tregoi hapur se «njerëzia në Libohovë duan dritë» duke goditur me këtë rast ata që duan errësinë⁴⁾.

Këtu del qartë njëkohësisht roli negativ i klerit mysliman, që bën çmos për mbylljen e mësimores. Lidhur me këtë patriotët iu përgjigjen ar-

1) Beqir Sinani. Revista pedagogjike nr. 6 1974, fq. 136.

2) Beqir Sinani. «Revista pedagogjike» nr. 6, 1974, fq. 136.

3) Ura e Shkumbinit. Elbasan, 30 prill 1924.

4) Liria, 30 vjeshtë e dytë 1910, nr. 102.

miqve të mësimit shqip se «dituria dhe këndimi i shkrimit nuk prish kurrë fenë, nga padija rrjedhin ligësitë, nga dija burojnë dashuria dhe lumturia».

Patriotët, të sigurtë se armiqtë e shkollës ishin vetëm ata që i shërbenin pushtuesit, tregojnë se ishte në dorën e vendasve të Libohovës «pleq dhe të rinj» të dilnin në mbrojtje të ditorisë. Dhe libohovitët e treguan hapur se ishin për arsimin shqip, duke u dhënë goditje të gjithë atyre që kërkonin errësirën mesjetare.

Vetë mësuesi Sherif Ruli na jep të dhëna për këtë ngjarje të muajve korrik-gusht 1910, duke shkruar se «sikurse ndë gjithë viset e Shqipërisë, që nisen bota e tërë të lëkunden e të përpiqen për të përhapur gjuhën e bukur tonë, ashtu dhe neve në verën që shkoi, nismë të çelim një shkollë kombiare»¹).

Por edhe këtu, si në fshatra të tjerë, pati kundërshtarë e armiq të shkollës shqipe. Patrioti Sherif Ruli tregon se kundërshtarët e shkollës shqipe nuk patën sukses, pasi patriotët mbështeteshin te masa e fshatarëve, të shumica e libohovitëve që ishin pro shkollës shqipe, pro kulturës etj.

Kështu me luftë e përpjekje, siç përmend edhe gazeta «Zgjimi i Shqipërisë»²) libohovitet hapën shkollën shqipe në vitet e mëvonshme, dhe jo vetëm shkollën por edhe shoqëri patriotike e demokratike.

1) Gazeta «Zgjimi i Shqipërisë». Janinë, 16 maj 1911, nr. 11.

2) Gazeta «Zgjimi i Shqipërisë» 2 vjeshtë e parë 1910.

Djemtë e Libohovës veç kontributit të çmuar që dhanë në punën e arsimit shqip, nga viti 1909 e këtej u dalluan edhe në përpjekjet për teatrin shqip, duke treguar se të rinjtë e këtij qyteti kishin një talent të veçantë në këtë fushë.

Ata dhanë shfaqjet e para në Janinë, kur ishin studentë në shkollat e mesme, dhe nga të ardhurat që fitonin kërkonin të «ngrinin mësonjëtoreshqip për të vegjëlit, ku të mësohej gjuha shqipe».

Djemtë e Libohovës krahas përpjekjeve për shkollën shqipe në qytetin e tyre punojnë më shumë dëshirë edhe për forcimin e Normales së çelur në Elbasan, në 1 dhjetor 1909, ku në mes të studentëve të parë të saj shquhej Heroi i Popullit Avni Rustemi.

Këta dhe patriotë të tjerë shqiptarë, që jetonin në Janinë, organizuan një mbledhje dhe brenda «një sekonde» mbledhën 230 napolona si fond për shkollën Normale¹⁾.

Veç nxënësve të shkollave fillore shqipe, që ishin të çelura në këtë periudhë, edhe prindërit «ëndërronin që, pasi fëmija të mbaronin shkollën «Liria», që nga Gjirokastra t'i dërgonin në shkollën Normale të Elbasanit, ku të përgatiteshin për mësues»²⁾.

Më këtë mendim ishin edhe patriotët e rinj e të vjetër libohovitë, që ndihmuan me të gjitha mundësitë edhe normalen shqipe të themeluar në Elbasan.

Gjatë viteve 1908-1910, edhe në Tepelenë bë-

1) Gazeta «Koha», 13 janar 1912.

2) P. Pepo. Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912. Tiranë, 1962, fq. 288.

hen përpjekje për të hapur shkollën në gjuhën amtare. Shkolla shqipe në Tepelenë u hap më 1910 më 60 nxënës dhe dy mësues.

Edhe në fshatrat e këtij rrethi përpjekjet për të hapur shkolla shqipe janë bërë që më 1906. Shkolla shqipe u hap në Koshtan më 1908, ndërsa më 1910 u çel shkolla e fshatit Matohasanaj. Shkolla shqipe u hap edhe në Bënçë.

Edhe në fshatrat e Përmetit janë bërë përpjekje për hapjen e shkollave shqipe. Janë shquar në këtë fushë sidomos patriotët e Hotovës. Në shkollën e këtij fshati qysh nga vjeshta e vitit 1909 jepeshin mësimet shqip nga dy-tre orë në javë. Në shkollën e Kuqarit gjithashtu, sipas shtypit të kohës mësohej gjuha amtare.

Si kudo edhe në Përmet pushtuesit osmanë dhe qarqet shoviniste sjellin lloj-lloj pengesash për të penguar hapjen dhe funksionimin e shkollave shqipe. Po edhe patriotët përmetarë punonin në këtë drejtim.

Më 26 shkurt 1910 në Danglli u organizua një miting i gjerë ku morën pjesë mbi një mijë veta. Më parullën «Rroftë abecejë», manifestuesit u tregonin pushtuesve dëshirën e popullit për arsim. «Kështu të bashkuar qytetarë e fshatarë përmetarë, drejtohen në zemër të qytetit, duke protestuar edhe më anën e një telegrami pranë Ministrisë së Arsimit në Stamboll, si dhe pranë parlamentit të Turqisë»¹⁾.

Delvina gjithashtu bënte përpjekjet për arsimin shqip. Ajo kishte tradita të shquara në këtë fushë. Qysh më 1730, fshatarët delvinjotë kishin bërë që të

1) Gazeta «Liria», 13 mars 1910.

largoheshin prej këndeje klerikë të dërguar nga «Izmiri i Turqisë, për të përhapur gjuhën greke»¹⁾.

Delvina kishte në gjirin e saj patriotë të tillë si Namik Delvina, që punonte në drejtim të shkollave shqipe para dhe pas shpalljes së Kushtetutës xhonturke. Së bashku me mësues të tjerë patriotë ai bëri përpjekje të mëdha për arsimin shqip.

Namiku mbetet si një nga pionierët e arsimit shqip në krahinën e Delvinës. Po kështu edhe Xhafo Poshi, i cili punoi për shkollën shqipe gjer në prag të Luftës Ballkanike. Kurse një mësues tjetër patriot, Xhelal Berberi, vazhdoi të punojë për gjuhën amtare, edhe më vonë. Ai u bë iniciator i hapjes së shkollës shqipe të këtij qyteti më 16 nëntor 1916. Në këto shkolla më vonë punuan mësues të tjerë patriotë.

Këta mësues patriotë dhanë kontributin e tyre edhe në aktivitete jashtëshkollore. Kështu p.sh. në gusht të vitit 1909 me iniciativën e tyre u organizua shfaqja e parë teatrale në sheshin kryesore të qytetit të Delvinës.

Edhe në Konispol, pas vitit 1908 mori zhvillim të gjerë shkolla në gjuhën amtare. Mësues si Rexhep Domi dhe pas tij i vëllai, Musa Domi punonin me mish e me shpirt, pa marrë parasysh kërcënimet e armiqve për të përhapur gjuhën amtare.

Ata kishin punuar vetë mjetet e riprodhimit të shkrimeve, me një lloj poligrafi primitiv, ndërsa populli ndihmonte me çdo mjet për të ngritur shkolla, duke siguruar gurin, gëlqeren etj.²⁾

1) Muzeu historik Gjirokastër.

2) Fondi i QKMGJ. Dosja Musa Domi — Kujtime për arsimin shqip — fq. 1.

Në Filat shkolla shqipe u hap më 25 gusht 1908. Për ngritjen e kësaj shkolle populli mblodhi rreth 74 lira turke. Mësuesit e kësaj shkolle u kërkuan shoqërive të mërgimit t'u dërgonin 300 abetare. Ata mendonin që krahas shkollës të kishin edhe një shtypshkronjë.

Po kështu edhe në Ninat, në fshatin e lindjes të patriotit të shquar Hasan Tahsimi në prill të vitit 1910 u hap shkolla shqipe.



Çerçiz Topulli

SHOQËRIA «KANDILE»

Formohet në qytetin e Gjirokastrës si shoqëri e fshehtë nga Heroi i Popullit Çerçiz Topulli, me 29 maj 1909. Në kushtet e rënda e të vështira të pushtimit osman Çerçiz Topulli bëri përpjekje të veçantë në atë kohë për organizimin e kësaj shoqërie, e cila u quajt «Kandile» dhe dita festive e saj bëhej me ndezje kandilesh. Si shoqëri e fshehtë ajo ka funksionuar pak vjet, gjer më 1912. Merrnin pjesë qytetarë nga qyteti dhe fshatrat e Gjirokastrës, të cilët u shquan për solidaritetin e treguar gjatë persekutimeve të katundarëve të Hormovës më 1914¹⁾.

Çerçiz Topulli punoi në krye të shoqërisë «Kandile», me frymë të lartë patriotike për bashkimin e mëtejshëm të popullit të kësaj krahine për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Anëtarët e shoqërisë «Kandile» janë ndeshur ashpër me klubet xhonturke e të shovinistëve grekë, që mundoheshin të përçanin lëvizjen patriotike në Jug. «Kandilja» e frymëzuar nga mendimet e guximshme të luftëtarit dhe heroit të Mashkullorës

1) Fondi QKM Gjirokastrë. Dokumenti, datë 28 maj 1919.

SHOQËRIA «VËLLAZËRIA»

Kushtet e rënda, në të cilat jetonte vendi ynë, i bënë patriotët të kërkonin që të ishin gjithnjë të bashkuar. Populli nuk e ndërpreu kurrë luftën e vet për të qënë i bashkuar, që të realizonte kështu aspiratat e veta.

Këtë dëshirë të popullit, ndonëse nën pushtimin italian, e tregoi hapur edhe Gjirokastra e kaq traditave, duke themeluar shoqërinë «Vëllazëria», më 23 nëntor 1919, me pjesëmarrjen e afro 200 vetave në lokalitë e shkollës të lagjes «Varosh».

Ajo kishte si program vëllazërimin, mbrojtjen e interesave të vëndit, në një kohë që zhvillohej Konferenca e Paqes në Paris, duke bërë përpjekje sistematike për sigurimin e të drejtave të Atdheut. Ishte për «një Shqipëri të re, e bazuar në parimet e lirisë e të vëllazërimit, të demokracisë, të kombësisë dhe jo të skllavërisë, oligarkisë, fetarizmit»¹⁾.

Anëtarët e shoqërisë, megjithëse e kishin të vështirë të realizonin këto synime, kanë meritën e madhe se punuan me ngulm. Ata dhanë prova patriotizmi, guximi, duke u ngritur herë pas here kundër elementit që iu kundërvu programit të saj.

1) Fondi QKMGJ — Dësja Nr. 1



SHOQËRIA "VËLLESËRIA"

GJINOKASTRË



Shoqëria «Vëllazëria»

Shoqëria punoi sidomos në fushën e arsimit. Në statut preket çështja e lehtësimit të jetës së fshatarit, veçanërisht e grave.

Ajo mundi të ngrinte një bibliotekë, e cila do të shërbente për ngritjen kulturore të popullit të Gjirokastrës.

Shoqëria synone në mbajtje konferencash, me qëllim që të përhapte frymën e vëllazërimit midis popullit, të shtypur e fukara duke botuar edhe një të përkohshme, që të forconte ndjenjat e patriotizmit, si udhërrëfyes i jetës së re kombëtare. Në programin e shoqërisë parashikohej krijimi i një grupi muzikantësh, të një orkestre dhe të një grupi teatral. Programi parashikonte gjithashtu zhvillimin e

gjimnastikës, të futbollit dhe ruajtjen e shëndetit të të rinjve¹⁾.

Anëtari që do të pranohej në këtë shoqëri duhej të betohej se do të punonte me fjalë e me vepra për forcimin e shoqërisë, këshilli do të përbëhej nga 10 anëtarë të zgjedhur lirisht me votim të fshehtë nga asambleja, prej 2/3 të anëtarëve. Do të organizoheshin festa me rast përvjetoresh për data historike me rëndësi, si ajo e nëntorit 1920. Në këtë shoqëri dhe në kryesinë e saj bënin pjesë patriotë të shquar në lëvizjen kombëtare të rrethit të Gjirokastrës. Prandaj edhe qytetarë gjirokastritë të emigruar në SHBA shkruajnë se «si djem të këtij vendi u gëzuan tepër kur pamë që në pleqësinë e kësaj shoqërie ishin patriotë të sprovuar, me të cilët kishin bashkëpunuar në kohët e mëparshme²⁾.

Nga muaji mars 1920, shoqëria përtërihet me të rinj, duke hyrë në të dhe anëtarë nga vegjëlja e qytetit, nëpunës të vegjël, zejtarë, demokratë konsekuentë që synonin të krijonin një vatër për një lëvizje demokratike të fuqishme.

Shoqëria shënon një përparim në rrugën e saj, duke goditur elementët anadollakë që nuk dinin ç'ishin mbledhjet dhe shoqëritë, që preferonin bisedat nëpër kafenetë, biseda më shumë në formë thashethemesh, etj. Në shoqëri hynë elementë të shëndoshë që ishin kundër një regjimi të vjetër e anadollak, patriotë që kishin punuar brenda e jashtë vendit, jo vetëm për pavarësinë e Shqipërisë, por edhe për një Shqipëri, që të mos ishte ç-

1) Fondi QKM Gjirokastrë.

2) Fondi QKM Gjirokastrë.

flig i feudalëve dhe i borgjezisë. Në shoqëri kishte elementë të rinj si arsimtarë që ishin ngritur me guxim kundër prapambetjes ekonomike-shoqërore e arsimore-kulturore të vendit. Këta arsimtarë demaskonin dembelizmin e tyre dhe shfrytëzimin që u bënin punonjësve¹).

Shoqëria mundi të punojë drejt dhe mirë për mbrojtjen e interesave të vendit, sepse në të punonin patriotë si Polo Meksi, bashkëpunëtorë i vjetër e i ngushtë i vëllezërve Frashëri, Hysen Hoxha, që dallohet edhe për luftën kundër bejlerëve, Hasan Xhiku, që bënte pjesë në pleqësinë e shoqërisë, Thoma Papapano, të cilit shoqëria, me anën e një letre të datës 23 janar 1920 «i jep fuqi të plota të vejë nd'Evropë e ku të dojë nevoja për të mbrojtur të drejtat kombëtare të kësaj krahine, duke përdorur çdo farë mjet që të gjejë të udhës dhe të nënshkruajë nd'emër të shoqërisë çdo letër e telegram, që do të ketë të bëjë me këtë çështje»²).

Për likuidimin e shoqërisë vepronin elementë të ndryshëm që kërkonin ta dëmtonin atë. Megjithatë, shoqëria shkon përpara dhe ajo u bë një vatrë e lëvizjes demokratike e patriotike në vitet 1919-1924.

Ndërsa klubi «Drita» i viteve 1908-1913 ishte bërë boshti i rezistencës kundër pushtesit osman dhe shovinizmit grek, shoqëria «Vëllazëria» diji të qëndrojë përballë kërcënimeve, të godiste agjentët e imperializmit italian, tradhtarët, disfatistët e dezertorët e Luftës së Vlorës.

1) Fondi QKMGJ (Dosja nr. 1)

2) Fondi QKMGJ. Dosja nr. 1 Dokumenti dt. 23.I.1920.

Shoqëria lufton me kurajo kundër veprimeve djallëzore të pushtesit italian, që nxiste hajdutët kundër fshatarësisë së varfër. Kronistë të asaj kohe shkruajnë se karabinierët italianë i shikonin hajdutët maleve dhe nuk i ndiqnin. Shumë fshatarë ishin grabitur e vrarë prej tyre si në Dervican, Boddrishtë, Hundëkuq, Tërbuq etj., në kohën kur pushtesit ngrinin burgje për patriotët.

Shoqëria punoi në drejtim të shkollave mikste, të arsimit laik, duke goditur klerikalizmin, por në çështjen agrare ajo nuk arriti asnjë përfundim, sepse kundër saj u ngrit «Lidhja e bejlerëve dhe e agallarëve».

Ajo organizonte protesta, sidomos pas deklaratave të dhëna në shtyp nga kryeministri italian i asaj kohe, që kërkonte copëtimin e Shqipërisë, gjë që ngrihti në këmbë gjithë popullin dhe patriotët shqiptarë¹⁾.

Menjëherë pas kësaj shoqëria «Vëllazëria», dërgoi një protestë në Paris, ku midis të tjerave thuhet: «Populli i Gjirokastrës përpara ngjarjeve kritike që kalojnë fatet e kësaj krahine në Konferencën e Paqës, jeton çastet më të vështira të jetës së tij kombëtare».

Protesta vazhdon të tregojë se «Gjirokastra nuk do të lejojë copëtimin, se populli trim është gati të bëjë çdo sakrificë morale e materiale, që të mos pësojë fatin fatal të bjerë nën thundrën armike»²⁾.

Shoqëria punon në kushte të rënda, sidomos në vitet 1920, mbasi Qeveria e Tiranës, e kryesuar nga

1) Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës. Tiranë, 1974, f. 95.

2) Fondi i shoqërisë «Vëllazëria», Gjirokastrë (dosje nr. 1)

Iliaz bej Vrioni, që i shikonte me shqetësim klubet e shoqëritë, kërkon me këmbëngulje mbylljen e tyre, duke ua kaluar në këtë drejtim edhe vetë pushtesve. Dokumenti i këshillit të Ministrave të qeverisë të asaj kohe vërteton «se këto (klubet) dëmtojnë politikën e brendshme e të jashtme të shtetit», duke shtuar se «futët në rrezik jeta e Atdheut». Sipas vetë urdhërit të Këshillit të Ministrave të nënshkruar nga kryeministri Iliaz bej Vrioni, «dëmi më i madh i Turqisë nga këto klube erdhi, ata e shkatërruan plotësisht atë»¹⁾.

1) AQRPSSH. Fondi i Kryeministrit Nr. 99/16, datë 10.10.1921.

SHOQËRIA «DRITA» E GJIROKASTRËS

«Drita» është e dyta shoqëri demokratike e Gjirokastrës, e formuar më 2 dhjetor 1920, që eci krahas shoqërisë «Vëllazëria». Ajo e përqëndroi aktivitetin e saj veçanërisht në problemin e kulturës dhe të arsimit. Ishte vazhduese e shoqërisë «Drita», të themeluar në mërgim nga patriotë gjirokastritë.

Merita për bashkimin e shoqërive në Shqipëri i takon kësaj shoqërie dhe me plot të drejtë Avni Rustemi, në Kongresin e madh për bashkimin e shoqërive në Vlorë, tha midis të tjerave: «Bashkimi i shoqërive nisi nga «Drita» e Gjirokastrës. Ajo tha në muajin shkurt poshtë egoizma krahinore dhe shfaqti dëshirën e bashkimit. Këndej shkrepri shkëndia e parë e bashkimit».

Avniu vizitoi me radhë Delvinën, Sarandën, Këlcyrën, ku nuk gjeti ndonjë kundërshtim. Pastaj arriti në Përmet, ku u takua me anëtarët e shoqërisë «Njeriu i ri», të cilët ja pranuan propozimet që shtroi.

Për bashkimin e shoqërisë «Drita» me të gjithë shoqëritë e tjera të mbarë Atdheut u zhvillua një ceremoni e veçantë në Gjirokastrë, me 3 qershor 1921, ku kryetar i mbledhjes u caktua Avniu. Këtu u votua për kryetarin, për sekretar Veli Hashorvën,

për anëtarë Kiço Koçi, Hasan Xhiku, etj. Në mbledhje pati recitimie poezish patriotike për Luftën e Vlorës, ngjarje historike nga Ramiz Harxhi, ndërsa Avni Rustemi merr fjalën përpara afro 100 vetave ku foli për rëndësinë e kësaj shoqërie. Atë ditë në të u regjistruan 40 anëtarë të rinj.

Lokali i shoqërisë kishte një dhomë për bibliotekë. Ata u bënë thirrje të rinjve ta frekuentojnë atë, të lexojnë libra e gazeta të ndryshme.

Duke ndjekur programin e saj, shoqëria «Drita» u ngrit në mbrojtje të shkollave fillore dhe të shkollës së mesme të Gjirokastrës. Duke vërejtur se gjoja «për kursime» mbylleshin shumë shkolla fillore, «Drita» proteston, duke thënë se «kjo është një masë e çuditshme për të ekuilibruar buxhetin e shtetit»¹⁾. Njëkohësisht shoqëria «Drita» shfaq mendimin se «vetëm të hollat e prishura për arsim janë ato që zënë vend», njëkohësisht kërkon të çelen shkolla të tjera në katunde dhe të shpejtohet ngritja e godinës së liceut²⁾.

Por edhe këto kërkesa nuk merren parasysh. Për këtë problem flasin vetë përgjigjet e dhëna nga Kryeministria³⁾.

Shoqëria «Drita» ishte bërë një qendër e mirë edhe për patriotët e moshuar. Aty shkëmbeheshin mendime për të ardhmen, dhe bisedohej për lëvizjen demokratike. Këtu vinin miq e patriotë. Me rastin e vizitës që bëri Fan Noli në Gjirokastrë më 23 gusht 1923 në kuadrin e fushatës elektorale,

1) Fondi QKMGJ (Dosje nr. 1).

2) Po aty.

3) Po aty.

takohet me anëtarët e shoqërisë dhe bisedon me ta për probleme të ndryshme politike e shoqërore¹⁾.

Elementi progresist dhe përkrahja e popullit bëri që shoqëria të shkojë përpara; të ketë suksese në fushën politike, kulturore e arsimore, por jeta e saj nuk shkoi gjatë. Me vendosjen e diktaturës zogiste, që mendohej të shuante çdo lëvizje demokratike, ajo u mbyll. Regjimi antipopullor i Zogut ishte armik i përparimit dhe i demokracisë, pra dhe i shoqërive patriotike.

Degë të shoqërive «Vëllezëria» dhe «Drita» u hapën edhe në Libohovë. Në Kongresin e shoqërive, «Vëllazëria» e Libohovës u përfaqësua nga demokrati konsekuent dr. Sezai Çomo. Në Tepelenë ishte ngritur Lidhje tjetër e përfaqësuar në atë Kongres nga Avni Rustemi, kurse në Konispol vepronte një shoqëri tjetër.

Por edhe këto, si të tjerat u likuiduan nga qeveria zogiste, e cila në çdo organizatë demokratike shikonte një pengesë për realizimin e synimeve të saj antikombëtare.

1) «Shqipëria e re» Konstancë, 23.9.1923.

SHOQËRIA E GRAVE GJIROKASTRITE

Shoqëria e parë e grave gjirokastrite u themelua më 1922 me emrin «Kundra Bastijës». Në mbësh-tetje të kësaj shoqërie, veç Urani Rumbos, kontri-buan arsimtarët demokratë Thoma Papapano e Hysni Babameto. Duke folur për meritat e të dy mësuesve Papapano (i riu) dhe të H. Babametos, shkruhej «se këta sulmojnë me gjithë forcën e tyre «Bastiljen» e Shqipërisë d.m.th. errësirën në të cilën mbahet grua-ja në Shqipëri, megjithëqë nga të ndriturit e gruas mvaret dhe qytetërimi dhe përparimi dhe rrojtja e Shqipërisë»¹⁾. Shoqëria zhvilloi aktivitete të ndryshme me gratë. Ajo bënte mbledhje me to, në të cilat merrte pjesë sidomos Urani Rumbo, e palodhur në shkollë dhe jashtë saj.

Nga puna e shoqërisë deri në një farë shkalle u përgatit terreni për një farë zhvillimi të gruas, për marrjen pjesë të vajzave në shkollën femërore të qytetit dhe veçanërisht në liceun e Gjirokastrës, duke e bërë atë shkollë të mesme mikste.

1) Fondi i QKM Gjirokastër, Korrik 1921.

I mbështetën këto përpjekje të grave përparimtare, veç Urani Rumbos, edhe mësuesja Naxhie Hoxha, etj. dhe më vonë Nebahet Bakiri, Qibrie Ciu. Kjo shoqëri dhe të tjera që u ngritën patën mbështetjen e patriotit dhe organizatorit të çetës së parë kundër Turqisë Bajo Topullit etj.

SHOQËRIA TEATRALE

Arsimtarë patriotë e përparimtarë, nga fundi i vitit 1920, themelojnë në Gjirokastrë të parën shoqëri teatrale. Janë në këtë shoqëri një plejadë mësuesish, që kishin dalë në skenën e Gjirokastrës, qysh në shtator 1909, të mbledhur grusht rreth klubit politik «Drita». Amatorët e rinj e të vjetër japin në mbërëmjen e përvjetorit të tetë të Shpalljes së Pavarësisë në Vlorë dramën «Filja» dhe komedinë «Martesa me përdhunë». Ishte e dyta herë që, pas një periudhe njëmbëdhjetëvjeçare, pas Luftës Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, bëhej e mundur dhënia e një shfaqjeje të tillë.

Në këtë shfaqje doli edhe një orkestër e përbërë prej pesë vetash, e para e këtij lloji në Gjirokastrë. Në këtë pjesë teatrale dallohen Niko Progri, Ilias Hoxha, Xhafo Poshi, Dine Qadhini, etj.

Mësues, nxënës dhe amatorë organizojnë shfaqje dramash si «Filja». Me të hollat e grumbulluara do të ngrihej një bibliotekë në qytet. Në këtë kohë fondi i shoqërisë teatrale «Gjirokastra» ishte fare i vogël, gjë kjo që tregonte sesa të varfëra ishin të ardhurat. Varfëria dhe mjerimi që kishin pushtuar popullsinë e Gjirokastrës shprehet edhe nëpërmjet faqeve të gazetave përparimtare, të cilat shkruanin

se: «populli vuan në heshtje dhe për ca muaj s'është çudi të vdesij një pjesë e varfër prej urie, pa u ndjerrë»¹⁾. Megjithkëtë varfëri populli ndihmoi për teatrin me aqë sa kishte.

Shoqëria «Gjirokastra» i kushtoi kujdes të veçantë pjesëmarrjes në teatër edhe të grave, duke kërkuar që këto të vinin në shfaqje, në një kohë kur konservatorët e urrenin dhe e luftonin këtë veprimtari teatrale. «ATINË ATINAD»

Anëtarët e shoqërisë teatrale punonin pa u lodhur. Shquhej sidomos Urani Rumboja, me gjithë «propagandën e ndyrë» që bënte kundër saj feudoborgjezia e qytetit. Me shfaqjen e dramës «Vdekja e Pirros» shoqëria teatrale pati një sukses të madh, ku dallohen elementë të rinj plot talent, aq sa kur flitet për këta, shkruhet se «me një stërvitje të posaçme, mund të bëhen nganjëktohet me të slyer të skenës shqiptare»²⁾.


1) QKMGJ (Dësja Nr. 1).

2) Revista «Nëntori», viti 1960, nr. 3, fq. 118.

KLUBI I OPINGARËVE «SHPRESA» DHE GAZETA «DRITA»

Në kushte të vështira punonin e jetonin në ato kohëra punëtorët, vegjëlja e qyteteve, zejtarët, duke mos patur asnjë përkrahje. Megjithatë ata punonin e luftonin kundër shtypjes e shfrytëzimit. Elementë përparimtarë nga shtresat e borgjezisë që kishin interesa për një zhvillim ekonomik, shoqëror e kulturor të vendit i vihen punës për një organizim të lëvizjes demokratike. Në këtë shquhen sidomos disa intelektualë demokratë, të cilët marrin iniciativën për të formuar në Gjirokastrë një shoqëri kulturore-arsimore e politike.

Ishte koha kur në këtë qytet kishin ngritur krye edhe punëtorët tipografë. Këta, në janar të vitit 1921 bëjnë një grevë, që zgjati afro dy javë. Me ta u bashkuan punëtorët rrobaqepës e këpucarë. Pronarët u detyruan që ndaj punëtorëve tipografë të bënin disa lëshime. Vetë shtypi lokal ishte i detyruar të shkruante se prefektura të mos mbështetej tek masat shtypëse administrative, se «as del, as ka hie puna me inat», duke dashur të tregojë se masat administrative nuk mund të sillnin asgjë tjetër veç acarimit të mëtejshëm të gjendjes.



Lokali i klubit të opingarëve «Shpresa».

Një nga organizatorët e kësaj shoqërie, Veli Hashorva, shkruante se «organizata dalkadal u rrit, u zgjerua dhe më pastaj mori emrin «Opinga»¹⁾. Ai tregon se «kjo organizatë luajti një rol të madh në luftën e rreptë që u hap bejlerëve dhe atyre që e pasonin».

Kundër «Lidhjes së bejlerëve dhe agallarëve» të Gjirokastrës, që kishte në krye Myfit bej Libohovën, në fillim të vitit 1920 veprojnë disa grupe të vogla demokratike si «Bruci», «Guna», «Vatra», të cilët u bashkuan më 1921 me shoqërinë e opingarëve

1) Kujtime të pabotuara «Të shkuara të paharruara». Stamboll, 21.10.1973, fq. 71. Originali në AQRPSSH.

«Shpresa». Në fillim kjo dukej si një klub, që më vonë mori formën e një shoqërie, ose organizate. Ky klub, sipas Veli Hashorvës, «u bë zëdhënës i një marrëveshjeje i shokëve që mendonin, bisedonin tok, punonin sëbashku»¹⁾. Nga ana tjetër klubi i opingarëve synonte ta drejtonte shtresën e vegjëlisë në rrugën e qytetërimit. Ai dhe organi i tij gazeta «Drita» kanë bërë një punë të madhe politiko-shoqërore, këmbëngulëse dhe konsekuente. Për këto dëshmojnë shkrimet e gazetës, si dhe vetë materialet dokumentare që disponon lidhur me përparimin shoqëror dhe me luftën kundër bejlerëve dhe synimeve grabitqare të imperializmit italian në Shqipëri.

Njëkohësisht klubi i opingarëve «Shpresa», të cilit patrioti Idris Guri i kushton edhe një punim me dru me inicialet Sh.P.R.E.S.A.²⁾ (Shpresa) i ka bërë një luftë të vendosur kreut të reaksionit Mufit bej Libohovës, qëndrimin të tij armiqësor ndaj Kongresit të Lushnjës, dhe ndaj Luftës së Vlorës.

Gazeta «Drita» demaskonte në faqet e saj Mufit bej Libohovën, duke shkruar se kundra tij është shumica e popullit, sikurse përball Esat pashë Toptanit etj. Lidhur me këtë gazeta «Drita» vërteton se urrej-tja për Mufit beun nuk «është për shkaqe personale»³⁾. Organi i «Opingarëve» demaskonte beun për qëndrimin ndaj lëvizjes patriotike e demokratike, ndaj Çerçiz Topullit, Avni Rustemit dhe patriotëve të tjerë që luftonin për mëmëdheun dhe për vegjëlinë.

1) «Të shkuara të paharruara». Stamboll 1973, fq. 74, vepër e cituar.

2) Fondi QKMGJ.

3) Gazeta «Drita». Gjirokastër, 10 shkurt 1921, fq. 3.

Urrejttja ndaj «Lidhjes së bejlerëve dhe agallarëve» paraqitet e qartë veçanërisht gjatë fushatës elektorale të vitit 1921. «Opingarët me shkrimet e tyre ngrihen kundër beut dhe klikës së tij që edhe pas largimit nga Shqipëria të pushtuesve italianë, ata vazhdonin të përkrahnin politikën imperialiste pushtuese italiane, se «Mufit beu duhesh të ndihmohej, të ishte ministër, deputet në Shqipëri etj.» se përndryshe sipas tyre «Shqipërinë do ta merrte lumi»¹⁾.

Këto këshilla, organi i klubit të opingarëve i hidhte poshtë me neveri, duke demaskuar rëndë agjentët dhe sahanlëpirësit e pushtuesve italianë.

Intelektualë përparimtarë, zejtarë, nëpunës të vegjël, patriotë të mbledhur rreth këtij klubi mundohen e punojnë kundër influencës së beut të Libohovës. Ata e luftonin atë si çifligar, si pronar tokash, si element antikombëtar, që vazhdimisht ishte treguar një agjent i imperializmit italian, duke deklaruar se «ishte i gatshëm të bashkonte Gjirokastrën me krahinën e Puljes, po të ishte se Italia nuk do ta bashkonte atë me Durrësin»²⁾.

Shoqëria e opingarëve u aktivizua dhe pati rezultate të mira gjatë fushatës elektorale në vitin 1923. Ata përpiqeshin të bindnin zgjedhësit që votat të mos i jepnin për bejlerët e agallarët po për ata që punonin e mendonin për vegjëlinë, për të mirën e kombit shqiptar, për përparimin e tij.³⁾

Gazeta «Drita» dhe shtypi tjetër përparimtar

1) Gazeta «Drita». Gjirokastër, 3 shkurt 1921, fq. 4.

2) Fondi QKMGJ, (Dosja nr. 1).

3) Jorgji Meksi. Gazeta «Labëria». Gjirokastër, 4 Vjeshtë e dytë 1925.

demaskonin ashpër Mufit beun, megjithëse atë e përkrahnin fuqimisht parësia dhe klerikët, fetarët e lidhur ngushtë me të. Krijimi i një blloku popullor gjatë fushatës elektorale bëri që ajo (shoqëria) të fitojë më shumë vota.

Në fushatën elektorale të vitit 1921 e 1923 morën pjesë një numër i gjerë patriotësh e demokratë të rinj, intelektualë rapsodë popullorë që nëpërmjet vargjeve demaskonin bejlerët, agallarët dhe qëllimet e tyre antipopullore.

Ja, një ndër këto vargje popullore:

*Urra, urra, urra
Opinga përmbi ta*

ose

*Barku firë (bosh) kërcen mirë
Barku plot s'kërcen dot.*

Nëpërmjet këtyre vargjeve bëhet aluzioni se fuqia e «opingës» bënte që reaksionarët të dështonin, se barkzbrazurit «do të dijnë të heqin «valle» më mirë, të kërkojnë të drejtat e mohuara me guxim e trimëri, se «barkmëdhenjtë» nuk mund të mateshin dot me ata me «barkunfirë».

Puna politike e bindëse, debati, kënga, ndihmuan në fitoren e «opingarëve». Beu i Libohovës, i mundur në votime, largohet nga Gjirokastra dhe shkoi u mbyll në shtëpinë e tij në Libohovë. Gjirokastra e vegjëlisë i tregoi hapur se «Shqipëria nuk është çifligu i tij»¹).

1) Jorgji Meksi. Gazeta «Labëria», Gjirokastër, 4 Vještë e dytë 1925.

Fitoren e «opingarëve» në fushatën elektorale e përshëndetën demokratë revolucionar si Halim Xhelua nga Vlora, duke e uruar klubin e opingarëve «Shpresa» për «triumfin e tij»¹⁾.

Shenja e «opingës» mbahej jo vetëm si distinktiv nga anëtarët e klubit, por vendosej edhe në mjettet e udhëtimit të «opingarëve», kur ata shkonin nga një vend në tjetrin. Kjo shenjë u vriste sytë kundërshtarëve politikë të këtij klubi.

«Opingarët» u përpoqën të ngrenë shtresat e popullit kundër klikës së tregtarëve, të feudalëve, si edhe kundër vetë kryetarit të bashkisë së qytetit Javer bej Hurshitit²⁾.

«Opingarët» punojnë me ngulm veçanërisht gjatë fushatës elektorale të vjeshtës 1923. Në këtë periudhë bëhen debate të fuqishme midis demokratëve dhe «Lidhjes së bejlerëve dhe agallarëve». Me këtë rast përpara popullit të Gjirokastrës më 26 gusht 1923 mbajti një fjalim të zjarrtë Fan S. Noli. Ai i bëri thirrje popullit të votonte për grupin demokrat. Fjala e tij, e cila zgjati mbi një orë, u dëgjua me vëmendje të madhe nga pjesëmarrësit duke lënë tek ata mbresa të pashlyera. Mitingu, ku foli Fan S. Noli ishte organizuar nga klubi i opingarëve «Shpresa».

Pas fitores së Revolucionit demokratiko-borgjez anëtarët e klubit të «opingarëve» e shtojnë aktivitetin e tyre revolucionar. Ata organizojnë protesta kundër «Lidhjes së bejlerëve dhe agallarëve», kundër vetë Mufit bej Libohovës, duke kërkuar dënimin e këtij të fundit.

1) Gazeta «Drita», Gjirokastrë, 27.3.1921.

2) Përfundoi si tradhtar dhe u pushkatua në prill 1945

Këtë protestë të «opingarëve», që ngrihen kundër «tolerancës ndaj bejlerëve, e cila do ta shpjerë vendin përsëri në greminë», e nënshkruajnë rreth 150 veta nga qyteti i Gjirokastrës dhe nga fshatrat e saj. Midis këtyre janë Andon Boshnjaku, Halil Hoxha, Dhimo Papajani, Mehdi Baboçi, Mehmet Shkurta, Sefer Koçi, Sami Dalipi, S. Krishti, Asim Mero, Hasan Xhiku, Dine Qadhini, Athanas Boshnjaku, Maliq Hajro, Qazo Puto, Duro Tabaku, Shemsho Hajro, Hysni Babameto, Nesip Kore, Mehmet Angoni, Isuf Dhrami, Selami Vehbi, Siri Karagjozi etj. etj.¹⁾

«Opingarët» me anën e mitingut dhe të protestës së tyre kërkonin nga qeveria e Fan S. Nolit që të përdorte dhunën kundër bejlerëve dhe agallarëve. Organi i klubit të opingarëve «Shpresa» kërkonte që qeveria e Nolit të merrte masat e duhura, duke shkruar «se qeveria e re duhet të dijë që puna e suksesit të revolucionit nuk ishte aq e zorshme, sa ishte mbajtja e situatës dhe shfrytëzimi i kryengritjes në mënyrën e duhur»²⁾.

Lëkundjet dhe mosbesimi në forcat popullore bënë që qeveria e Fan S. Nolit të karakterizohej nga një plogështi e rëndë, nga mospërdorimi i dhunës revolucionare, në çastin e duhur, kundër armiqve.

Klubi i opingarëve «Shpresa» mbetet si një tribunë e edukimit demokratik të shtresave të ulëta qytetare, që dha kontributin e tij në luftën kundër feudalizmit, klub që punoi për demokratizimin e jetës së vendit, që doli hapur kundër bejlerëve dhe shfrytëzimit feudal.

1) «Drita». Gjirokastrë, 19.VI.1924, nr. 174, fq. 2.
2) Gazeta «Drita». Gjirokastrë, 21 gusht 1924.



Enver Hoxha, ish sekretar i Shoqërisë «Studenti»

SHOQËRIA «STUDENTI»¹⁾

Përfaqësuesit më luftarakë të «djalërisë së vojtur» të viteve 1920, ku dallohej studenti Enver Hoxha i Liceut të Gjirokastrës, më 7 korrik të vitit 1924, në kushtet e krijuara nga Revolucioni demokratiko-borgjez i Qershorit themelojnë shoqërinë e tyre «Studenti». Kjo u ngrit në afërsi të kodrës historike të qytetit, plot tradita e kujtime, 14 shkallë më sipër nga dhoma ku Çerçiz Topulli me shokë kishin themeluar shoqërinë «Kandile» më 1909,

U ngjiten këta të rinj entuziastë përmbi «Kandilen», nëpër një shkallë, për të themeluar këtu një si shtëpi kulture. Një dhomë e vogël ishte kjo, ku do të punonin me gjallëri të 50 anëtarët e saj të parë, dhomë me dy ballkone anash, njëra nga Qafa e Pazarit dhe nga Kalaja, tjetra nga ana perëndimore. Çerdhen e tyre këta studentë e ngritën përmbi zemrën e tregut, aty ku njerëzit e shtresës së varfër dergjeshin duke kërkuar punë, qëndronin në këmbë ose ulur në pezulë, ndërsa këmbë mbi këmbë.

1) Kopertina e shoqërisë ka këtë titull në origjinal: «Statuti i Shoqërisë studente Gjirokastra» 1925, faqe gjithsej 8, datë 19.7.1924.

përpara dyqaneve qëndronin agallarët dhe fajdexhinjtë.

Djalëria gjirokastrite e viteve 1920-24 e frymëzuar nga traditat patriotike të kohës së lavdishme të popullit tonë, nga lufttrat kundër turqve dhe pushtuesve të tjerë, u organizuan në shoqërinë «Studenti», e cila i vuri vetes si detyrë të thellonte akoma më tepër këto tradita patriotike dhe të luftonte për liri e përparim.

Shoqëria «Studenti» doli me një program pune më të zgjeruar, për reforma shoqërore. Vetëm një broshurë prej 8 faqesh është statuti i shoqërisë «Studenti», por aty pasqyrohet shqetësimi i djalërisë, shpirti i saj luftarak, etja për përparim, hartuar nga të rinj revolucionarë si Enver Hoxha me shokë. Rreth 50 ishin anëtarët e parë të shoqërisë, por këta çanë një rrugë të re në jetën e Gjirokastrës, thelluan më shumë një traditë, që i kishte rrënjët që në fillim të këtij shekulli.

Anëtarët e shoqërisë «Studenti», sikurse e shohim në nenin e parë të statutit, janë të vendosur për ndryshimin e gjendjes shoqërore në Shqipëri. Ata shkruajnë, qysh në fillim «se shpallin shoqërinë në qytetin e Gjirokastrës pas nevojës së pamohuar të vojtjes shoqërore të studentëve gjirokastritë përgjithësisht»¹).

Qëllimin e shoqërisë, këta studentë energjikë e tregojnë në nenin e dytë të statutit ku thuhet se «shoqëria ka për qëllim të sjellë bashkimin midis studentëve shqiptarë brenda dhe jashtë qytetit»²). Kë-

1) Statuti i Shoqërisë studente Gjirokastra, fq. 3.

2) Po aty.

tu del qartë se shoqëria nuk kishte karakter lokal, se ajo mendonte të punonte për bashkimin e studentëve edhe në rrethe të tjera të vendit. Njëkohësisht ajo i vinte detyrë vetes të punonte për zhvillimin e sportit, duke ndjekur traditën e krijuar veçanërisht nga Avni Rustemi, i cili në korrik 1921, kishte ngritur në Gjirokastrë «Lidhjen e mësuesve» që synonte edhe për zhvillimin fizik të djalërisë, të mësuesve të rinj, për zhvillimin e notit, të gjimnastikës dhe të qitjes me armë. Njëkohësisht shoqëria «Studenti» ecte në rrugën e shoqërisë «Vëllazëria» që hodhi baza qysh më 1919 për muzikën në Gjirokastrë. Kjo shoqëri u bë bosht i rëndësishëm për të ngritur një teatër me vlera edukuese në Gjirokastrë dhe në rrethe të tjera të vendit.

Në nenin e gjashtë bëhet fjalë për të ngritur një «bibliotekë me libra shqip e të huaja», duke ecur kështu në traditën e krijuar nga shoqëria «Drita», e cila në prill 1923 kishte ngritur një të tillë.

Biblioteka e shoqërisë «Studenti» e ngritur në vitin 1924 ishte njëkohësisht një mjet për bashkimin e studentëve, në mënyrë që këta të mbledheshin, të njiheshin, të bashkoheshin, të shtronin mendime.

Në nenin e shtatë të shoqërisë vihet si detyrë që anëtarët e saj, të ishin shembull «brenda dhe jashtë shoqërisë», sepse kështu ngrihej lart figura e anëtarit të saj. Ky nen drejtohej kundër disa anëtarëve të ish-shoqërive të vjetra të cilët ishin elementë karrieristë e arivistë, që nuk punonin sa duhet për të ruajtur dinjitetin dhe pastërtinë e anëtarit të këtyre shoqërive demokratike.

Për të ruajtur pastërtinë e radhëve të saj në ka-

pitullin e 11 të statutit del se kjo pranonte «anëtarë veprues vetëm studentët»¹). Njëkohësisht aty i jepet rëndësi e veçantë disiplinës. Kështu, një anëtar i veprues, në qoftë se nuk do të merrte pjesë në tri mbledhje i hiqej vërejtje, bile deri në përjashtimin nga radhët e saj. Në nenin e dhjetë të statutit parashikohej ndalimi që në mbledhjet e përgjithshme të marrin pjesë të jashtëmit. Statuti parashikonte që «ankimet e çdo anëtar i të paraqiten në këshillin e shoqërisë me shkrim, ndryshe këshilli i shoqërisë nuk e merrte parasysh». Parashikohej që zgjedhjet e shoqërisë të bëheshin dy herë në vit, me 10 korrik dhe me 20 shtator.

Rëndësi e posaçme u jepej vendimeve kolegjiale, duke caktuar në statut, se për të rrëzuar një pikë të tij kërkoheshin 3/4 e votave të pjesëmarrësve në atë mbledhje.

Statuti lejonte që anëtarë të tij të largoheshin nga shoqëria «për shkaqe familjare ose financiare» dhe këta «të mos përjashtoheshin nga shoqëria»²).

Në kapitullin e tretë flitej për detyrat e çdo anëtar, thuhej se «kryetari ka të drejtë të bëjë mbledhje të jashtëzakonshme, kur ka ndonjë mosmarrëveshje ose ndonjë ngjarje të papritur». Kryetari ngarkohej me detyra të rëndësishme. Ai duhej të përgjigjej për mbajtjen e rregullit në shoqëri dhe për përparimin e shoqërisë. Për punë sistematike dallohen kryetarët e shoqërisë Aqif Selfo, Elmas Konjari. Këta studentë të rinj 15-17 vjeçarë e ndjenin përgjë-

1) Statuti, fq. 4. (Originali ndodhet në Fondin e QKMGJ.).

2) Statuti, fq. 5.

gjësinë dhe vepronin si burra të pjekur, si patriotë të vërtetë, nga të cilët u frymëzuan në atë periudhë edhe të moshuarit. Ata të rinj tregonin kujdes të madh për kulturën, muzikën, traditat, respekt dhe nderim për patriotët që kishin dhënë jetën ose kishin bërë sakrifica për atdheun.

Statuti i jepte rëndësi administrimit të shoqërisë dhe me këtë detyrë ngarkohej sekretari i saj, ndërsa për arkëtarin kërkohej të ishte «njeri i besës». Parashikohej që çdo anëtar veprues të kontribuonte në arkën e shoqërisë. Edhe në punën e kuotizacionit kishte disiplinë të fortë, duke parashikuar përjashtimin e anëtarit që nuk paguante kuotën e caktuar për dy muaj me radhë.

Statuti kërkonte që të drejtën e votës ta kishin vetëm ata që do të merrnin pjesë në mbledhje. Pjesëmarrja në mbledhje ishte e detyruar¹⁾.

Në pranimin e anëtarëve, shoqëria kishte vënë disa kërkesa të drejta, që ajo i zbatonte me rreptësinë më të madhe. Pranohehin anëtarë nderi vetëm njerëzit korrektë, për të ruajtur kështu pastërtinë në radhët e saj. Këta anëtarë nderi nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në punën e anëtarëve veprues.

Nga statuti dhe nga vetë forma e vulës, stamposur nëpër librat e bibliotekës së shoqërisë «Studenti» njihemi me simbolin e saj: një libër i hapur dhe anash data 7 korrik 1924 (dita e themelimit të shoqërisë).

Statuti i shoqërisë «Studenti» përcaktonte numrin e anëtarëve të këshillit që përbëhej prej tetë vetash: kryetari, sekretari, arkëtarë dhe pesë këshill-

1) Statuti, fq. 6.

tarë. Ai përcaktonte gjithashtu se anëtarët e Shoqërisë «Studenti» nuk mund të ishin njëkohësisht edhe anëtarë të ndonjë shoqërie tjetër që mund të formohej në Gjirokastrë.

1) Aty përcaktoheshin ndihmat që do të kërkonte Shoqëria nga trupi mësimor i liceut të Gjirokastrës, e që ishin morale e materiale.

Në statut nuk mungonte të pasqyrohej edhe shqetësimi për fondin e saj dhe shënohej se të hollat e arkës së shoqërisë «të destinoheshin për një bandë muzikore, për të cilën punonte shoqëria, duke patur si një synim kryesor edhe zhvillimin e muzikës»¹⁾.

Këta studentë punonin plot pasion edhe natën. Shoqëria i dha hov muzikës, krijoi mandolinatën, nën tingujt e ëmbël të së cilës liceistët këndonin me pasion himnin e Flamurit, e këngë të tjera patriotike.

Veprimtaria e shoqërisë në fushën kulturore e artistike rritej vazhdimisht, me gjithë mungesat e pengesat e shumta. Vullneti, durimi, pasioni i këtyre studentëve bënte që puna të shkonte vazhdimisht përpara, aq sa vetë mësues përparimtarë shkruanin për forcimin e përparimin e shoqërisë, për sukseset që kishin njerëzit e rinj e të ditur të Gjirokastrës. Elementi përparimtar i qytetit, pesë muaj pas themelimit të shoqërisë «Studenti» konstatonte me kënaqësi se si «brenda një kohe të shkurtër shoqëria tregoi një përparim të çudiçim»²⁾.

Shoqëria pati ndihmën e patriotëve demokratë si Dine Qadhimi fotograf plot pasion. Ky njeri i

1) Statuti, fq. 8.

2) «Drita», 6.12.1924.

varfër e shëndetlig, por me ndjenja të pastërta u bë regjisor i shoqërisë «Studenti». Kjo ishte një provë tjetër e përkrahjes që pati shoqëria edhe nga elementët më përparimtarë të qytetit.

Aktivitetet e shoqërisë «Studenti» nuk kishin vetëm karakter të mbyllur kulturor. Ato ishin në radhë të parë aktivitete politike, ku mbahej ndezur sidomos prushi i patriotizmit, i urrejtjes dhe i luftës kundër regjimit.

Kjo veprimtari del e gjallë në nderimin dhe respektin që shoqëria ka për patriotët dhe luftëtarët e lirisë.

Vullneti, aftësia, talenti në fushën e teatrit u duk veçanërisht në komedinë «Lojnat e studentit» që u dha më 24 gusht 1924 në Gjirokastrë, «ku muarjnë pjesë si aktorë Enver Hoxha, Selami Xhaxhi, Vehap Ciu, Naxhi Totozani, Reshat Toto, Fejzi Hoxha etj. Shfaqja u dha edhe për gratë dhe pati sukses, ajo u pëlqye shumë nga spektatorët artdashës gjirokastritë»¹).

Duke u bashkuar me përpjekjet e mjaft patriotëve përparimtarë që punonin për çlirimin e gruas nga «qefini për së gjalli», në të cilin ishte e detyruar të mbështillej ajo nëpër dekada, shoqëria «Studenti» jep shfaqje për gratë e mbyllura brenda katër mureve të shtëpisë gjithashtu. Me anën e këtyre shfaqjeve ajo u dha një grusht të fortë elementëve konservatorë e prapanikë, që e kishin halë në sy emancipimin e gruas shqiptare, e që nuk linin dy gurë bashkë për të penguar e për të mbytur që në vezë çdo përpjekje në drejtim të përparimit të saj.

1) Aqif Selfo, Revista «Nëntori» nr. 7. 1977, fq. 63.

kundër saj, sidomos kur shoqëria «Studenti» krijoi marrëdhënie me shoqërinë «Lidhja e punëtorëve» të Gjirokastrës.

Regjimin e shqetësonte shumë ekzistenca e shoqërisë «Studenti», prandaj ai kishte vendosur ta likuidonin me forcë këtë qendër përparimtare.

Tani sekretari i shoqërisë është i riu Enver Hoxha, i cili dallohet për veprimtarinë e palodhshme në dobi të shoqërisë. «Personaliteti i shkëlqyer i këtij djaloshi, dora dhe zëri i tij energjik, ishin ndjerë me kohë brenda dhe jashtë shkollës, duke merituar simpatinë e të gjithëve. Që në ceremoninë e mbarimit të vitit të parë, ai u ngrit dhe përshëndeti në emër të studentëve. Sigurisht kjo nuk ishte një rastësi»¹).

Sekretari i shoqërisë, Enver Hoxha, dallohet si aktivist shoqëror, si aktor në shfaqjet patriotike, duke zgjedhur për personazhe kujtimin e trimave si Çerçiz Topulli. Edukata familiare që kishte marrë qysh i ri e kishin brumosur sekretarin e shoqërisë për «t'u bërë një luftëtar i zjarrtë për mbrojtjen e çështjes së madhe të popullit, të vegjëlisë, për t'i shërbyer Atdheut, Shqipërisë»²).

E panë këtë veprimtari patriotët, e çmuan demokratët e Gjirokastrës dhe e vlerësuan si një veprimtari patriotike të shkëlqyer. Kronisti i atyre kohëve që parashikonte një të ardhme të ndritur të sekretarit të shoqërisë «Studenti» arriti të shkruajë se këta «ishin udhëheqës të gjeneratës së re»³).

1) Haki Toska. Gazeta «Pararoja», 14 nëntor 1973, fq. 3.

2) Po aty.

3) «Drita», Gjirokastrë, 6.12.1924.

Megjithë kufizimet që iu bënë kësaj shoqërie nga ana e regjimit, ndjekjet e presionet, ajo pati një përparim dhe ndikoi mjaft për atë periudhë në rezistencën kundër regjimit obskurantist. Xhandarmëria dhe prefektura e Gjirokastrës ndiqnin këmba-këmbës punën revolucionare të shoqërisë dhe bënë gjithçka për t'i prerë asaj hovin. Por kur panë se kjo nuk mund të arrihej me mjete legale organet e qeverisë së Zogut në Gjirokastrë hidhen kundër saj. Regjimi e luftoi atë si një qendër të rëndësishme patriotike, përparimtare, antizogiste dhe për këtë arsye qeveria e Zogut më 1925 e mbylli shoqërinë «Studenti». Pas tre vjetësh, më 1928, e mbylli me forcën e bajonetës edhe vetë liceun.

Elementi armik i çdo përparimi vendosi mbylljen e shoqërisë së studentëve, për të cilën shoku Enver Hoxha shkruan se «regjimi obskurantist zogollian po tregonte me vepra fytyrën e tij antipopullore e antikombëtare»¹⁾.

Por edhe pse shoqëria u mbyll studentët më energjikë, ish-anëtarët e saj, ish-drejtuesit e saj, nuk e ndërprejnë aktivitetin e tyre. Flasin për këto protestat e organizuara nga ish-anëtarët e shoqërisë në gusht-shtator të vitit 1928, për të kundërshtuar mbylljen e liceut të qytetit. Midis 67 studentëve gjirokastritë të revoltuar nga masat që po merrte regjimi për të mbyllur të vetmen shkollë të mesme të Gjirokastrës, ishte edhe nënshkrimi i ish-sekretarit të shoqërisë Enver Hoxha, që midis të tjerave i drejtohet me këto fjalë plot urrejtje qeverisë së Ahmet Zogut: «Duam të shpëtojmë nga katastrofa e mbylljes

1) «Pararoja». Gjirokastrë, 14 nëntor 1973, fq. 2.

së shkollës sonë... Të anulohet vendimi që është vendim shkatërronjës, dënim me vdekje për brezin e ri dhe shtytje e popullit në errësirën e paditurisë»¹⁾.

Vijoi të punojë në këtë drejtim ish-sekretari i shoqërisë «Studenti» edhe katër vjet pas mbylljes së liceut dhe shtatë vjet pas mbylljes së shoqërisë «Studenti». E provon këtë fjala plot zjarr revolucionar e shokut Enver Hoxha në 14 gusht 1932 në këmbët e kodrës së bregut të Hazmuratit, duke thënë midis të tjerave në varrin e një ish-anëtari të shoqërisë «se atë mortja e zezë e rrëmbeu në kohën e djalërisë, në moshën kur mendja e tij do t'i shërbente atdheut dhe njerëzimit»²⁾, duke treguar si shëmbull punën e studimit e këtij anëtari të shoqërisë «Studenti», si model i veçantë për rininë që tretet si qiriri dhe vdes thëror i mësimi për të mirën e njerëzimit»³⁾.

Tetë vjet pas mbylljes së liceut dhe njëmbëdhjetë vjet pas mbylljes së shoqërisë «Studenti», përsëri ish-sekretari i saj Enver Hoxha, ngrihet e flet kundër gjendjes së krijuar në Shqipëri në vitin 30, kur regjimi i «dyerve të hapura» u kishte lënë dorë të lirë fashistëve të Musolinit në vendin tonë, disa vjet përpara se Shqipëria të pushtohej prej tyre më 7 prill 1939.

Edhe në Gjirokastër, elementët revolucionarë të saj që studionin si brenda, ashtu edhe jashtë Shqipërisë, në bashkëveprim me militantë komunistë si Ali Kelmendi, internuar në vitin 1936 në Gjirokastër, punojnë në drejtim të ngritjes së popullit kundër re-

1) 40 vjetori i Gjimnazit «Asim Zeneli» (1923-1963) Gjirokastër 1963, fq. 53-54.

2) Gazeta «Demokratia». Gjirokastër 2 gusht 1932.

3) Po aty.

gjimit antipopullor. Veprimtari të rëndësishme zhvillon në Gjirokastrë studenti Enver Hoxha, kur vjen këtu gjatë pushimeve verore. Ai punon për përhapjen e ideve revolucionare midis rinisë, zejtarëve, intelektualëve patriotë etj.

Në vitin 1935, shoku Enver Hoxha kthehet nga Franca në Shqipëri, dhe në korrik 1936 zhvillon në Gjirokastrë një punë politike më të hapur e më të organizuar, duke bërë takime me Ali Kelmendin e një numër studentësh, brenda e jashtë qytetit¹⁾.

I rëndësishëm është fjalimi që ai mban më 26 korrik 1936 mbi varrin e Bajo Topullit, me rastin e gjashtë vjetorit të vdekjes së patriotit. Në këtë fjalim revolucionar e antizogist, shoku Enver Hoxha ngriti lart veprën e patriotit dhe të kryekomitetit Bajo Topulli. Fjala e tij ishte një program pune jo vetëm për djalërinë shqiptare, por edhe për mbarë popullin shqiptar.

Në këtë fjalim historik shoku Enver Hoxha ngriti problemin se lufta për përparimin e vendit duhej të mbështetej kryesisht te djalëria, e cila është gati të sakrifikojë gjithë gjakun e zemrës për mbarëvajtjen dhe përparimin e Atdheut. Fjalimi i tij i bënte thirrje djalërisë, e cila «nesër a pasnesër do të ketë fatin të qeverisë tokën arbërore». Fjalimi i tij frymëzohej nga lufta e patriotëve revolucionarë, duke u zotuar mbi varrin e heroit të popullit Bajo Topulli se «djalërisë nuk do t'i mungojë as vullneti dhe as kurajua, kur ka për të ardhur puna që të përgatitim një Shqipëri të lumtur e të begatshme»²⁾.

1) «Pararoja». Gjirokastrë, 27.7.1977.

2) Fondi i Muzeut të Luftës Nacionalçlirimtare të ish-qarkut të Gjirokastrës.

SHOQËRIA «SHKËNDIJA» NË LIBOHOVË

U formua më 1920 në një periudhë kur në Gjiro-kastër e në visë të tjera të Atdheut, zhvillohen përpjekje të shumanshme për forcimin e arsimit kombëtar. Anëtarët e saj ishin nxënës të shkollës gjashtë-klasëshe të Libohovës, të cilët të frymëzuar nga veprimtaria patriotike e Avni Rustemit, hedhin hapat e para për një shkollë mikste (me djem e vajza).

Në Libohovë, elementi përparimtar bënte një punë të mirë për emancipimin e femrës, e cila hodhi tutje çarçafët e perçet brenda një kohe të shkurtër. Po kështu vepruan nën ndikimin e shoqërisë «Shkëndija» edhe vajzat e shkollës së Libohovës. Ajo i dha zhvillim teatrit, duke dhënë shfaqje me përmbajtje patriotike, të rinjtë u aktivizuan gjithashtu në sport, në lodra popullore.

Më vonë, kur revolucionari demokrat Avni Rustemi ngriti shoqërinë «Bashkimi», shoqëria «Shkëndija» u lidh me të dhe mori emrin «Dega e rinisë» e shoqërisë «Bashkimi».

«Shkëndija» që një shoqëri që frymëzoi rininë e Libohovës, e bashkoi pa dallim feje dhe ideje. Frytet e saj u dukën shpejt. Megjithëse nuk kishte veçse një vit që ishte formuar, më 28 nëntor 1921 ajo doli e bashkuar në një manifestim popullor, duke iu ku-

ndërvënë elementit konservator, klerikëve që me ungjill në duar, kërkonin të mashtronin masën e popullit. Përballë urdhërave të nënprefektit për të arres-tuar disa nga nxënësit, masa e këtyre përleshet me organet e pushtetit lokal¹⁾.

Nëpërmjet shoqërisë dhanë kontribut sidomos mësueset e para, aq sa afro 10 vajza e hodhën tutje perçen. Nën ndikimin e «Shkëndijës» u hoqën sarakët e hoxhallarëve, festet e kuqe etj.

Më vendosjen e diktaturës së Zogut, në dhjetor 1924, u ndoqën edhe më shumë antarët e shoqërisë «Shkëndija». Mufit bej Libohova si ministër i qeverisë së Zogut pengoi emërimin në punë të disave që ishin anëtarë të shoqërisë, duke marrë masa kundër tyre²⁾.

Anëtarë të kësaj shoqërie, në vitin 1927, kërkuan që fondi i saj «të vihej në dispozicion të shkollës së Libohovës për t'u përdorur për blerjen e mjeteve shkollore më të nevojshme dhe për të ndihmuar nxënësit më të vobektë³⁾. Ata ngulën këmbë që këto fonde të mos grabiteshin nga nëpunësit e administrasë së Ahmet Zogut. Populli, që kishte dhuruar këto fonde, mendonte që ato të përdoreshin për arsimin e fëmijëve të tij.

Shoqëria «Shkëndija», si edhe ajo me emrin «Vëllazëria», ku punoi veçanërisht dr. Sezai Çomo me shokë, i cili e përfaqësoi këtë edhe në Kuvendin e Vlorës, në prill 1921⁴⁾, dha një kontribut me vlerë në lë-

1) Kujtime nga një grup iniciatorësh të shoqërisë, botuar në «Mësuesi», 24 shtator 1975, fq. 4.

2) Gazeta «Mësuesi», 24 shtator 1975.

3) Fondi QKMGJ.

4) Po aty.

vizjen, demokratike të Libohovës. Që të dyja u lidhën me shoqërinë e Gjirokastrës, dhe u bënë mbështetje për një lëvizje demokratike të mëtejshme, për përparimin shoqëror.

Kjo lëvizje rritej dita-ditës, elementi më i shëndoshë i shkollës së Libohovës dha prova se ishte i gjallë, plot zell, që të shkonte përpara në çështjen e kulturës, të teatrit, të gjimnastikës etj.

Aty ndjehej fjala dhe shembulli i Avni Rustemit, i cili sikurse kudo në Shqipëri, kontribuoi shumë edhe në shoqërinë kulturore të Libohovës, duke forcuar njëkohësisht edhe radhët e shoqërisë «Vëllazëria»¹⁾.

1) Gazeta «Mbrojtja Kombëtare». Vlorë, 20.2.1920, Nr. 20.

«LIDHJA E PUNËTORËVE» NË GJIROKASTËR

Jeta e vështirë, mëditja e pakët, kushtet e këqia të punës, detyruan punëtorët e Gjirokastrës, sidomos ata të shtypshkronjës së shtetit të ngriheshin në grevë. Kështu ndodhi më 21 janar 1921. Si shkak për grevën shërbeu dëbimi nga puna e një shoku të tyre. Me grevistët e shtypshkronjës u bashkuan këpucarët dhe rrobaqepësit e qytetit.

Për të kërkuar të drejtat e mohuara punëtorët në Gjirokastrë mundohen të krijojnë organizatat e tyre. Ngjarjet e qershorit 1924¹⁾ i kishin nxitur ata të krijojnë një farë organizimi. Shpallja e programit të qeverisë së Nolit nxiti gjithashtu edhe kërkesat e fshatarëve dhe ato të qarqeve demokratike në qytet.

Pas ardhjes në fuqi të Ahmet Zogut me ndihmën e reaksionit të jashtëm e të brendshëm, përpjekjet e punëtorëve për të organizuar shoqëritë e tyre nuk u ndërprejnë. Kështu ndodhi në disa qytete të Shqipërisë si edhe në Gjirokastrë.

Në Gjirokastrë në fund të marsit 1925 u hodhën hapet e para për «Lidhjen e punëtorëve». Në këtë vit punëtorët e këtij qyteti themeluan «Lidhjen» e tyre.

1) Fitorja e Revolucionit të Qershorit.

Iniciativën për formimin e kësaj organizate e morën punëtorë e zejtarë.

Në Statutin e Lidhjes flitej për synime në fushën e kulturës, të teatrit, të sportit. Nuk liheshin mënjanë edhe problemet që kishin të bënin me vetë organizmin e punëtorëve, me shtresat e tjera punonjëse të qytetit, si me zjetarët dhe studentët.

Anëtarët e «Lidhjes» punuan rregullisht, por shoqëria nuk pati jetë të gjatë për të zbatuar qëllimet e saj në favor të punëtorëve e të zejtarëve të shfrytëzuar. Me ndërhyrjen e disa punëdhënësve që nuk i shikonin me sy të mirë këto shoqëri, pushteti zogist i qytetit e shpërndau shoqërinë. Organizatorët kryesorë të saj u ndoqën nga xhandarmëria.

Një meritë e madhe e «Lidhjes së punëtorëve» ka qenë fakti se ajo, «mbështeti studentët e persekutuar nga regjimi i Zogut, bile u bë një marrëveshje solidariteti midis tyre për ndihmë reciproke»¹⁾.

«Lidhja punëtore» u përkrah edhe nga elementi përparimtar i qytetit. Për këtë flasin disa shkrime me frymë përparimtare në shtypin e kohës, ku patriotë demokratë shkruajnë për gjendjen e krijuar, për hapat e para të një organizimi profesional të njerëzve që punonin e rropateshin tërë ditën.

Masat e egra kundër studentëve e punëtorëve tregonin hapur fytyrën e vërtetë antipopullore të regjimit të Zogut, që u mundua të shtypte çdo shenjë shoqërie ose organizate profesionale.

1) Fondi QKMGJ...

«LIDHJET» NË ISH-QARKUN E GJIROKASTRËS

Për mbrojtjen e interesave jetike të vendit, populli ynë krahas klubeve, komiteteve e shoqërive ka formuar edhe «Lidhje» të ndryshme, me të cilat ka synuar të bashkojë forcat patriotike e përparimtare në vitet 1906-1925.

Të tilla janë formuar edhe në ish-qarkun e Gjirokastrës. Ndër të parat është ajo që njihet me emrin «Lidhja e telegrafistëve të jugut», e cila u formua për të ndihmuar punën dhe veprimtarinë e çetave kryengritëse. Nga materialet historike del se ajo është themeluar fill pas formimit të Komitetit të fshehtë të Manastirit (1905). Kjo lidhje ndihmonte kryengritësit duke zbuluar lëvizjet ushtarake të armikut, vendimet e administratës turke që kishin të bënin me veprimtarinë kombëtare të çetave të para për t'ua transmetuar këtyre të fundit.

Në «Lidhjen e telegrafistëve të jugut» bëjnë pjesë telegrafistë në radhë të parë, nëpunës të vegjël, mësues etj. si p.sh. Neim Shaplllo, që punonte në Tepelenë, Shemsho Hajrua në Gjirokastrë, Haxhi Shaplllo në Leskovik, telegrafistë në Ersekë, shokë të besuar të Sali Butkës. Pjesëtarë të tjerë të kësaj «Lidhje» ishin nga Korça, nga Janina. Në «Lidhje» ishte edhe Musa Demi, megjithëse jo telegrafist.

Rëndësi të veçantë për lëvizjet e çetave ka patur Leskoviku për arsye se këtu bëhçj lidhja telegrafike e Korçës dhe e Gjirokastrës me Janinën¹⁾. Kjo Lidhje bashkëpunonte ngushtë me Komitetin patriotik të Gjirokastrës. Një pjesëtar i saj tregon «se detyra e deshifrimit ishte një punë sa e rëndë, aq edhe e rrezikshme. Askujt në telegraf nuk i bëhej fjalë për këto çështje përveç anëtarëve të Komitetit, që ishin në dijeni»²⁾. Nga vetë anëtarët e «Lidhjes së telegrafistëve» mësojmë se çdo natë, kur telegrafisti mbetej vetëm në dhomën e punës, nxirrte shënimet e marra nga qendrat e tjera, si dhe ato që jepnin ata dhe i deshifronte.

Pjesëtarët e «Lidhjes» tregojnë se në pranverën e vitit 1906 Sali Butka për të lajmëruar Haxhi Shapllon në Leskovic, që të njoftonte nisjen e Bajos dhe të Çerçizit nga Gjirokastra për në Butkë, bëri këtë lajmërim telegrafik: «Ato plaçkat e Gjirokastrës i dërgoni këtu».

Në kujtimet e tyre telegrafistët tregojnë se kur kishte ndonjë ngjarje të rëndësishme, atëherë ata vinin në dijeni Komitetin, pastaj lajmëronin menjëherë telegrafistin e Leskovikut. Kjo punë bëhej gjithnjë pas mesit të natës, meqënëse shumë stacione të tjera telegrafike kishin pushuar punën dhe natën vonë nuk kish njerëz të qeverisë nëpër këmbë, që të përgjonin lëvizjet. Telegrafistët patriotë vepronin me shumë kujdes, largonin çdo shpërndarës telegramesh, vetëm e vetëm që të ishin ata vetë në zyra dhe në

1) Fondi QKMGJ.

2) Shemsho Hajro, «Në gjirin e lëvizjes patriotike». Tiranë 1962, fq. 30.

raste të ndonjë telegrami urgjent ata i çonin vetë në familjet e ndryshme, duke kryer kështu edhe detyrën e shpërndarësit.

Nga fundi i vjeshtës të vitit 1907, komanda ushtarake e Janinës urdhëronte komandën vartëse në Gjirokastër, që të përgatiteshin dy batalione ndjekësish dhe pa vonesë të viheshin në gjurmët e kryengritësve, që vepronin midis Leskovikut e Ersekës, por anëtarë i «Lidhjes së telegrafistëve» vë në dijeni menjëherë kolegun e tij në zyrën telegrafike të Leskovikut dhe merr njoftim «që të mos bëheshin merak se punët venin mbarë dhe se kryengritësit ishin shëndosh e mirë».

«Lidhja e telegrafistëve» ishte një krah i djathtë i çetave, të patriotëve. Këta në male me armë, telegrafistët me morsin në duar, kontribuonin për ruajtjen e jetës së patriotëve, që kishin rrokur armët për lirinë e Shqipërisë.

Kontributin e dhënë nga «Lidhja e telegrafistëve» e çmonin vetë patriotët e vendit tonë, kryetarët e çetave, traditë kjo që vijoi edhe në rrethana e kushte të tjera.

«LIDHJA E GRAVE TË GJIROKASTRËS»

Shtypja shekullore e grave, mjerimi në të cilin jëtonin këto, ka bërë që herë pas here patriotët më të mirë, mësuesit, intelektualët popullorë të ngrihen, të flasin e të shkruajnë për të drejtat e tyre.

Këtë e vërejmë sidomos nga viti 1908, kur në një mbledhje për shkollën shqipe «Liria» u ngrit problemi edhe për diturinë e grave. Aty u fol se edhe gratë e vajzat gjirokastrite duhet të përfitojnë nga arsimi.

Këto forca përparimtare, në vitet 20-të ngrenë edhe më me forcë zërin për të drejtat e femrës së mjerë e të mbyllur brenda katër mureve si në një burg të përjetshëm, pa asnjë të drejtë.

Edhe qarkullimi më i zakonshëm i gruas apo i vajzës, vatja e tyre për vizitë familjare apo për të blerë diçka në treg konsiderohej si «turp» nga prapanikët e konservatorët. Megjithatë në vitet 20-të pati edhe gra përparimtare, si Urani Rumbolja me shoqe që u përpoqën t'i kapërcejnë këto pengesa dhe të luftojnë për çlirimin e gruas gjirokastrite.

Në gushtin e vitit 1920 u ngrit problemi i të drejtave të grave, organizimi i një shoqërie të tyre.



Urani Rumbo

Në diskutimet e bëra nga vetë gratë, të cilat kishin zgjedhur në krye të mbledhjes së tyre, mësuessen e palodhur Urani Rumbo, u ngrit qështja e formimit të një shoqërie të grave të Gjirokastrës. Nga mbledhja doli nevoja e një bërthame të tillë, e cila u quajt «Motrëmatë», emër ky që u propozua nga Urania dhe që u mbështet nga shumë shoqe të saj.

Por shpejt, pa kaluar as dy muaj, elementi konservator e prapanik i qytetit, kundërshtar i çdo përparimi shoqëror, bën një mbledhje si kundërpërgjigje të formimit të shoqërisë «Motrëmatë» ku u fol kundër organizimit të gruas, dhe u kërkua ndalimi i saj. Elementët reaksionarë arritën gjer atje, sa të pushonin nga puna kryetaren Urani Rumbo, si dhe disa mësuese në fshat, që ishin lidhur me të.

Të përkrahura nga shtypi përparimtar i qytetit, që veçanërisht në vitet 1920-1922 e më vonë punonte në drejtim të emancipimit të gruas, një muaj e pak ditë më vonë, në Gjirokastrë pas një mbledhjeje të grave, më 20 nëntor 1920, qarkullon një protestë e tyre, një lloj manifesti¹⁾, që kërkonte njohjen e të drejtave të tyre të mohuara. Manifesti fillon duke goditur mbledhjen e burrave reaksionarë e konservatorë, duke theksuar se edhe gruaja e Gjirokastrës është zgjuar tanimë, se ajo është frymëzuar nga ngjarjet e kohës, nga të zgjuarit e gruas në botë.

1) Gazeta «Drita». Gjirokastrë, 28 Vjeshtë e III 1920, fq. 2.

Në këtë mbledhje folën patriotët demokratë. Kështu p.sh. Veli Hashorva foli për të drejtat që duhet të kishte gruaja në shoqëri, dhe përkrahu iniciativën e Urani Rumbos me shoqe për nevojën e bashkimit të gruas, të arsimit dhe të daljes së saj në dritë. Jorgji Meksi midis të tjerave tha «se sa mund të ndalojë njeriu rrjedhjen e lumit, aq mund të ndalojë dhe përparimin e gruas në Shqipëri». Ndërsa Thoma Papapanua, mësuesi, që qysh më 1908, kishte folur në klubin «Drita» për nevojën e arsimit të gruas ngriti çështjen e një shkolle mikste, duke filluar nga fillorja. Ai përkrahu dëshirën e madhe të vajzave për të hyrë si mësuese në shkollat e qytetit e të fshatit. Përmendi shembulla të tjera mësuesesh përparimtare nga Libohova e nga Labova e madhe që kishin deklaruar se «ishin gati të bënin çdo therori për lulëzimin e Atdheut dhe për përparimin e qytetërimit në Shqipërinë e prapambetur».

Para mbylljes së kësaj mbledhjeje historike, që përfundoi me organizimin e «Lidhjes së grave», Urani Rumbo, kryetarja e saj midis të tjerave tha: «... Kjo gjendje e grave tona do të na shpjerë në greminë. Sa na kanë sharë ne burrat e Gjirokastrës¹⁾ aqë të mira paçim. Po ne do të përparojmë».

Urani Rumbo me plot besim në të ardhmen shtoi se «nuk do të jetë çudi që të shohim nesër a pasnesër midis leshshkurtërve edhe leshgjatat, të ngarkuara me një detyrë e me një soj pune që t'i shërbejnë njerëzimit dhe qytetërimit».

1) Ka parasysh elementin reaksionar.

Në fund Urani Rumbo tregoi se duheshin forcuar «zakonet e mira, të thithen ato si bleta, për plotësimin dhe mbaresën e detyrës së lartë që femra ka kundrejt shtëpisë, shoqërisë dhe mëmëdheut».

Tri detyra kryesore i caktoi Urani Rumbo gruas gjirokastrite dhe asaj të mbarë vendit tonë, detyrën për ta ngritur jetën familjare në një nivel më të lartë, detyrën për të punuar për ngritjen e shoqërisë së prapambetur shqiptare dhe detyrën ndaj mëmëdheut. Ajo ngrinte problemin se gruaja duhet edhe të punojë: a) si «mëmë», b) si «shoqe e burrit», c) si «ekonome», ç) si «anëtare e shoqërisë njerëzore»¹⁾.

Urani Rumbo, si organizatore e shfaqjeve teatrale me anën e nxënësve dhe tok me mësuesen Naxhie Hoxha, punon për përgatitje dramash e pjesë të tjera për skenën. Naxhie Hoxha penkthen nga gjuha e huaj dramën «Besnikëria e Medihasë», ku rolin e gjyshes së Medihasë e luante ajo vetë, Hasibe Hashorva rolin e nënës, rolin e Medihasë e luante një vajzë e re, nxënëse e shkollës femërore, ndërsa mësuesja Urani Rumbo luante rolin e të fejuarit.

Shikojmë se rolin e djemve e luajnë vetë vajzat. Këto shfaqje ndiqeshin me shumë interes nga gratë. Megjithëse pati edhe thashetheme kundër këtyre shfaqjeve, gratë përparimtare, që shënuam më lart, vijuan punën e tyre pa hequr dorë, sepse «e gjykonin dobinë e teatrit, sidomos për edukimin e ndjenjave patriotike»²⁾.

1) «Demokratia». Gjirokastër. 13 gusht 1927, fq. 2.

2) Revista «Shqiptarja e re», nr. 7, 1979, fq. 14.

Mësuesja patriotë Nexhie Hoxha shkruan se «me të hollat e mbledhura u blenë makina qepëse për të mësuar të qepnin e të qëndisnin vajzat e reja, sidomos ato të familjeve të varfëra të qytetit»¹).

Edhe shoqëria «Kundër Bastiljes» e grave gjirokastrite zhvillon një aktivitet për arsimin e vajzave dhe të grave. Në të marrin pjesë si anëtare nderi, redaktorë e drejtues gazetash si Veli Hashorva, mësuesit Thoma Papapano, Hysni Babameto etj. Këta të fundit në festa shkollore ngrinin nevojën e arsimit të femrës.

Nëpërmjet të shtypit përparimtar të qytetit ngrihej problemi së «nga mëm' e verbër nuk del dot pjellë e mirë»²). Interesim të veçantë tregon gazeta «Drita» e qytetit për problemin e shkollës femërore. Duke treguar gjendjen e atëhershme, kjo gazetë shkruan se «vajza gjirokastrite mbyllet në Bastilat e qytetit dhe zburgoset në kohën e martesës». Po dhe këtë «zburgerim», këtë dalje nga burgu ajo gazetë e quan të pamjaftueshme, jo të plotë. Gruaja e vajza përsëri, edhe pse është martuar, përshkruhet «verdhake, e zbehtë nga trupi e nga shpirti, për dëm të pallogaritshëm të fëmijës që do të rritë»³).

Duke luftuar prapambetjen shekullore, elementi përparimtar, që ishte lidhur ngushtë me shoqërinë «Kundra Bastiljes», kërkon që «Shqipëria evropiane gruan ta ketë si shtyllë graniti, mbi

1) Revista «Shqiptarja e re», nr. 7, 1979, fq. 14.

2) FQKMGJ. Dosja nr. 2.

3) Po aty.

të cilën të ngrejë godinën e saj». Synimi i elementit përparimtar ishte që «Shqipëria duhet zgjuar, lartësuar, arsimuar»¹⁾).

Nga ana tjetër u ndje nevoja për një gazetë të gruas, ku të rriheshin problemet e jetës së saj, ku të dilnin dëshirat dhe aspiratat e saj. Duke përkrahur e sjellë si shembëll botimin e një gazete të grave në Vlorë, shtypi i qytetit të Gjirokastrës tregon se kjo ishte një nder i veçantë për gjithë shqipërinë.

Shtypi i tërhiqte vëmendjen qeverisë së atëhershme për nevojën «që të çelij me të shpejtë shkolla për vajza» e duke kritikuar «zonjën qeveri», që nuk e ve aspak ujët në zjarr për këtë problem jetësor»²⁾).

Shoqëria filloi një debat të ashpër kundër rrymave reaksionare kundërshtarë që ishin kundër zbulimit të fytyrës së gruas, kundër çlirimit të saj shoqëror. Elementët prapanikë arritën gjer atje sa të shkruajnë në shtyp se gjoja, me rrugën e emancipimit të gruas, «i bëhej gropa Shqipërisë», se «gjoja vajtja e grave në teatër nuk bie përparim dhe liri po bie dëm dhe prostitucion»³⁾.

Diskutimi u ndez edhe më i zjarrtë kur reaksioni, edhe në Gjirokastrë, shtronte tezën e shtrembër, anakronike, bajatë se «gjoja nuk ishte koha» për të bërë reforma në këtë fushë, se «nderi në

1) Po aty.

2) Fondi QKMGJ.

3) Fondi QKMGJ.

Shqipëri është mbajtur dhe do të mbahet edhe pak kohë me tirani»¹⁾).

Shoqëria e grave ka merita, se ajo luftoi për barazinë e gruas me burrin, se nuk iu tremb syri nga obskurantizmi mesjetar, se i përplasi në fytyrë reaksionit fjalët e saj guximtare: «Nuk mund të përparojë një komb vetëm me diturinë e burrave»²⁾. Ajo ka meritën se doli me një zotim të prerë: «për të flakur tutje vendimet e obskurantizmit mesjetar, të reaksionit kundër grave»³⁾).

Njëkohësisht shoqëria, për hir të vendosmërisë së saj ka meritë tjetër: atë të vijimit të punës, të mbledhjeve në dasma ose kudo, duke dalë kështu hapur dëshira e saj, se ato nuk duhet të jenë si gratë e dikurshme, që takoheshin vetëm brenda mureve të shtëpisë, të familjes, prapa kafazeve të urryera, por se ato do të vijojnë të mbledhen edhe jashtë vatrës së tyre, jashtë katër mureve të shtëpisë.

Frutet e punës së shoqërisë duken sidomos në fushën e arsimit mikst, kur në nëntor të vitit 1923, bashkë me qindra djem gjirokastritë shkojnë në lice edhe vajzat e para të këtij qyteti.

Ndërkohë reaksioni, i tronditur nga puna dhe veprimtaria e grave gjirokastrite, e ndalon këtë shoqëri nga fundi i vitit 1923. Iu desh përsëri anëtareve të ish-shoqërisë të bëjnë përpjekje për të themeluar në korrik 1924 një shoqëri të re të emëruar «Përmirësimi». Me anën e kësaj shoqërie

1) Fondi QKMGJ.

2) Drita. Gjirokastrë, 28 nëntor 1920.

3) Po aty.

ato synonin të realizonin këto qëllime: a) përmirësimin e jetës familiare, b) lartësimin e gruas, c) organizimin e shfaqjeve teatrale, ç) luftimin e luksit në radhët e grave të parësisë, d) ngritje punishtesh për punë dore, dh) ngritje kursesh kundër analfabetizmit, e) mbajtje konferencash për higjienën.

Puna e zhvilluar dhe frutat e saj dhe gratë punuan me ngulm për të realizuar programin e caktuar, për të ngritur nivelin e gruas, për të luftuar analfabetizmin, për ta kthyer edhe teatrin në një shkollë edukimi patriotik edhe për gratë.

Shpejt edhe kundër kësaj shoqërie u ngritën elementët reaksionarë.

Këta edhe në shtyp kishin dalë hapur, duke akuzuar gruan që kërkonte lirinë e saj dhe duke e cilësuar të «çpërndëruar» etj. Fajdexhinj, pronarë, tregtarë të pasur, të bashkuar me qeveritarë antipopullorë, me nëpunës prapanikë, armiq të përparimit shoqëror, edhe kësaj here përpiqen me lloj-lloj mënyrash për të penguar ngritjen e shoqërive të grave. Nga ana tjetër ata përdoren çdo mjet për të mashtruar gratë e qytetit, duke hapur fjalë se gjoja mbledhjet e grave bëheshin për t'u marrë atyre «nga pesë napolona secilës që do të vente në këtë shoqëri».

Të gjitha këto shpifje të bëra nga armiqtë e emancipimit të gruas u luftuan ashpër nga shtypi dhe elementët progresistë. Shquhet në këtë drejtim sidomos Urani Rumboja, e cila me anën e shkrimeve, artikujve, poezive, brenda dhe jashtë shkolle, bën një luftë të madhe për emancipimin e gruas tok me nxënësit e saj. Ajo dhe shoqet

e saj këndonin në sheshin kryesor të qytetit këngë, që ishin thirrje për emancipimin e të rejave: «Zgjohu e mjera Shqipëri/ zgjohu të shohësh edhe ti liri». Nëpërmjet vargjeve e thirrjeve, Urani Rumboja mundohet të afrojë sa më shumë të reja në shkollë, dhe në shoqëri. Në lokalin e kësaj shoqërie ajo kishte shkruar në një faqe muri: «Gati, gati, gatitu bijë shqiptare/ me ushtrim stërvitu si trime shkollore/ mësoju o bijë, ki qytetërim/ lëvdoje Shqipërinë/ nga ti pret shpëtim».

Duke shkuar shtëpi më shtëpi, Urania kërkon që vajzat të ndjekin shkollën me çdo sakrificë, me qëllim që të ngrënë «mëmën e dashur që ka rënë përdhe/ se atë e ka plasur padija rrufe».

Veç shkollës, ku ajo punoi me dashuri të veçantë, Urania punoi me pasion e me aftësi edhe si vjershëtore, publiciste, regjisore teatri. Dorëshkrimet e saj të shumta, punimet si «Therorija e Efigjenisë», dialogët didaktikë, pjesët «Kuleta e kopracit», «Fiqtë», «Nipi i këpucarit», komedia «Dhëndër me përdhunë» etj. ishin një fushë tjetër e veprimtarisë së saj.

Plot emocione është përshëndetja e Urani Rumbos, kur ajo u largua nga Gjirokastra, me urdhër të qeverisë, sepse nuk shikohej me sy të mirë puna e saj. «Uroj të ta dëgjoj lart e më lart emrin tënd, vajzat dhe djemtë e tu të të lartësojnë, o Gjirokastër».

Ajo largohej nga Gjirokastra e saj e dashur plot optimizëm, me plot besim se «fara që mbolli me mundime e me pengesë do të lindte një ditë lulë për jetën e ardhshme».

Nga disa të dhëna të pakta, të shkruara nga

Urania del se «Lidhja e grave» bashkëpunoi me shoqëritë «Vëllazëria» dhe «Shkëndija».

Anëtare të shoqërive «Lidhja e grave», «Përmirësimi» etj., edhe pas vdekjes së Urani Rumbos (mars 1936), vijuan të ngrinin zërin për të drejtat e gruas gjirokastrite, të vajzës së qytetit dhe të mbarë vendit. Këto shoqëri patën ndihmën edhe nga elementët më të përparuar të qytetit të Gjirokastrës.

Por ato mbetën vetëm dëshira. Ëndrrat e patriotëve tanë, të nënave, të motrave, grave u realizuan vetëm pas triumfit të Revolucionit Popullor nën udhëheqjen e Partisë, ku gruaja i fitoi me gjak e sakrificë këto të drejta. Ajo sot është e barabartë me burrin në çdo fushë të jetës politike, ekonomike e shoqërore.

Fitorët e grave tona janë sanksionuar në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ku në nenin 41 thuhet: «Gruaja e çliruar nga shtypja politike dhe nga shfrytëzimit ekonomik, si forcë e madhe e revolucionit, merr pjesë aktivisht në ndërtimin socialist të vendit dhe në mbrojtjen e atdheut»¹).

1) Kushtetuta e RPSSH, fq. 25-26.


«LIDHJA E MËSUESVE»

«Lidhja e mësuesve» është krijuar më 25 korrik 1921. Krijimi i saj u bë i mundur në sajë të përpjekjeve të bëra nga mësuesit patriotë, me në krye Avni Rustemin. Më 17 korrik 1921 u bë mbledhja e parë, me pjesëmarrjen e mësuesve të Gjirokastrës, të Libohovës dhe të ftuar e të ardhut nga ish-qarku.

Me këtë rast u hartua një shpallje që u drejtohej gjithë mësuesve shqiptarë dhe veçanërisht atyre të Gjirokastrës. Ajo çmonte vlerën e detyrës së shenjtë të mësuesit, punën e tij dhe evidentonte mungesat e shumta që kishte ai në veprimtarinë e përditshme, sidomos gjendjen e veshtirë ekonomike etj.

«Lidhja» kishte gjithashtu si synim të mbronte të drejtat e secilit arsimtar dhe kërkonte të realizonte «një barabritje me mësuesit e botës së qytetëruar». Ajo luftonte për forcimin e radhëve të mësuesve në një organizatë të vetme.

Avni Rustemi, krahas punës për demokratizimin e jetës politike, punoi për «Lidhjen e mësuesve», duke folur e duke shkruar se «me mësonjësit demokratë do të hidhen bazat për një lëvizje demokratike në Shqipërinë e prapambetur».



Salla e lokalit «Lidhja e mësuesve», Gjirokastrë,

Jehona e krijimit të kësaj lidhjeje dhe puna që bëri ishte e madhe. Ajo u bë mbështetje e fuqishme për fushatën elektrorale të vitit 1923, për forcimin e klubeve dhe të shoqërive demokratike. Me punën e saj «Lidhja» mundi të ngrrejë nivelin politik e arsimor të mësuesve dhe të forcojë ndër-gjegjen e tyre. «Lidhja» organizoi grevat e mësuesve, zhvilloi debate për përparimin shoqëror, mbrojti klubet dhe shoqëritë ekzistuese dhe jo vetëm në Gjirokastrë, por dhe në Përmet, Tepelenë, Delvinë, Libohovë etj.

Me formimin në shtator 1924 të «Lidhjes së

përgjithshme të mësuesve», me kryetar mësuesin Kiço Konomin u bë e mundur të forcoheshin më mirë «Lidhjet e mësuesve» nëpër rrethet e vendit tonë.

Në janar 1925 me formimin e «Lidhjes së përgjithshme të arsimtarëve të Shqipërisë» kërkohet që kjo të mbronte interesat shoqërore të mësuesit, të përmirësojë gjendjen kulturore të mësuesit dhe ta bëjë mësuesin «burrë që të mos kërkojë meramet (mëshirë), por të kërkojë të drejtën, kur mbaron detyrën»¹⁾.

Në vitin 1925 regjimi i Zogut, sapo i vendosur, ndaloi veprimtarinë e «Lidhjes së përgjithshme të arsimtarëve të Shqipërisë», ndërsa mjaft arsimtarë patriotë demokratë i burgosi dhe i vrau për aktivitetin e tyre antizogist.

1) Gazeta «Liria», Tiranë, 6.12.1924.

RRETHET LETRARE

Një formë tjetër, e veprimtarisë patriotike në favor të zgjimit kombëtar, ishin edhe rrethet letrare, që u organizuan gjatë periudhës së Rilindjes sidomos në Janinë, Gjirokastrë etj. Këto rrethe përmblidhnin aktivistë të vjetër që kishin luftuar me kohë për çështjen kombëtare, patriotë të pushkës e të penës, si Bajo Topulli, Namik Delvina etj.

Në Gjirokastrë në janar 1909, u ngrit «Shoqëria Letrare» për mbrothësi të gjuhës, me iniciativën e klubit «Drita» të qytetit, ku mësues të shkollës shqipe «Liria» shtruan problemin e zhvillimit të gjuhës, të ndonjë botimi, të sigurimit të një shtypshkronje, për të botuar ndonjë gazetë politiko-letrare, ose ndonjë kalendar. Por këto përpjekje nuk patën sukses të plotë, mbasi për mungesë fondesh shtypshkronja nuk u suall dot nga jashtë. E vetmja gazetë që doli në vilajetin e Janinës ishte «Zgjimi i Shqipërisë» botuar në Janinë, dy herë në javë shqip-turqisht, dhe në të cilën punuan Nuçi Naçi etj.¹⁾

Një rreth letrar u ngrit në Janinë më 9 mars

1) Fondi QKMGJ.

1910 për gjuhë e për dituri. Kjo shoqëri u themelua me iniciativën e Bajo Topullit Gjergj Qiriazit, etj. Vetë Bajo Topulli, në një mbledhje të organizuar me rastin e themelimit, preku rëndësinë e saj. Hapat e para të shoqërisë ishin hedhur nga disa të rinj shqiptarë qysh më 1908. Ajo organizoi shfaqjet e para teatrale në Janinë, si ajo e shtatorit 1909, për të cilën shkruante edhe shtypi lokal¹⁾.

Shoqëria «Burimi» u formua në Lozanë të Zvicrës nga elementët e rinj, studentë si Avni Rustemi me shokë në vjeshtë të vitit 1913, shoqëri e cila u ngrit kundër feudalëve shqiptarë, për përparimin shoqëror, për arsimin laik, kundër skollave turke e greke, për një bashkim të studentëve shqiptarë jashtë Atdheut dhe për forcimin e lidhjeve të tyre.

1) Fondi QKMGJ.

SHOQËRIA «KASA E KURSIMIT PËR BUJQIT»

Në gusht të vitit 1921 Avni Rustemi organizoi në Libohovë një mbledhje me bujqit, në të cilën ngriti problemin agrar, duke folur edhe për shfrytëzimin e njerëzve që merrem me punimin e tokës¹).

Këtu Avni Rustemi tregoi nevojën e një organizimi në shkallë kombëtare të bujqëve dhe propozoi të ngrihet një shoqëri e cila të merrte emrin «Shoqëria Kasa e Kursimit për bujqit».

Ajo u ngrit në gusht të vitit 1921 dhe zhvilloi një veprimtari të dukshme sidomos gjatë viteve 1921-1923. Më vonë ajo pati një rënie për shkak të kërcënimeve të bëra nga Mufit beu që nuk lejonte qoftë edhe rezistencën më të vogël të bujqëve kundër shfrytëzimit feudal. Bile ai e konsideronte pronë të tij edhe ujin e burimeve të maleve të Libohovës²).

1) Në mbledhjen e Libohovës, Avniu kërkoi bashkimin e bujqëve. Aty nuk u bë ndonjë kërkese konkrete dhe as u ngrit çështja e ndonjë reforma të tokës, megjithëse ai dy vjet më vonë ngriti problemin agrar për zgjidhje në Asamblenë Kushtetuese. (Shpallja e grupit demokrat - Fondi i QKMGJ.)

2) Fondi i Muzeut të Luftës Nacionalçlirimtare të ish qarkut të Gjirokastrës.

SHOQËRIA «NJERIU I RI» NË PËRMET

U krijua në Përmet në vitin 1921. Në vitet 20 në Përmet ka patur një lëvizje të gjerë demokratike. Në këtë qytet, Avni Rustemi gjeti shokë dhe bashkëpunëtorë. Këtu ai ndikoi në formimin e shoqërisë «Njeriu i ri», të cilën Avniu e përfaqësoi vetë në bashkimin e shoqërive në Vlorë, për ngritjen e federatës «Atdheu».

Miq të vendit tonë si Justin Godard, flasin më 1921 me simpati për këtë shoqëri, si edhe për aktivitetin e saj, duke shënuar se kishte parë anëtarë të shoqërisë që mbanin kokardën e saj në xhaketat e tyre¹).

Në programin e saj kjo shoqëri kishte «përparimin dhe mirërojtjen e jetës». Nga ana tjetër shoqëria kërkonte ndihmën e gazetarëve patriotë që të forcohej, të shkonte përpara «për gëzim të gjithë shqiptarve».

«Njeriu i ri» sipas informacioneve të dhëna nga Avni Rustemi synonte demokratizimin e jetës së vendit dhe përgatitjen e një grupi politik, që të luftonte influencën e bejlerëve të Këlcyrës, të

1) L'Albanie en 1921. Paris. 1922, fq. 93.

cilët vite me radhë kishin shfrytëzuar fshatarët në atë krahinë.

Ajo ishte afërsisht e pesta që sipas Avniut «u bashkua me qëllimin e tij për një Kongres të madh për bashkimin e të gjitha shoqërive shqiptare të kohës»¹⁾.

Shoqëria ishte një nga më të preferuarat e Avniut, më me perspektivë, sipas mendimit të tij, sepse vetë «Përmeti dhe përmetarët — tregonte Avni Rustemi — janë për përparimin, megjithëse nëpër shekuj ata kishin patur mbi kokë bejlerët e Këlcyrës, që i kishin mbërthyer ata në grykë»²⁾.

«Njeriu i ri» bashkëpunonte ngushtë me «Djalërinë përmetare», një tjetër shoqëri demokratike e Përmetit, e drejtuar nga Stavro Vinjahu, që veproi nga viti 1920 e deri më 1924.

Synimet kryesore të «Djalërisë përmetare» ishin mbrojtja e pavarësisë së Atdheut, përmbysja e pushtetit të bejlerëve, vendosja e një regjimi demokratik në Shqipëri³⁾. Vepri i saj e shikojmë edhe në debatet e zhvilluara në votimet e vitit 1923. Ajo ishte drejtuar kundër njerëzve e grupeve politike, të përbërë nga kandidatë që i kishin shërbyer okupatorëve të ndryshëm, ose që anonin ndaj atyre.

Të dyja shoqëritë përmetare dhanë kontributin e tyre në lëvizjen demokratike, në fushatën elektorale të vitit 1923. Ata u bënë krahu i djathtë

1) Nga mbledhje e biseda të zhvilluara në klubin e opingarëve «Shpresa» të Gjirokastrës.

2) Po aty.

3) Fondi QKMGJ.

KLUBI POLITIK «LEKË-BOÇARI»

Gjirokastrë

Klubi politik «Lekë-Boçari»,

Iniciativën për ngritjen e tij e kishte marrë Heroi i Popullit Avni Rustemi. Ai u themelua «pas një bisedimi të gjerë e të gjatë, që do të kishte për qëllim mbrojtjen e interesave politike të mëmëdhezës dhe veqanërisht të krahinës së Gjirokastrës.»⁴⁾

U desh një punë e madhe nga ana e udhëheqjes së klubit për të zhvilluar aktivitetet, pasi kundër tij u ngritën si përherë elementë konservatorë, armiq të përparimit. Anëtarët aktivë të këtij klubi

4) Fondi i QKMGJ. Dosja Klubi politik «Lekë-Boçari», maj 1921, dhe gazeta «Drita», 13 korrik 1921.

ishin sidomos mësues të vjetër e të rinj të shkollës shqipe, publicistë, ish-anëtarë të klubeve të mëparshme, nëpunës të vegjël, oficerë përparimtarë, ish-pjesëtarë të çetave patriotike etj.

Kishte në radhët e tij edhe elementë karrieristë, që pengonin forcimin e klubit politik «Lekë-Boçari». Por më së fundi, përmbi këto përçarje e debate ambiciesh fitoi «mençuria dhe patriotizma e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv «kryesia e klubit — Shënim L. D.), i cili dijtë të kuptojë këtë rrezik në një mënyrë fare të kënaqshme.¹⁾

Me formimin e një komisioni iniciator nga nëntë veta, ku bënte pjesë vetë Avni Rustemi me shokë të tjerë, u hartua statuti i klubit²⁾. Klubi politik «Lekë-Boçari» ishte vazhdim i një tradite të shëndoshë në fushën e shoqërive, po që në kushte të reja do të punonte për mbrojtjen dhe përparimin shoqëror. Më 17 qershor 1921, pasi u përgatit «Kanonizma» për t'ia paraqitur mbledhjes për miratimin, u zgjodhën anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të klubit.

Në të njëjtën kohë klubi punoi për çështjet e arsimit, si edhe për ngritjen e një shkolle të mesme në Gjirokastrë.

Në këtë klub politik hynë klube me një përberje të vogël, si «Klubi gjimnastikor», «Klubi demokrat», ku bënin pjesë intelektualë patriotë, zëjtare, nëpunës demokratë si Andon Boshnjaku, Dhimitër Qurku etj. Ky klub u lidh ngushtë me klubin e opingarëve «Shpresa» dhe veproi edhe pas

1) Po aty

2) Po aty.

vitit 1924 më vete, gjer sa u mbyll nga regjimi i Zogut më 1925.

Megjithë goditjet që pati nga elementët reacionarë lëvizja demokratike përparimtare, shkoi përpara. Më mirë u mbajt klubi i opingarëve «Shpresa», që veproi me patriotizëm në fushën politike i mbështetur te anëtarët e klubit politik «Lekë-Boçari», ose te «Klubi intelektual» dhe tek një shoqëri e porsa formuar, «Shoqëria teatrale» e cila punoi në forma të ndryshme edhe pas vendosjes së diktaturës së Zogut.

«Shoqëria teatrale» ndihmoi në ngritjen e një shkolle laike të muzikës. Këtë veprimtari e çoi më tej shoqëria «Studenti» e formuar në 7 korrik 1924 në qytetin e Gjirokastrës.

**Figura të shquara
të lëvizjes arsimore-kulturore
e demokrate**



Andrea Konomi

ANDREA KONOMI

«Në është i lik Andrea Konomi, është e tillë gjithë Gjirokastra dhe të gjithë anëtarët e klubit «Drita», që e mbajnë atë...»¹⁾

Lindi në Kavajë më 14 korrik 1879, në zjarrin e lëvizjes patriotike, kur lufta për çlirim kombëtar nga zgjedha otomane kishte shënuar një hap përpara me organizimin e «Lidhjes Shqiptare të Prizrenit» më 1878.

Mbasi kryen shkollën fillore, familja e dërgoi Andream në gjimnazin e Manastirit, ku mësimet jepeshin në gjuhën rumune. Këtu ai njihet me patriotë shqiptarë dhe merr mësimet e para të shqipes. Kur u kthye në Kavajë në vitin 1900, pas mbarimit të shkollës së mesme, ra në kontakt me patriotë si Abdurahim Kavaja (Sedja), i cili punonte me një vullnet të shquar në qytetin e tij të lindjes. Më vonë Andrea Konomi largohet për

1) Telegram i anëtarëve të klubit «Drita» të Gjirokastrës në emër të të gjithë popullit për lirim nga burgu të mësuesit Andrea Konomi. Telegrami i drejtohet kryeqeveritarit turk në Janinë, në mars 1909.

në Egjipt, ku njihet nga afër me Jani Vruhon, Thanas Tashkon e patriotë të tjerë.

Punonte për të nxjerrë bukën e gojës në një fabrikë në Kajro. Aty merr pjesë në lëvizjen patriotike dhe ndihmon me sa mundet për botimin dhe përhapjen e librave shqip. Ndhmon njëkohësisht me të hollat e mbledhura nga shqiptarët e Egjiptit çetën e Çerçiz Topullit. Ndërkohë bashkëpunon me publicistët patriotë dhe shkruan me pseudonimin «Shkëmbi i Kavajës» në gazetën «Rrufeja» të botuar nga Jani Vruho.

Sipas një relacioni të Andrea Konomit të shkruar në shkurt 1909, xhonturqit nuk bëjnë gjë tjetër veçse bashkohen me konsullatat e huaja, për të luftuar patriotët e Gjirokastrës. Ai luftonte njëkohësisht demagogjinë e xhonturqve, të cilët i cilëson «bijtë e bushtrës Turqi»¹⁾.

Andrea krenohet që është mësues i një qyteti si Gjirokastra, ku i madh e i vogël, që nga moshë 5 vjeçare kërkojnë me ngulm arsimin në gjuhën amtare. Ai është njëkohësisht kryelartë që gëzon simpatinë e përgjithshme në qytetin e Gjirokastrës, duke shkruar se «nuk ka gja ma t'ambël për një atdhetar se nga të qënurit mësonjës kombiar»²⁾.

Së bashku me Papapanon ai përfaqëson Gjirokastrën në Kongresin e Elbasanit, në shtator 1909.

Andrea Konomi qëndron dy vjet e ca si mësues i shkollës së parë shqipe të Gjirokastrës. Gjatë kësaj kohe me iniciativën e tij u hapën këtu

1) Fondi QKMGJ.

2) AQRSSH. Fondi J. Vruho. Letër e datës 19.II.1909 nr. 50: 106.

edhe shkolla të mbrëmjes, të cilat frekuentohe-
shin nga një numër i madh zejtarësh dhe qytetarë
të tjerë nga shtresa të ndryshme.

Për punën e kujdesshme dhe plot pasion të
Andrea Konomit dëshmojnë ditaret që ruajnë ako-
ma edhe sot ish-nxënësit e tij, ku shikohet përga-
titja për mësimet e ditës, ose ato të mbrëmjes,
dëshmojnë vjershat që i mbajnë mend edhe sot
ish-nxënësit e tij etj. Ata kujtojnë me mall e me
nderim këto vjersha ku flitet për vlerën e di-
turisë e të mësimi dhe njëkohësisht për kryetrimin
e Krujës, Gjergj Kastriotin — Skënderbeun:

Në vitin 1906 kthehet nga mërgimi në Kavajë.
Këtu ai hapi në banesën e vet një shkollë ilegale
shqipe. Por ndjekjet e pushtuesve turq e dety-
rojnë të largohet nga Kavaja. Me rekomandim të
patriotëve shqiptarë të Egjiptit Andrea Konomi
vjen në Gjirokastrë.

Në këtë qytet me tradita patriotike dhe ar-
simdashëse Andrea Konomi hapi shkollën «Liria»,
një bërthamë e vogël me 3-4 nxënës¹⁾. Ai punon-
te me zell të madh ditë e natë për të përhapur
gjuhën shqipe, për t'u mësuar nxënësve histo-
rinë e Shqipërisë. Autoritetet qeveritare turke e
akuzojnë se ka ardhur nga Egjipti për «një kryen-
gritje në Shqipëri». Por pavarësisht nga kjo ai
vijoi pa u lodhur t'u jepte nxënësve të shkollës
«Liria», mësimin e shqipes dhe njëkohësisht mësi-
min e frëngjishtes në gjysmëgjimnazin turk të
Gjirokastrës.

Kundër shkollës dhe mësuesve patriotë vep-
ronte sidomos prefekti i Gjirokastrës, një armik

1) Fondi QKMGJ.

i tërbuar i kulturës dhe i gjuhës shqipe. Andrea Konomi, në një lëter që i dërgonte Jani Vruhos në Egjipt, midis të tjerave jep portretin e shëmtuar të këtij prefekti. Kurse për drejtorin e gjysmë-gjimnazit turk të Gjirokastrës, ai shkruan: «Mydyri janjot është tyrk i ndyrë që nuk do të na shohë, po s'ka ç'ju bëjë djemët, të cilët më duan shumë tepër, sa deshnin dhe te më paguanin nga vetja e tyre, po unë i thashë njerit që këtë shërbim e bëj nga zemra dhe s'dua pagë»¹).

*Unë e njoh fort mirë
Bashkë jemi përpjekur
dhe për Shqipërinë
trim i mirë ka vdekur*

Me entuziazëm mësuesi patriot tregonte taktikën luftarake të Skënderbeut, i cili «armiknë» e hëngri/ dhe në këmbë s'e la/ gjer në buzë të varrit».

Në ceremoninë e fundit të çdo viti shkollor, ai së bashku me nxënësit e vet recitonte vjersha si këto:

*se ngriti krye e gjithë Shqipëris
se krisi pushka, topi gjëmon
e u mbloodh gjith djalëria²).*

Autoritetet qeveritare turke shikonin një element të rrezikshëm tek patrioti Andrea Konomi,

1) Po aty.

2) Fondi i QKMGJ. (Dosje nr. 3).

sepse ai punonte jo vetëm si mësues por njëkohësisht ishte edhe aktivist dhe organizator i teatrit amator në vitin 1909. Ata i shqetësonte edhe fakti tjetër se ai ishte në kontakt të ngushtë me nxënës të rritur, të gjysmëgjimnazit turk të qytetit. Prandaj edhe e luftonin dhe mendohehin t'i hiqnin lëndët humanitare dhe mësimin e frëngjishtes. Për këtë autoritetet turke ndeshën në kundërshtimin e hapur të vetë studentëve dhe të popullit, sepse ata kishin Andrea si këshilltar, mësues të dashur, shok e bashkëluftëtar për lirinë e mëmëdheut.

Shtypi i kohës shkruante për këto ndjekja që i bëheshin Andrea Konomit midis të tjerash edhe këto: «Shumë po e mendojnë autoritetet policore, që e thërresin tri herë ditën në polici, se e burgosin të mjerin djalë pa ndonjë faj, duke shkuar udhës (në Janinë) të shohë qytetin, duke shpifur se ka ardhur nga Misiri të merret vesh me kryengritësit e Toskërisë, se i muarrnë edhe një gjash-tore (revolver) të xhepit, se e shtrëngojnë keq»¹).

Njëkohësisht patriotët godasin nëpërmjet shtypit qeverinë osmane, e cila e ndjek të «mjerin mësues, duke e dërguar në internime»²).

Punë të mirë bëri ai për pasurimin e bibliotekës së klubit «Drita». Përveç librave të reja që siguronte, ai sistemonte shtypin e kohës, gazetat që vinin nga Egjipti, Bukureshti etj., duke tërhequr me anë të tyre anëtarët e klubit.

Mësuesi patriot u detyrua të largohet nga Gji-

1) Fondi i QKMGj (Dosje nr. 3).

2) Po aty.

rokastra pas një pune të frytshme që bëri. Vepra e tij ishte frymëzuese për çdo të ri gjirokastrit. Kanë kaluar mbi shtatë dekada që atëhere dhe ish-nxënësit e tij flasin me admirim për mësuesin e tyre, që nuk u kursye të punonte për abetaren, për kulturën kombëtare, për teatrin shqiptar.

I ndjekur nga agjentët e Esat pashë Toptanit, detyrohet të kalojë jashtë atdheut dhe kthehet në Shqipëri më 1921, duke u radhitur si gjithnjë në krah të forcave demokratike. U dallua si anëtar i partisë popullore, kundërshtar i Ahmet Zogut.

Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të 8 shkurtit 1922, vetë Ahmet Zogu i pyetur nga Fan S. Noli pranonte për rrahjen e Andrea Konomit nga bashibozukët e tij. Mësuesi patriot, që dikur ndiqej nga turqit në Kavajë, në Janinë, në Delvinë, në Gjirokastrë, ndiqet e rrihet edhe nga qeveritarët e Zogut.

Ata e ndiqnin Andrea Konomin sepse shihnin tek ai figurën e shquar, patriotin e mësuesin revolucionar, që tok me Avni Rustemin dhe patriotët e tjerë luftonin për një Shqipëri të lirë, demokratike, pa bejlerë dhe agallarë. Për këtë Andrea Konomi kishte fituar dashurinë e popullit gjirokastrit dhe të qyteteve të tjera ku jetonte e punonte në gjirin e tij si bir i vegjëlisë.

Mësuesi Andrea Konomi së bashku me Papanon çanë në Gjirokastrë një rrugë të re, atë të vajtjes nëpër familjet gjirokastrite. Duke forcuar lidhjet me prindërit ata fitonin dashurinë dhe respektin e tyre dhe bënë që të rritej numri i fëmijëve në shkollat shqipe. Andrea Konomi është paraprijësi i shkollave të mbrëmjes dhe shembu-

Ili i tij u përhap edhe në Delvinë, në Përmet, në Tepelenë e gjetkë.

Andrea Konomi dha kontribut me vlerë edhe për forcimin e shoqërisë patriotike «Vëllazëria» të Durrësit, duke e lidhur atë edhe me shoqëritë e mërgimit. Ai ndihmoi njëkohësisht edhe për zhvillimin e teatrit në Durrës.

Vdiq në varfëri dhe në mjerim më 11 mars 1934, i ndjekur dhe i persekutuar nga klika e Zogut, por i nderuar nga populli.

Vepra e tij dhe e patriotëve të tjerë është e gjallë në Kodrës historike të Gjirokastrës dhe në muzeume të tjera të vendit e konkretizuar nëpërmjet materialeve dokumentare, që ruhen me kujdesin më të madh.

Nëpërmjet këtyre dokumentave historikë brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë, mësojnë nga jeta, nga vepra, nga puna, nga shembulli i këtyre patriotëve që do të mbeten kurdoherë të gjallë në kujtesën tonë dhe do të na frymëzojnë për të vazhduar e për të çuar akoma më tutje fitoret tona, për të mbajtur kurdoherë të ndezur amanetin e të parëve tanë.


HYSEN HOXHA

Ka lindur në Gjirokastrë më 15 janar 1865. Që i ri mori pjesë në lëvizjen patriotike. Ai, me moshatarë të vet, kanë parë sigurisht në qytetin e tyre patriotë si Abdyl Frashëri me shokë, që hynin e dilnin në shtëpitë e Gjirokastrës, në praktikë të formimit të Degës të Lidhjes shqiptare për Gjirokastrën, kur ne këto populli ia mirrte shtruar këngës: Kurvelesh e Gegëri/ Ç'u mblodhe në Ergjiri/...

Që në moshë të re Hysen Hoxha ishte një nga lexuesit dhe përhapësit e shtypit patriotik në qytetin e lindjes. Në faqet e «Kalendarit kombiar» të vitit 1905 lexojmë se në listën e pajtimtarëve ndër të parët është edhe emri i Hysen Hoxhës.

Në vitin e nëntë të këtij shekulli, për vepërimitarinë e tij të gjërë patriotike, për respektin dhe simpatinë që gëzonte tek vegjëlja dhe populli i Gjirokastrës, Hysen Hoxha u zgjodh kryetar i klubit «Drita».

Në krye të këtij klubi, tok me të 260 anëtarët e tij ai punoi vite të tëra për përhapjen e arsimit dhe të diturisë dhe për bashkimin e popullit në luftë kundër pushtuesve dhe reaksionit



Hysen Hoxha

feudal. Mbante lidhje të ngushta me klubin qendror të Manastirit, me atë të Elbasanit etj., ndihmonte nga ana organizative klubet e lidhjet e para të ngritura në Libohovë, në Kuç, në Progonat, në Labovën e Madhe, në Sheper të Zagorisë etj.

Hysen Hoxha me shokë dijtën të shfrytëzonin kushtet legale, për t'u bërë ballë synimeve të pushtesve të huaj dhe tradhëtarëve të vendit. Ai u shqua në përpjekjet që u bënë në muajin mars 1910 për të kërkuar alfabetin kombëtar, me shkronja latine. Si kryetar të klubit «Drita» ky patriot ngre me forcë nevojën e alfabetit të të parëve tanë. «për ndryshe, në rast se do të përdoren «krrabat» ose «hieroglifet, sikurse cilësoheshin në atë periudhë shkronjat turko-arabe, thoshë ai, vendi do të kthehet 5000 vjet prapa»¹⁾.

Duke bashkëpunuar ngushtë me të rinj dhe me studentë përparimtarë i frymëzonte ata të punonin për të mirën e Atdheut.

Së bashku me Nuçi Naçin dhe Kadri Gjatën, Hysen Hoxha shkoi tek valiu i Janinës për problemin e alfabetit latin. Valiu, i cili e pa veten ngushtë përpara këtyre patriotëve, u mundua të paraqitej sikur gjoja ishte i paanshëm dhe që nuk i takonte të vendoste ai vetë. Por ky qëndrim i tij nuk ishte gjë tjetër veçse mashtrim dhe këtë e kuptuan mirë patriotët tanë, të cilët nuk hoqën dorë nga përpjekjet e tyre për të vendosur alfabetin latin.

Përsa i përket problemit të alfabetit Hysen

1) Fondi QKMGJ.

Hoxha bashkëpunonte edhe me klubet e tjerë për të patur mendime të përbashkëta.

Ai kishte lidhje edhe me shtypin përparimtar brenda e jashtë atdheut.

Në një telegram drejtuar prej tij gazetës «Shqiptari» të Stambollit, midis të tjerash theksohet: «Ju njoftojmë publikisht dhe në emër të të gjithë popullit se mbledhja e përgjithshme që u mbajt dje prej gjithë klerikëve dhe parësisë së vendit, do të mbrojë alfabetin e tashëm kombëtar shqip»¹⁾.

Ndërsa patriotëve të Elbasanit ai u shkruante: «Vetëm disa shqiptarë fanatikë e mendjendryshkur kanë dalë kundër abecesë sonë»²⁾.

Njëkohësisht në këtë dokument shprehet gëzimi për përparimin e lëvizjes kundër shkronjave turko-arabe, për mbarëvajtjen e punës në Elbasan, për zgjerimin e lëvizjes patriotike në këtë krahinë, për vendosmërinë e treguar nga patriotët e Elbasanit në drejtim të shkollave e të klubeve shqipe etj.³⁾.

Po kështu edhe letërshkëmbimi midis klubit të Gjirokastrës dhe atij të Manastirit dhe të qyteteve të tjera, janë një provë e qartë e zgjerimit të kësaj lëvizjeje për organizimin më të mirë të punës në drejtim të shkollës.

Si kryetar i bashkisë së Gjirokastrës i zgjedhur nga populli dhe kryetar i një klubi politik; Hysen

1) AQSH. Fondi klubi «Bashkimi» — Elbasan. Dokument nr. 50170.

2) Po aty.

3) Po aty.

Hoxha ishte përkrahës i zjarritë i çetave kryengritëse të patriotëve gjirokastritë. Ai bashkëpunoi ngushtë me organizatorët e këtyre çetave si Namik Delvina, Hasan Xhiku, etj. Ai takohet në malin e Kardhiqit dhe shkëmben mendime për forcimin e luftës kundër pushtuesit turk me anëtarë të «Shoqërisë së Zezë», të ardhur nga Vlora, Mallakastra dhe Korça.

Ja ç'shkruhet në një dokument për këtë takim të tij me kryengritësit: «Në Kardhiq vjen një Hoxhë me mend e me nder të madh». Ai u tha kryengritësve, që ishin afro 200 vetë «të mos i lenë armët, po të nderojnë atdhenë me sa të munden»¹⁾.

Pasi u kthye në Gjirokastrë nga ky takim, Hyseni pati një bisedë me prefektin. Dhe ndërsa prefekti turk e pyeti sa vetë ishin kryengritësit, ai i përgjigjet me kurajo: «Përmbi 2000, edhe gjithë me maliherë, me bomba të shumta dhe plot me fyshekë».

Dhe kur prefekti e pyeti përsëri se ç'kishin ndër mend të bënin, ai ju përgjigj i vendosur: «Do t'i bien Gjirokastrës»²⁾.

Kjo përgjigje burrërore e kryetarit të bashkisë së qytetit e tronditi aq shumë prefektin turk sa që menjëherë i dërrmuar i çoi telegramin Janinës, me të cilin kërkonte ndihmën e ushtrisë.

Bisedimi i Hysen Hoxhës me prefektin e Gjirokastrës bëri bujë në të gjithë qytetin. «Ato

1) Gazeta «Liri e Shqipërisë» Sofje 15.12.1911, nr. 27

2) Po aty.

ishin fjalë që e nderojnë shumë Hysen efendinë»¹⁾, — shkruan kronisti i atyre ditëve.

Ishin ditë plot ngjarje historike për Gjirokastrën këto që po kalonte vendi mbarë. Po kështu edhe për patriotët që me guxim shkruanin fage plot krenari. Ata kishin besim të madh në fitore, aq sa redaktorë gazetash patriotike uronin që «korriku i cili mbush grunaret me grurë, të sillte edhe lirinë e Shqipërisë»²⁾.

Në zhvillimin e ngjarjeve politiko-shoqërore të ish-qarkut, si edhe në ato të lëvizjes kryengritëse të kësaj periudhe shikohet mendimi dhe dora e pleqësisë së Mbrojtjes Kombëtare të Gjirokastrës, anëtar i së cilës ishte edhe Hysen Hoxha. Anëtarët e këtij Komiteti dhe vetë Hysen Hoxha ndodhen kurdoherë pranë kryengritësve, që vepronin në Gjirokastrë, Tepelenë, Delvinë, Përmet dhe në zona të tjera, duke i ndihmuar ata materialisht në luftën kundër turqve.

Hysenin dhe anëtarët e tjerë të pleqësisë i shikojmë duke punuar e luftuar në zonën e Kardhiqit, në Cepo e gjetkë. Ai ishte në krye të veprimeve kundër Mufit bej Libohovës, vegël e ndyrë e turkut, bashkëpunëtor më i ngushtë i Mustafa Zihniut, kryeqeveritarët të Janinës.

Qëndrimi burrëror i Hysen Hoxhës me shokë, që janë të lidhur ngushtë me çetat kryengritëse, të cilat luftonin për të sulmuar Gjirokastrën dhe për ta çliruar atë nga pushtuesit turk, e detyroi vullnetshëm e Janinës të dërgojë këtë letër që mban da-

1) Po aty.

2) Po aty.

tën 3 korrik 1911 në drejtim të Mufit beut të Libohovës. «Nesër në darkë o të martën në mëngjes thuhet se do të bëhet ofensivë mbi qytetin e Gjirokastrës. Në qoftë se kjo ngjan është një fatkeqësi, prandaj dhe ju, menjëherë të shkoni në Gjirokastrë, të bisedoni me shehlerë (parësinë) e po të jetë një gjë e tillë, menjëherë, ta ndaloni»¹).

Mufit bej Libohova duke dashur të ulë figurat e patriotëve gjirokastritë, ata të pleqësisë së klubit, që ishin edhe në Komitetin e Mbrojtjes, i përgjigjej valiut midis të tjerash: «... Ata që kanë mendjen në kokë nuk do të marrin rrugën e keqe e kështu gjendja do të ndryshojë dita-ditës»². Njëkohësisht beu i shkruante valiut turk: «që qeveria të jetë e përgatitur për çdo eventualitet»³).

Ndërkohë vali i Janinës merrte masat mbrojtëse, duke nxitur kundër kryengritësve edhe klerikët e shitur tek Turqia. Kjo provohet edhe nga telegrami i datës 4 korrik 1911 që ai u dërgonte baba Selimit e baba Sulejmanit, ku thuhet: «Ju lutem, perëndia mos e dhëntë, në rast se sulmohet qyteti (Gjirokastra) duhet ta kufizoni me përpjekjet tuaja këtë që të zhdruken të ligat»³). Tek këta klerikë mbështetej edhe Mufit bej Libohova.

Nga frika e kryengritësve dhe per-patriotëve, Mufit beu, me letër të veçantë njëfton «se nuk është mirë që të shkojë në Gjirokastrë, se mos e vënë përpara», dhe shton: «Ngathtë vete n'atë

1) Gazeta «Shkumbi». Stamboll, nr. 70, fq. 3-4 turqisht.

2) Po aty.

3) Po aty.

gjendje, është më mirë t'i këshilloj në Libohovë»¹⁾. Mufite beut e ndjente frikën e patriotëve dhe preferonte të qëndronte më mirë në sarajin e vet të Libohovës, sesa të shkonte në Gjirokastrë, ku kishte rreziqe për të.

Në korrik 1912, në Gjirokastrë organizohet një manifestim popullor për të festuar çlirimin e Krujës kryer një muaj përpara nga çetat kryengritëse. Në krye të këtij manifestimi ishte edhe kryetari Hysen Hoxha me shokë, në emër të klubit «Drita». Edhe pse garnizoni turk ndodhej i vendosur në kala, edhe pse xhandermaria ishte në këmbë, gjirokastritët nuk u tërhoqën, por i treguan pushtuesit se zotër të vendit ishin ata e jo pushtuesit turq. Të 260 anëtarët e klubit politik «Drita», me kryetarin e tyre në krye, e kishin kthyer «Kodrën historike» në një vatrë rezistence pesëvjeçare. Ata i detyruan qeveritarët turq me datën 6 gusht 1912 të pranonin hyrjen e çetës kryengritëse në qytet.

Çeta hyri në Gjirokastrë nga ana e lagjes Hazmurat. Me mauzeret në sup, në grykat e të cilave disa pjesëtarë të çetës kishin vendosur nga një bisht pene, simbol i luftës për dituri e për mësim, kryengritësit i afrohen prefekturës dhe kaluan përpara xhandarëve të armatosur që dridheshin nga frika. Pastaj kryengritësit e armatosur shkojnë në «klubin e rilindasve», duke bërë të gjëmojë vendi nga këngët patriotike, nga «Mëmëdheu» i Gramenos.

Përpara prefekturës, popull, nxënës, kryengri-

1) Po aty.

tës, bëhen si një grusht i vetëm dhe së bashku ngjiten për në mësimoren «Liria», për në klubin «Drita». Në krye të tyre shquhen Hysen Hoxha e Dervish Hima.

Tek sheshi i vogël dhe oborri i shtruar me pllaka guri, populli i pret krahëhapur kryengritësit. Ai ishte sheshi i mësimores dhe «salla» e teatrit të parë shqip. Këtu tre vjet përpara ishte luajtur e para dramë në gjuhën amtare dhe ishte ngritur e para skenë amatore.

Vargje të Naimit dhe të Çajupit u recituan me këtë rast te sheshi, përpara kryengritësve dhe popullit.

6 gushti i vitit 1912 ka mbetur në histori si një nga festat popullore më të mëdha. Pas kësaj në historinë e këtij populli ka mbetur edhe festa e 4 dhjetorit 1912, kur në kalanë e këtij qyteti u ngrit flamuri kombëtar.

Jon vetëm zyra e tij si kryetar klubi, ose zyra si kryetar bashkie, por edhe shtëpia e patriotit Hysen Hoxha ishte kthyer në një vatër patriotike. Ishte kjo një «shtëpi e nderit dhe e halleve të popullit»¹⁾, një vatër ku u strehuan patriotët më të mirë, por njëkohësisht nga ku furnizoheshin edhe çetat me luftëtarë trima. Në kujtimet e veta pjesëtarë çetash kujtojnë ato ditë të vështira, kur Hysen Hoxha mendonte dhe i ndihmonte ata²⁾.

Njëkohësisht Hysen Hoxha me shokët Hasan Xhiku, Andrea Konomin, Mulla Xhaferrin nga Vlora ka punuar edhe nëpër bodrumet e shtëpisë

1) Revista «10 Korriku», nr. 10, 1973, fq. 3.

2) Revista «10 Korriku», nr. 10, 1973, fq. 3.

së Hasan Xhikut, duke biseduar kokë më kokë me Mihal Gramenon, Spiro Bellkamenin, Themistokli Gërmenjin, kur ata ndiqeshin këmba-këmbës nga turqit. Nga këto bodrume niset ai i përkrahur nga anëtarët e Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare të Gjirokastrës për të shkuar nga Çajupi në Përm¹).

Në mbledhjen historike të Kuvendit të Vlorës, Hysen Hoxha caktohet nga populli i Gjirokastrës si përfaqësues i tij. Pas mbarimit të punimeve të Kuvendit, që shpuri në Shpalljen e Pavarësisë, në telegramet e dërguara nga Vlora e porositnin: «Të forconi vijat e mbrojtjes, për të ndaluar sulmin kundër Atdheut tonë nga ana e qeverive të Ballkanit... të mos pësojë dëm askush, pa ndryshim besimi etj.»²).

Si delegat i Gjirokastrës, tok me Kristo Meksin, Elmas Bocen etj., Hysen Hoxha nuk u ndodh dot në mbledhjen e tretë kombëtare të datës 1 dhjetor 1912, që kishte në rend të ditës formimin e qeverisë. Ai mori pjesë me shokët e tjerë të Gjirokastrës në mbledhjen e katërt kombëtare të datës 3 dhjetor 1912, dhe kjo shifet edhe në procesverbalin përkatës ku njoftohet se «atë ditë arritën delegatët e Gjirokastrës Hysen Gjirokastra (Hoxha), Petro Poga, Jan Papadhopulli etj.»³).

Ai njihet e çmohet nga vetë kryetari i qeverisë së përkohshme të Vlorës, Ismail Qemali dhe bash-

1) Galip Xhiku. Lufta për çlirimin kombëtar në vitet 1878-1912. Tiranë 1962.

2) AQRPSSH. Dokumentet nr. 10.435, 10493, 8050.

3) Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Tiranë 1962.

këpunëtorët e tij më të ngushtë. Për këtë flasin dokumentet historike, telegramet e atyre ditëve; ku midis të tjerave është edhe telegrami që Hysen Hoxha u dërgon disa qytetarëve gjirokastritë nga Vlora e ku midis të tjerave ai shkruan: «Mbrimë shëndoshë. Me Ismail Qemal efendinë edhe me përfaqësues të tjerë, folëm gjer' e gjatë. Për njohjen e indipendencës sonë ka sigurime të forta... Të shpallni sa më shpejt e pa humbur minutën indipendencën, pas deklaratës së lartë të nderçmes kryesi dhe të ngrini flamurin kombëtar. Enveri a është shëndoshë?»¹⁾

Xha Hyseni, si prind i dashur, i dhemshur, i përmallshëm, i ndarë ato ditë nëntori nga nipi i tij i vogël 4 vjeçar, Enver Hoxha, pyet me mall për shëndetin e gazit të shtëpisë së vet, i cili pikërisht pas 32 vjetëve, do të shpallte në Tiranë çlirimin e plotë të Atdheut tonë. Largimi i Hysen Hoxhës nga qyteti, nga bashkëqytetarët e vet, largimi nga populli për të cilin ai punonte, nga familja, që atë e pati një edukator plot ndjenja të pastërta patriotike e bënte atë edhe më shumë të përmallshëm, për qytetin, për qytetarët, për nipin e vogël.

Kryetari i klubit jetonte edhe në Vlorë me hallet e me problemet jetike të Gjirokastrës. Në një telegram tjetër njoftonte Gjirokastrën, Tepelenën, Delvinën «për të mbajtur ashtu si duhej harmoninë

1) Telëgrami ka datën 20 vjeshtë e tretë 1912, nr. 89. fjalë 69. I është drejtuar Idris Angonit, Musá Xhikut etj.

(Dokumente Historike. Kallnduer 1925, nr. 11 — Elbasan).

e dashurinë ndërmjet elementëve të Atdheut dhe të përgënjeshtrohen me vepra ngulmet e armiqve të pamëshirshëm, të cilët parashtrojnë se nuk janë të zotët me ngrehë një shtet të qytetëruar, të ecin pra pas politikës së qeverisë së përkohshme». Këtë dokument e nënshkruajnë edhe patriotë të tjerë¹).

Ditët që përfaqësuesit e Gjirokastrës kishin kaluar në Vlorë pas shpalljes së pavarësisë kishin lënë mbresa të pashlyera në kujtesën e tyre.

Ish-kryetari i klubit «Drita», Hysen Hoxha, kishite sjellë me vete nga Vlora edhe një qeleshe të bardhë, që ato ditë e mbante në kokë, si shenjë të shtrenjtë të kostumit kombëtar. Kujtonte festat në Vlorë, sheshet ku hidhnin valle me mijëra veta të ardhur nga gjithë Shqipëria dhe nga Kosova.

Nuk kishin kaluar as katër muaj nga dita kur në Gjirokastër u ngrit flamuri kombëtar, kur një pushtues i ri shkeli vatanin tonë të shtrenjtë. Më 16 mars 1913 ushtria shoviniste greke hyri në Gjirokastër.

Pushtuesit u pritën me armë. Populli me në krye patriotët qendroi i papërkulur para burgimeve, internimeve, para kërcënimeve për të djegur e shkatërruar qytetin.

Ish - kryetari i klubit «Drita», Hysen Hoxha, qendron si kurdoherë si një tribun i qytetit dhe i

1) Telegrami ka datën 20 vjeshtë e tretë 1912, pa numër, fjalë 140. I është drejtuar Idris Angonit, Musa Xhikut etj.

(Dokumente Historike. Kalinduer 1925. nr. 11 — Elbasan).

gjithë krahinës, duke mos iu nënshtruar urdhrave të njëpasnjëshme të pushtuesve shovinistë grekë. Edhe pse klubi «Drita» ishte mbyllur formalisht, patriotët nuk e pushonin aktivitetin. Hysen Hoxha dhe shokët e tij eju përgjigjen me burrëri pushtuesit dhe e ndaluan të digjte qytetin¹). Shovinistët, me pishë në dorë u detyruan të zbrapseshin nga qëndrimi burrëror i këtyre patriotëve. Jehona e këtij akti të guximshëm u përhap brenda e jashtë atdheut. Bashkëkohësit vlerësojnë lart veprën e patriotit Hysen Hoxha, qëndrimin e tij kërenar përpara kërcënimeve të ushtarakëve grekë, të cilët sipëruan 13 veta nga Gjirokastra, disa prej të cilëve ishin anëtarë të klubit «Drita». Ai nuk u mashtroas nga demagogjia e përdorur prej tyre, të cilët nxirrnin shpallje zyrtare, ku shkruanin se gjoja «kishin zaptuar Epirin, dhe se s'do t'i jepnin këtij vendi të mirat e lirisë së vërtetë e të njësisë ndaj nomit»²).

Në mendjet e bashkëkohësve të tij ka mbetur i paharuar, qëndrimi burrëror dhe vendosmëria e tij, ndaj shovinistëve grekë, të cilët urdhëruan të largohet populli i Gjirokastrës dhe të lihej qyteti në duart e tyre. Hysen Hoxha u përgjigj me vendosmëri: «Jo, nuk largohet Gjirokastra!»

Kur pushtuesi jep ultimatumë duke thënë: «Të largohet Gjirokastra, se unë e ngre!», ai përsëri kundërvihet me këto përgjigje lakonike: «Nuk e ngte dot, Gjirokastra është e rëndë».

1) Gazeta «Liria» 9 tetor 1924. Tiranë, nr. 1/17, fq. 3

2) Fondi i Muzeut historik Gjirokastrë.

Kur pushtuesi kërcënon:

«Të largohet Gjirokastra, se unë e djeg», Hysen Hoxha i thotë: «Nuk e djeg dot Gjirokastrën, Gjirokastra është shkëmb»¹⁾.

Shkëmb patriotik mbeti ajo edhe më vonë, e ushqyer me këto tradita të shkëlqyera, dhe kështu do të mbetet Gjirokastra për jetë e mot.

Hysen Hoxha dhe patriotë të tjerë kanë protestuar energjikisht pranë autoriteteve ushtarake të pushtimit, për aktet çnjerëzore të ushtrisë dhe të bandave shoviniste greke në popullin e Gjirokastrës dhe të krahinave, për masakrën e Hormovës dhe për masakrat e tjera.

Patrioti Hysen Hoxha, që dikur protestonte në emër të popullit kundër xhonturqve për shkronjat kombëtare, për shkollën shqipe, vepron tani edhe kundër komedisë së zgjedhjeve parlamentare më 1915 në prefekturën e Gjirokastrës, për të zgjedhur deputetë në parlamentin e Athinës. Vetë qytetarë e fshatarë të Gjirokastrës kujtojnë sabotimin që u bënin patriotët tanë me Hysen Hoxhën në krye këtyre votimeve, kur pushtuesit grek, «shtronin kandidatura të kurdisura nga vetë ata, për të mashtruar popullin, i cili askurrë nuk është mashtruar nga këto veprime djallëzore»²⁾.

Hysen Hoxha mbron anëtarët e komisionit, që kundërshtonte fushatën e votimeve parlamentare, që ishin një mashtrim i plotë, mbron qytetarët e fshatarët që ishin në këtë komision.

Për të gjitha këto veprime partiotike Hysen

1) Revista «10 Korriku», nr. 10, 1973, fq. 1

2) Gazeta «Drita» Gjirokastër, 2 tetor 1924, fq. 3.

Hoxha fillon të ndiqej nga autoritetet e pushtimit, gjer sa më 1915 pushohet nga puna. Megjithatë populli e pati zgjedhur si kryetar bashkie edhe më vonë.

Edhe pse atë e larguan nga Bashkia e qytetit, përsëri Hysen Hoxha mbeti një frymëzues dhe organizator i protestave kundër pushtuesit grek. Dhe kur urija kishte pllakosur në Gjirokastrë dhe në krahinat e saj, ai ngriti zërin për të siguruar bukë.

Po këtë qëndrim mbajtën patriotët gjirokastritë edhe përpara pushtimit italian. Ata nuk u mashtruan dhe nuk u tundën as nga demagogjia dhe as nga territori i egër i pushtuesit imperialist italian.

Synimeve të pushtuesve italianë patriotët si Hysen Hoxha me shokë u vunë përballë kërkesat e tyre. Në 13 nëntor të vitit 1918 mbledhet Kuvendi i Gjirokastrës, i cili kërkon mbrojtjen e vendit dhe formimin e një ushtrie shqiptare. Ai u bëri thirrje shqiptarëve brënda e jashtë atdheut të bashkoheshin si një trup i vetëm për të shporrur pushtuesin nga trualli arbëror dhe për ta bërë mëmën Shqipëri të lirë dhe sovranë¹⁾.

Patriotët gjirokastritë e konsideronin bashkimin e vendit si një kusht të domosdoshëm dhe për këtë kërkonin formimin e shoqërive patriotike. Një shoqëri e tillë me emrin «Vëllazëria» u formua pas një viti në Gjirokastrë.

Duke kujtuar me nderim veprën e Hysen Hoxhës, qytetarët gjirokastritë, që dallgët e jetës i kishin çuar në mërgim, shkruanin se «në Gjirokastrë ka shqiptarë me ndjenja të paqme, shqip-

1) Fondi i Muzeut historik – Gjirokastrë (Fletorja nr. 3)

tarë që kanë kuptuar çështjen tonë si duhet, që janë të nderçëm dhe duan një Shqipëri të mbarë për gjithë shqiptarët, jo vetëm për bejlerët sojzezë... Dhe këta shqiptarë me ndjenja të paqme, të nderçëm, që duan një Shqipëri të mbarë për gjithë shqiptarët e jo vetëm për bejlerët sojzezë, janë në radhë të parë Hysen Hoxha, Papapano — prifti (plaku)» etj.¹⁾

Me nder e mbylli jetën e vet më 28 korrik 1934 Hysen Hoxha, ish-kryetar i klubit «Drita».

Atë ditë mbarë populli i Gjirokastrës mori pjesë në varrimin që iu bë xha Hysenit, i cili gjithë jetën punoi e luftoi për të mirën e këtij populli, për gjithë Shqipërinë.

Edhe pse shtypi i kohës, ai lokal dhe qëndror heshti, edhe pse qeveritarët antipopullorë i shikonin jo me sy të mirë këto nderime për patriotin, për vegjëlinë, për inteligjencien përparimtare, kujtimin i Hysen Hoxhës mbetej i gjallë.

Populli kujtonte, veçanërisht në këto çaste, burrin fjalëzjarr, që u qëndroi burrërisht ultimatimeve të gjeneralëve të huaj, populli nderonte kujtimin e patriotit, që i doli zot gjuhës dhe kulturës së popullit, edhe kur armiqtë mundoheshin t'i shuanin këto.

Hysen Hoxha nderohej për patriotizmin që tregoi me armë supit në mitingun e Cegos në korrik 1911, për mbrojtjen e alfabetit, të librit e të mësimores shqipe, optimist e plot besim se një ditë ajo do të lulëzonte.

1) «Memorjet e mia» nga Visar Dodani. Bukuresht, 1933, fq. 148.



Idriz Guri

IDRIS GURI

Lindi në Gjirokastrë më 1870. Pasi kreu shkollën fillore, u dërgua nga familja në Janinë, më vonë në Stamboll në një shkollë ushtarake, por këtë e la dhe u kthye në Gjirokastrë, me qëllim që të punonte për çështjen kombëtare.

Luftën patriotike kryesisht ai e zhvilloi me «bastunet» e tij. Ato ishin kronika e ditëve të vështira të regjimit antipopullor, kronikat e ngjarjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Në një kohë kur gazetat e qytetit, zëdhënëse të regjimit, përpiqeshin të helmonin ndërgjegjen e njerëzve, Idriz Guri me anën e bastuneve të tij nga fillimi i këtij shekulli e gjer më 1940 për afro katër dekada rresht, u bë një shprehës i aspiratave dhe i luftës politike të popullit kundër pushtuesve dhe regjimeve antipopullore.

Krahës shkrimeve në shtyp, nëpërmjet bastuneve të tij, që shprehnin mendime alegorike me karakter të thellë politik, Idriz Guri u bë një propagandist i mendimit përparimtar. Kur ai heshte, se nuk i kishte përgatitur akoma punimet e veta për ngjarjet e ditës, populli i Gjirokastrës e kërkonte atë, se diçka i mungonte, kërkonte komentatorin e javës, të muajit, i cili ngjarjen e lidhte

me historinë, me situatën brenda dhe jashtë Shqipërisë. Idriz Guri qëndronte si antipod i regjimit dhe i gazetave të tij, dilte dhe i fliste popullit.

Punimi i drurit dhe në radhë të parë brendia politike e bastuneve të tij, shumë ekspresive, bënin efektin më të madh në popull, edukonin njerëzit me ndjenjat më të pastërta patriotike e demokratike.

Nga disa të dhëna del se Idrizi i filloi këto punime me «Lulon» (sulltan Abdyl Hamitin), të cilin e paraqiti si një figurë të shëmtuar: qimekuq, si qeros e hundëgjatë etj.

Në punime të tjera ai paraqet Perandorinë Osmane në formë karikaturale, si ari e arushë, kërmë, çakall, kunadhe, qen të zgjebosur, nepërkë etj. Punimet e tij ishin me të vërtetë vepra arti, që ai i përgatiste ditë të tëra në shtëpinë e vet, e cila ishte edhe punishte edhe studio, por kryesisht arkiv dokumentash të sistemuara, në bazë të të cilave i jepte publikut vlerësime dhe objekte mjaft shprehëse e komunikuese.

Guximi dhe veprimtaria që zhvillonte e kishin bërë atë një figurë të dashur. Për të shkruar me simpatinë më të madhe Mihal Gremenua, i cili e kish njohur personalisht qysh më 1907, duke thënë «Dyqani i Idrisit ishte qendra dhe shkolla ku përhapeshin ndjenjat e veprat kombëtare»¹⁾.

Po të dojë njeriu të njohë ngjarje e figura të shquara patriotësh që lidhen me to, këtë mund ta bëjë edhe nëpërmjet «bastuneve» të Idriz Gurit.

1) Antikat Kombëtare. Tiranë 1971, fq. 166.

Kështu për shëmbull në bastunin nr. 37 gdhënden një galeri patriotësh, që nga ata që përkrahën abetaret e Naum Veqilharxhit, e gjer te patriotët me në krye Ismail Qemalin që ngritën flamurin në Vlorë, martirët e rënë nën plumbat e osmanëve dhe të regjimit të Zogut.

Në to paraqiten figura të shquara patriotësh si ato të Çerçiz Topullit me Gramenon krahpërkrah, të cilëve u ka vendosur në sup nga një shkallë metalike. Nëpërmjet këtij punimi Idris Guri, kërkon nga të rinjtë që mblihdeshin kryesisht në Qafën e Pazarit; të hypnin në këto shkallë edhe t'u thoshnin këtyre të dy patriotëve «nga dy fjalë në vesh».

Idrisi është i mprehtë, inteligjent, plot brendi në shprehjet dhe mendimet e tij. Ai kërkon edhe nga kryetari i bashkisë së Gjirokastrës «një shkallë të lartë» për të hypur te monumenti i Çerçiz Topullit «që t'i thoshte këtij dy fjalë në vesh». Kur kryetari çuditet se si mund t'i drejtohet një vepre në bronx, Idris Guri, sipas dëshmitarëve të kohës, i përgjigjet atij: «Kur nuk dëgjoni ju me kompaninë tuaj, shumë mirë dëgjojnë patriotët, se ata sy e veshë i kanë në vend, jo si juve që jeni shurdhuar e verbuar nga të mirat, që ju rrethojnë».

Njëkohësisht në këto bastune paraqitet galeria e qeverive antipopullore e antikombëtare, dalin vjedhësit e arkës së shtetit, kriminelët, politikanët me dy faqe e mashtruesit, demagogët. Aty Idris Guri paraqet si në një vepër satirike tiparet kryesore të regjimit dhe të njerëzve të urryer që i shërbejnë atij.

Arkivat e tij personale janë ato që e ndihmuan

atë të «vazhdojë luftën partiotike» nga vitet 1925-1940. Idris Guri shkroi edhe vjersha. Ato që kemi në dorë janë të pakëta, mbasi pjesa më e madhe humbën, por ato kanë një brendi politike me vlerë. Janë shkruar në momente historike vendimtare, në mbrojtje të çështjeve kombëtare, kundër sundimit otoman, kundër shtypjes, kundër bejlerëve, po edhe kundër demagogjisë së xhonturqve, sidomos në fushën e kulturës dhe të alfabetit. Ai na ka lënë poezi për djemtë e gjysmëgjimnazit turk në Gjirokastër, që ngrihen e revoltohen kundër synimeve të xhonturqve, për të vendosur alfabetin turko-arab. Ai, duke vlerësuar qëndrimin e këtyre patriotëve të rinj, të këtyre studentëve shkruan se këta janë «yjtë e Shqipërisë», që nuk e duan jetën në rast se nuk miratohet alfabeti kombëtar. Në vjershat goditen klerikët dhe feja. Mendimi i Idris Gurit në këtë problem shprehet nëpërmjet të vargjeve:

Idadien¹⁾ ata ikn' e lanë

T'u mir mbeç i thanë.

Dhe e bënë besa-besën

ja të rrojne, ja të vdesin.

ja të mbrojnë abecenë

me gjithë shpirt.

sa gjall të jenë.

Njëkohësisht duke goditur klerikët antikombëtarë, Idris Guri mendon se studentët e Gjirokas-

1) Shkollë e mesme turke.

trës kërkajnë të shpëtojnë mëmëdhenë/ nga armiqtë e pabesë/ që fshihen nën rrobë të fesë/ dhe si lenë të përparojnë/ shkronjat e bukura të mësojnë./ I mbështetur në dëshirën e zjarrtë të të gjithë popullit të rrethit të Gjirokastrës si dhe në veprën e 260 anëtarëve të klubit «Drita», ai punon e shkruan se «djemtë këto s'i duruan/» pors i trima u lëshuan/ ndë luftë të diturisë/ për dritë të Shqipërisë/».

Për patriotin e vjershëtorin, studentët e Gjirokastrës janë «dragonj». Mendimin e vet ai jep në vargjet: u lëshuan si dragua/ u a paçim për jetë hua/ emri tyre mos u harroftë/ me shkronja t'arta u shkroftë/ në histori të Shqipërisë/ emri djemve t' Idadisë./

Me plot besim te djalëria, shkruan se vetëm të rinjtë e Shqipërisë do ta çlirojnë e lulëzojnë vendin. Këtë djalëri ai e përshkruan:

po jo, jo... se djalëria,

që po na vjen pas e gjallë,

hakën s'e la pa marrë,

Shqipërinë do ta ngjallë.

Njëkohësisht ai u këndon «Djemve të Shqipërisë» që kishin rënë për pavarësinë e Atdheut: u nxi koha, u nxi dielli/ duman lëshonte qielli/ u bë ditë e ligësisë/ humbën djem të Shqipërisë/».

Idris Guri ishte njeri i vendosur gjër në fund për çlirimin nga Turqia, por njëkohësisht edhe nga shfrytëzimi feudal. Ai simpatizonte njerëzit e vendosur në jetë, ata që ishin patriotë konsekuentë, jo si mësalla me dy faqe, simpatizonte luftëtarët

që do t'i mbronin mendimet e idealet e tyre gjer
në fund, duke na lënë këto vargje:

*lum ata, jan të lumtur
ata, vetëm ata mund
që qëndrojnë të patundur,
gjersa vdesin më në fund.*

Kjo strofë i përshtatet edhe jetës dhe veprës së Idris Gurit. Ajo mund të ishte edhe një epitaf i përshtatshëm për të.

Vjersha dhe vargu i tij ishte shumë popullor, njerëzit i mësonin përmendësh. Aq është e vërtetë kjo sa një qytetar gjirokastrit e tregonte pikërisht këtë strofë ashtu sikurse ishte e shkruar në një shkrim të Mihal Gramenos, në gazetën «Koha» që botohesh prej tij në mërgim.

Dëshirat e ndjenjat e tij shpesh i shprehte me vargje edhe kur bisedonte me të tjerët. Kështu kur dikush e pyeti se ç'dëshironte të ishte, pasi Shqipëria të fitonte pavarësinë ai u përgjigj: «Kërkoj të bëhet Shqipëri/ pa le të jem dhe lustraxhi». Linte të kuptonte se ai nuk do ta kishte syrin te kolltukët, ashtu si vepruan pseudopatriotët, që u shërbyen pushtuesve dhe regjimeve antipopullore¹).

Një formë tjetër propagande e politike e tij ishte përdorimi i kriptogrameve. Gjer sot kemi siguruar një të tillë, që flet për poezitë më tipike të Koto Hoxhit, i cili shkruante: Ju djem do të kujtoni/ kur të ngjalletë liria/ po ç'të bëj, o un' i mjeri/ që m'u mbyllnë sytë e mia/. Ose poezia

1) Informacion gojor nga Ismet Baçi, nga Delvina.

tjetër kundër besimeve, fesë dhe përçarjes që mbillnin fetarët:

nuk për kish e për xhami

po për mësim, qytetari

vritemi për Shqipëri¹⁾.

Këto vargje, disa herë Idris Guri i ka gdhendur në dru, jo me fjalë të plota, po vetëm me iniciale.

Gdhendja në dru, dhe kriptogrami ishte një traditë e vjetër. E provon këtë edhe albanologu Hahn, që na flet për një shkrim «kriptografik», të shoqëruar me disa shenja të tjera, që ai takoi në Gjirokastër nga mesi i shekullit të kaluar²⁾.

E provojnë këtë punimet artistike simbolike në dru, që janë gjendur në Gjirokastër, në mes të të cilave një bilbil i hijshëm, punuar më 7 korrik 1870, ku paraqiten në mënyrë simbolike dy gjarpërinj, që ndjekin dy zogj.

Për veprimtarinë e tij politike Idris Guri burgoset disa herë. Dëshmohet nga një gazetë, se në vitin 1911 ai arrestohet pasi foli kundër ushtrisë turke dhe synimeve të saj, se «shau formën e ushtrisë»³⁾. Por shkakun kryesor ishte se Osmanët e kishin atë halë në sy. Shtypi i kohës tregon qartë se atdhetarin e djegur, turqit nuk e burgosën vetëm për këtë, por se Idrisi ishte shqiptar, se e «njohin që qe ai në kryengritjen e Bajos

1) Fondi i QKMG.

2) Gazeta «Ora». Tiranë, 11 nëntor 1930, fq. 4.

3) «Liri e Shqipërisë», 15 vjeshtë e tetë 1911.

e të Çerçizit, dhe se ishte «ndër të parët liridashës». Bashkë me Namik Delvinën kish shkuar më 1911 në Berat dhe në Korçë në krye të një komisioni¹⁾.

Burgimi i Idrisit kishte hidhëruar zemrat e popullit. Atë e mbajnë një kohë të gjatë të mbyllur në burgun e Janinës, aq sa shtypi i kohës shkruante se atij nuk i jipnin as bukë. Patrioti ynë përmendet si një atdhetar i flaktë që i ka ndihmuar çështjes shqipëtare me mish e me shpirt dhe ka bërë theror kamjen e vet për Shqipërinë, prandaj kërkohet që shtypi të kontribuonte për lirin e tij nga burgu.

Por Idrisi, nuk u lirua dhe osmanët e kishin cilësuar «të rrezikshëm», dhe ishin të sigurtë se më të dalë nga burgu do të vijonte veprimtarinë e tij kundër tyre. Ishte koha kur në Gjirokastrë gjendja ishte shumë e turbulltë, aq sa nga Përimeti vjen si përforsim një taborr ushtarësh turq²⁾, që do të vepronin kundër çetave kryengritëse në luginën e Gjirokastrës.

Idris Guri u burgos gjithashtu se kishte dalë në mbrojtje bashkë me shokë të tjerë, të malësorëve të Veriut të ndjekur nga turqit e të internuar në Gjirokastrë më 1910 e më 1911.

Mjerimin e tyre ai e kishte paraqitur në punimë druri me vlerë, por edhe me anën e shkri meve të tij në gazetat e shqiptarëve në mërgim.

Duke përshkruar mjerimin e këtyre «gegeve», të sjellur me forcë, Idrisi tregon se «qeveria,

1) Po. sht. 1911, numri 11, shtatori 1911, shtatori 1911.

2) «Liri e Shqipërisë», 8 mars 1912.

si të gjitha qeveritë e kazave (krahinave) po bëjnë
ca gjëra të ndyra e të pështrira në çdo vend që
ndodhen gegë, nga ata që përhojnë me bel në çdo vend
që rrojnë¹⁾. Po në atë gazetë ai shkruan se këta
të mjerë i sjellin në Gjirokastrë, tetë shpirt të
lidhur me një tërkuzë dhe po i burgosin duke ju
thënë se janë komitë.

Ai i përshkruan ata «pa opinga, zhveshur, laku-
riq, fytyrat e tyre të prishura nga të pangrënët,
aq sa në fund, i revoltuar nga kjo gjendje kërkon
me forcë që edhe Shqipërisë «t'i sigurohet një
gëzim», të shohë edhe ajo ditë të bardha²⁾».

Idris Guri, i duroi vuajtjet e burgut dhe mun-
dimet, por mbeti plot besim se Atdheu do të çli-
rohej një ditë. Për ta shpëtuar nga dënimi i si-
gurtë nga gjykata ushtarake, u ngritën shumë pa-
triotë, shokë e dashamirës të tij. Disa prej tyre,
që shërbenin si mjekë në Janinë, dhanë raporte se
ai ishte i sëmurë, ndërsa vetë Idrisi në burg hiqej
si një njeri që vuante nga nervat, aq sa shokë e
bashkëpunëtorë të tij si Thoma Papapanua tregonin
se për këtë ishin të bindur edhe rojet e burgut.
Kur Papapanua shkon një ditë për ta parë në burg
rojet e këshilluan «të mos i afroreshin se ai kishte
çaste që paraqitesh i rënduar nga sëmundja». Vetë
Idris Guri, i cili ishte krejt normal, u thoshte
atyre që e vizitonin se ishte «i sëmurë me shtatë
raporte». Duke mos patur edhe prova të dokumen-
tuara për ta dënuar, pas afro shtatë muajve hro-

1) Gazeta «Shkumbia», Stamboll, maj 1911.

2) Po aty.

het nga burgu. Dhe siç pritej ai nuk e ndërpreu aspak veprimtarinë politike.

Nga muaji gusht 1912 e gjer në nëntor 1912, te punimet e «bastunëve» të tij gjejmë jehonën e ngjarjeve më të rëndësishme të vendit, vendimet e Komiteteve të fshehta që kërkonin «vet-qeverimin e Shqipërisë», vendosmërinë e patriotëve me armë në dorë që deklarorin se do të ngulnin këmbë gjer në fund, gjersa të shuhen që të gjithë.

Punime me vlerë përgatiti ai për ditën e 6 gushtit 1912, kur në Gjirokastrë hyn një çetë kryengritëse e cila u prit me brohori nga populli i qytetit.

Po kështu veproi edhe për ngjarjen e madhe të shpalljes së pavarësisë në Vlorë, duke e paraqitur këtë në një punim të veçantë, ku dalin figurat e Ismail Qemalit e të Luigj Gurakuqit dhe shprehen mendime për të ardhmen e Shqipërisë, punim që është ruajtur i padëmtuar.

Në këtë frymë veproi Idris Guri gjatë pushtimeve të shovinistëve fqinj në vitet 1913-1920, kur ai nëpërmjet «bastunëve» të tij paraqiste me ironi dhe sarkazëm, funksionarët dhe ushtarakët e huaj të ushtrive agresive.

Vitet e pushtimit italian (1916-1920) ishin shumë të vështira edhe për patriotin Idris Guri. Këtë na e dëshmojnë qytetarë gjirokastritë, këtë e vërteton me shkrimet e tij edhe Mihal Gramenua, i cili tregon, se qysh nga Lufta e Parë Botërore Idris Guri synonte të ngrinte vegjëlinë, shtresat e ulëta të shoqërisë, «opingen» kundër shfrytë-

zuesve dhe bejlero-agallarëve, vegla të çdo pushtuesi.

«Ai — shkruan Gramenua në një artikull të tij në mërgim — sulet për të zgjuar opingën, ve-gjëlinë, dhe si shpërblim të gjithë kësaj pune ai dënohet të vdesë»¹⁾.

Mihal Gramenos i ther në zemër gjendja e Idris Gurit. Vuajtjet e patriotit dhe bashkëpunëtorit të tij ishin vuajtje edhe për publicistin dhe shokun e vjetër Mihalin. «Ky lajm — vijon në shkrimin e tij Gramenua, ishte një goditje nga më të mëdhatë, që kam ndjerë në jetën time»²⁾.

Mëgjithatë Idris Guri vijoi të punojë e të veprojë plot optimizëm edhe më vonë. Këtë ai e shpreh në shkrimet e tij, sidomos në «bastu-nin» me këto fjale: «Dum spiro spero» (sa marr frymë shpresoj), që e shoqëronte me fjali e mën-dime të patriotëve më të mirë të Shqipërisë, të cilët shpresonin që një ditë Atdheu do të çlirohej nga çdo pushtues. Aty gjejmë ndonjë strofë të Idris Gurit për shpresën e çlirimit, ndërsa në ko-din e dëshifrimit të këtij bastuni, ai shkruante: «Nuk dëshpërohem aspak dhe për dita këndoj këngën tënde, që këndonin në kohët e Lulos (sul-tan Hamitit)». Këtu, «në këngën tënde», Idris Guri ka parasysh poezitë e preferuara që këndon-të Mi-hal Gramenua për të ardhmen e vëndit. Besimin e madh të tij së pushtuesi italian do të shporrej nga Shqipëria, Idris Guri e shprehte me këto fja-lë: «Do t'i kapërcejmë edhe këto or vëlla, duke

1) Antikat Kombëtare. Tiranë, fq. 167.

2) Po aty.

pritur ditët e mira paskëtaj, që të bashkohemi të gjithë në Shqipërinë e lirë e të lumtur...»¹⁾.

Në dhjetor 1926, në Tiranë u nënshkrua «Pakti italo-shqiptar» i ashtuquajtur «i miqësisë dhe i sigurimit», por që ishte një tradhti e re dhe e hapur e Ahmet Zogut ndaj interesave kombëtare të Shqipërisë, ku legalizohej drejtpërdrejtë ndërhyrja e Italisë në çështjet e brendshme të popullit tonë. Urrejtjen për lidhjen e kësaj marrëveshjeje Idris Guri e paraqiti në një punim të titulluar «Kambana e Alarmit», që ishte ndër punimet më tipike dhe të goditura të tij. Në këtë punim ai ka shënuar numrin 5 (të pesë nenet e paktit të Tiranës), dhe ka gdhendur këto fjalë në bastun «Për 5 vjetë e vura befa (peng) shtëpinë, pastaj do dal të rri në diell». Në mënyrë alegorike ai demaskon tradhtinë që satrapi Zog kreu ndaj Shqipërisë. Në krye të «bastunit» kishte vendosur një kambanë të rëndë, me shumë zile për rreth, që formonin një tingëllimë të vijuar. Pasi këtë «bastun» e ekspozoi tek Qafa e Pazarit, populli duke bërë aluzion për tradhtinë e Zogut përsëriste fjalët: «Idris Guri e vuri befa shtëpinë», që do të thoshte «Zogu e shiti «Shqipërinë».

Punimi i ekspozuar te Qafa e Pazarit dhe i miratuar nga populli gjirokastrit shkaktoi pushimin e tij nga puna dhe detyrimin që të paraqitej dy herë ditën, për afro 6 muaj në prefekturë.

Megjithatë Idris Guri vijoi të punojë, të flasë me «bastunet» e tij, të mbajë gjallë traditat më

1) Gazeta «Koha», 31 gusht 1918, fq. 3.

të mira, të shfaqë mendime revolucionare në fushën e diturisë, të arsimit.

Me vlera edukuese ishte punimi i kushtuar shkollës së mesme. Krahas protestave të popullit dhe të studentëve që kërkonin të mos mbyllej liceu, këtij qëllimi i shërbejnë edhe punimet e Idris Gurit. Dhe kur më 1929 në Gjirokastër fillon ndërtimi i një burgu të madh në kalanë e qytetit, patrioti gjen rastin që me një punim të veçantë të protestojë edhe një herë për politikën e Zogut që mbyll shkollat, që i jepnin popullit dritë në një kohë kur hapi burgje për shtypjen e tij.

Idris Guri kish një «atelie» të tijën që paraqet interes. Për t'i dhënë hijeshi, që në hyrje të ateliesë ai kishte vendosur portrete heronjsh, pamjen e kalasë së Krutës, «Skënderbenë në kalë» etj. Aty gjeje foto të Marubit nga Shkodra, i cili kishte fiksuar ngjarje e fakte të rëndësishme, shikoje letra patriotësh, kujtime ngjarjesh, aty kishte letra e libra të Ibrahim Shytit nga Vlora të Dervish Himës, të piktorëve si Duro Guri, vëllai i tij, foto të varrimit të Avni Rustemit, foto të Mihal Gramenos, dorëshkrime të tij etj. etj.

Koleksioni i gazetave të rilindjes, ishte diçka me vlerë të madhe. Aty shikoje edhe gazeta të botuara jashtë atdheut edhe pas vitit 1924, si «Shqipëria e re» e Kostancës, që hynte fshehurazi e deri te organi i Konarësë.

Tryeza e punës ishte mbushur plot me pjesë druri të papunuara, me pjesë metalike, me lima, sharra, gërsërë të mëdha e të vogla, që e ndihmonin në punën e përditshme.

Më kujtohet se kur hyra për herë të parë në

këtë «atelje» e gjeta xha Idrisin që po vendoste në një anë të veçantë punime të tilla. Në të dukej një karrikaturë e Zija pashë Matit, i cili kur erdhi në Gjirokastër nga Janina, dha urdhër që ta hiqnin nga maja e kalasë flamurin tonë. Idrisi «atë sorrë të keqe» e stigmatizon në punimin e tij me këto fjalë therrëse: «Për ne shkaba është shpirti, për tradhtarët është pallë, është mortja e tyre». Pashaj që e kishte parashikuar këtë reagim të Idris Gurit, pat porositur ta arrestonin, por patrioti me një gjest trimëror nuk kishte pranur të dorëzonte koburen.

Kështu, u qëndroi Idris Guri edhe sundimtarëve të tjerë gjatë pushtimeve të mëvonshme. Kështu u përgjigjet ai prefektëve e xhandarëve. Këtë qëndrim burrëror e mbajti ai edhe ditën e Flamurit, për të cilën flet shoku Enver Hoxha në përshëndetjen drejtuar popullit të Gjirokastrës më 24 maj 1977, ku midis të tjerash thotë: «Nuk e mbaj mend vitin por ishte Dita e Flamurit, në kohën e regjimit të Zogut. Me shkollën vajtëm në atë copë vend para prefekturës së vjetër, që të moshuarit e mbajnë mend, atje ku sot është kinemaja. Te porta e madhe e prefekturës, në mes të kollonaven dolën prefekti, komandanti i xhandarmërisë dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Dhe prefekti, sa për të shkuar radhën, filloi të thotë disa pak fjalë për Ditën e Flamurit, pastaj nisi të mburrte Zogun dhe regjimin e tij. Heshtje e madhe në të katër anët, s'kish asnjë duartrokitje, por në këtë çast një zë i fortë u dëgjua nga turma: «Poshtë kusarët!» U bë katrahura, xhandarët vinin rrotull, prefekti dhe autoritetet u futën brenda. Ne, djem-

të e shkollave, prishëm radhën dhe dëgjonim mësuësit të flitnin kokë më kokë: «Oh, më iu lumtë!». Turmë jonë u hap përnjëherë dhe ne pamë të çante përpara, me kokën lart, me dorën në shpatë dhe me sharpën kuqezi hedhur në sup e kraheror, kapiten Idris Guri. Ish ai luftëtar i vjetër dhe shok i Çercizit e i të tjerëve, që bërtiti «poshtë kusarët». Idris Guri zbriti rrugës, qëndroi në një tryezë këmbë mbi këmbë në kafenenë e «huqumetit» dhe porositi një gotë raki. Rreth e rrotull tij u mblodhën burra. Ne, djalëria, kishim zënë rrugën që çonte në klubin e Rilindasve që po inaugurohet sot, dhe qëndronim te shkallët e kovaçit armëndreqës, Aziz Budukut, përpara dyqanit të Zigurit të xha Bañushit dhe pritnim ç'do të ngjiste.

Nuk kaloi shumë kur u dëgjuan këpucët me proka të xhëndarëve me një major në krye të tyre. Majori i Zogut çau me zor turmën, qëndroi përpara xha Idrizit dhe iu drejtua me zë të lartë: «Kapiten Idris Guri, kam urdhër të të arrestoj. Dorëzo shpatën!». Xha Idrisi me mustaqe të thijnjura dhe të dredhura në maja, u çua në këmbë, nxori shpatën dhe bërtiti: «S'e dorëzon kollaj shpatën Idris Guri. Sprapsu, zoti major!». Ne filluam të thoshim: «Mbahu, xha Idris». Gjirokastritët, shokë të moshuar të xha Idrisit, rrethuan majorin e xhëndarmërisë dhe njëri prej tyre i tha me zë të fortë: «Ik u thuaj atyre që të kanë dërguar se nuk arrestohet Idris Guri. Ne po shkoimë të pimë te kafeja e Kuçukut, se kemi festë dhe, po të doni, ejani, por duhet të vini me një taborr xhëndarësh». Majori i xhëndarmërisë u shtang, u tremb,

u mbraps dhe u largua, kurse turma me xha Idrisin në krye, mori rrugën e pazarit dhe ne të rinjtë u shkuam nga pas duke kënduar këngën e Flamurit. Ahmet Zogu ia zhveshi xha Idris Gurit rrobat e oficerit, por ai vazhdoi luftën e tij patriotike me «bastunet» që ju i keni në Muzenë e qytetit.

Të tillë ishin ata trima të pushkës e të pendës që ne përkujtojmë dhe e bëjmë veprën e tyre të pavdekshme. Populli ruan si gjënë më të shtrenjtë kujtimin e përpjekjeve të tyre patriotike dhe Partia jonë e lavdishme e Punës i vuri ata në pedestal».

Veprimtaria antizogiste e Idris Gurit është shumë aktive dhe vazhdoi gjatë. «Ishte qershor i vitit 1936 kur në Gjirokastrë vjen një oficer i lartë, për të mbyllur klubin e qytetit, ku mbledheshim ne të rinjtë. Pasi bëri një mbledhje ai urdhëroi mbylljen e klubit.

Ca ditë më vonë si kundërpërgjigje, Idris Guri, del me një bastun, në të cilin ishin gdhendur fjalët: «Tunduni», ndërsa «bastuni» lëshonte disa tinguj, ishte zëri i një zileje, që ai e bënte të dëgjohej tatëpjetë kalldrëmit të rrugës kryesore të pazarit të Gjirokastrës. Duke u takuar përpara hotelit «Ruajal» me të rinjtë Kadri Baboçi, Siri Shaplllo e të tjerë, patrioti u thotë këtyre: «Shikoni këto gërma: J.L.J.B.» dhe fillon t'ua shpjegojë me ngadalë: — Ai zabiti i madh, që erdhi nga Tirana e ju mblodhi me xhandarë në klub ju tha: — «Ja ligj, ja bajonetë» dhe duke u larguar Idrisi e tundi përsëri shkopin, zilja u dëgjua, po u dëgjua dhe fjala e tij «tunduni»¹⁾.

1) Kujtime nga prof. Zihni Sako.

Me plot besim të forcat përparimtare, te populli liridashës, Idris Guri duke ndjerë thellë shtypjen dhe mizerjen në të cilën jetonte populli ynë, foli nëpërmjet një bastuni tjetër, ku ai kishte gdhendur këto fjalë: «P.N.B.P.D. — J.K.P.T.V. (Po nuk i bëtë popullit derman, ju ka për të vrrarë.) Njëkohësisht Idris Guri në «bastunet» e tij godit veglat e pushtuesit italian, parësinë e agallarët që i shërbenin atij, pseudopatriotët, duke i paraqitur në një punim mjaft interesant.

Ky punim ka dalë në çaste vendimtare të krahinës së Gjirokastrës, kur pushtuesi italian kërkonte të godiste mblëdhjen e gjerë të nëntorit 1918, kur populli i dytetit kërkoi «bashkim mendimesh e veprimi». «Me vlera është veçanërisht testamenti i tij politik që ai na ka lënë, jo të gdhendur në bastun, se mjerimi e pleqëria e bënë që mjeshtri të ndërpriste punën e tij të dashur në dru dhe në metal. Ai shkruan tani me penë për dëshirën e tij të fundit, për qëllimin kryesor të jetës së tij, për shërbimin ndaj Atdheut këto fjalë: «Të kisha vdekur dhe unë si ki (ky) do të jesha i lumtur... meqë nuk vdiqa, tani lus zotin të më lërë deri sa të shoh Shqipërinë 5 ditë, pa le të vdes»...¹⁾

Idris Guri vdiq më 22 maj 1941. Më tepër se katër dekada punoi e veproi ai si patriot konsekuent, duke përdorur edhe shtëpinë, këtë gendër objektësh muzeale propagandistike, edhe dyqanin, këtë vatër librash e gazetash të Rilindjes, romanesh të Gramenos, bazë të shtypit të mërgimit,

1) Fjalë të shkruara pas një-fotografie të shokut të tij, Dipo Çiços, i cili kishte vdekur më 3 shkurt 1939.

si një armë për edukimin patriotik në ditët më të vështira të pushtimit. Njëkohësisht ai bëri, me mënyrën e vet, të njihet lufta e drejtë e popujve të tjerë kundër fashizmit, veçanërisht e popullit spanjoll, duke i kushtuar asaj lufte një «bastun kuptimplotë»¹⁾, që e nderon mendimtarin tonë politik, patriotin, mjeshtrin e punimeve me vlera politike e artistike.

Bastunet që i kemi sot, ai me nr. 46, dhe ai me nr. 34 i janë kushtuar tre vëllezërve Frashëri, kurse për figurat e tyre janë punuar 6 dyer të një godine me disa shkronja, që mjerisht kanë mbetur të padeshifruar gjer më sot. Bastuni nr. 10 mban datën 20 gusht 1938, ai me nr. 38 ka një thirrje ku janë gdhendur fjalët «Durim gjer kur?» e «Ku vemi?», dhe datën 18 shtator 1937. Një bastun, pa numër i kushtohet Hasan Xhikut, kështu dhe shumë bastune të tjera me interes.

Idris Guri ka shkruar në shumë raste për dëshmorët e rënë për liri, si bie fjala për dëshmorin e Luftës së Mashkullorës, Hajredin Tremishtin²⁾, ka hartuar vargje, ka gdhendur edhe bastune nergut për atë. Ka mbetur një pjesë e padëmtuar, e një bastuni kushtuar dëshmorëve, në të cilin pati gdhendur këto fjalë të plota: Vit për vit varret e tyre/ me lule t'i zbukuroni/ këta duhet t'i nderoni/ dhe për herë t'i kujtoni. Ky është një vlerësim për martirët e çështjes së çlirimit dhe një

1) Kujtime nga Rasim Bazo që kujton këtë punim. Idris Guri paraqiste në këtë bastun një dem, që e tërhiqnin dy forca, dy veta me një thikë, kur atë e shpinin për ta therur.

2) «Lidhja orthodhokse» Korçë 16 shenendre 1909, fq. 4


respekt i vazhdueshëm i patriotit Idris Guri për dëshmorët, me të cilët, edhe ai vetë kishte bashkëpunuar.

Studjoja, punishtja, arkiva e tij ka patur një pasuri të madhe në këtë drejtim, në fushën e traditave, por mjerisht pjesa më e madhe u dëmtua, nuk arriti dot, e paprekur gjer në ditët tona. Megjithatë sigurimi i tyre, se shumë prej tyre janë edhe të shpërndara, pasi vetë autori i pat dërguar si kujtim nëpër shokë e miq, të tij, është një detyrë e rëndësishme. Duke punuar në këtë drejtim, duke i mbledhur e duke i studjuar, personaliteti i këtij do të dalë më i gjerë, figura e tij do të pasurohet më tepër, kështu që brezat e ardhshme ta njohin atë më thellë, edhe më mirë. Pak shkrime, më tepër korrespondenca kemi prej tij në shtyp, por megjithatë Idris Guri ka vlera të mëdha, ishte mendimtar i thekur, patriot largpamës, ai mbetet një paraprijës i muzeve tona. Pas Sami Frashërit me shokë, Idris Gurin e shohim të flasë për një «musio»¹⁾ për të pasqyruar këtu materiale dokumentare, në një periudhë kur regjimi antipopullor mundohesh të shuante çdo traditë përparimtare, Idris Guri mbetet kështu një paraprijës muzeumesh dhe mendimtar politik i mprehtë, një patriot që dajti të punojë për afro gjysmë shekulli me traditat më të shëndosha, kronist i dalluar i aspiratave më të mira, jo vetëm të Gjirokastrës, por të mbarë popullit tonë, vepra e të cilit çmohet sot në ditët tona. Kujtohet ai si një luftëtar me armë, që vep-

1) Letër e datës 17 korrik 1939 drejtuar nipit të vet Flamur Gurit.

roi si anëtar i Komitetit patriotik të Gjirokastrës, duke qënë në krah të çetave të para, duke luftuar edhe vetë me armë edhe jashtë Gjirokastrës dhe ish-qarkut të saj.

Luftëtari, patrioti e mendimtari politik mbetën një dhe të pandarë. Si i tillë, Idris Guri zë një vend nderi për periudhën ku ai jetoi e punoi.



Thoma Papapano

THOMA PAPAPANO

Ka lindur në Gjirokastrë më 17 mars 1884. Së bashku me Andrea Konomin, Ilias Hoxhën e me të tjerë punoi parreshtur si mësues, ndërsa për pesë vjet me radhë (1908-1913) ishte edhe sekretar i Klubit «Drita» të Gjirokastrës.

Duke kujtuar punën e gjatë e të frutëshme të këtij mësuesi, shoku Enver thotë: «Furtuna ka luan mbi Atdheun që nga ajo kohë kur ju, Basho Thoma, hapët shkollën e parë shqipe në Gjirokastrë, dhe unë hapa për herë të parë sytë në jetë»¹).

Që në moshë të re si mësues i gjuhës amtare, Thoma Papapanoja u rrethua me dashuri e me respekt nga patriotët dhe punonjësit e Gjirokastrës. U çmua për «ndritimin e mendjes së tërë çunave të pritmit (t'ardhmes) të Shqipërisë»²). Ishte një mësues nga i cili djalëria e Gjirokastrës «shpreonte shumë gjëra të mira e mësim të bukura», për të cilat ai nuk u kursye. I papërtuar punoi përmbi gjysmë shekulli në fushën e arsimit dhe të kulturës. Mendimet pedagogjike përparimtare i shikojmë në disa punime të lëna prej tij, shkruar me

1) Enver Hoxha: Vepra, Vëll. 23, fq. 415

2) Fondi i QKMGJ.

atë kaligrafinë shembullore, që nuk e humbi as në castet e fundit të jetës së tij. Janë pjesë të shkurtëra, por me interes.

Në shkrimin e titulluar «Shqipëria» Thoma Papapanoja tregon se «sikurse një djalë që ka një atdhe të mirë e të nderuar nga gjithë bota, nuk duhet vetëm të mburret, por ka edhe detyra në punërat e tij të tregojë që meriton fisin e vet, kështu dhe për trimërinë e stërgjyshëve nuk duhet vetëm të mburremi. Duhet të kujtojmë që ato trimëri na ngarkojnë detyrën të duhemi e të tregohemi stërnipër të vërtetë e të merituarshëm, duke punuar dhe punë të lavdëruar për të mos u turpëruar dhe nderuar zërin e mirë dhe famën që nga ata kemi trashëguar»¹).

Papapanoja ishte mësuesi që ngjalli dhe ushqeu traditat më të mira. Megjithëse Gjirokastra dhe Vlora ishin atëherë nën pushtimin e parë italian (1916-1920) ai paraqet të gjallë dashurinë për traditat më të shëndosha, të kultivojë këto, në një kohë kur agjentët italianë mundoheshin për italianizimin e vendit, duke patur edhe ndihmën e disa mësuesve italianë që punonin në fshatra shqiptare.

Papapanoja me shokë i kundërvihet, në shkollë, kësaj veprimtarie. Ai kërkonte që «çunat, që ndë vogëli të bëhen të ditur, që të nderojnë vetehe, Atdheun dhe të jëtonin me nder e me të mira ndë këtë jetë».

1) Të gjitha referencat janë shkrime që Thoma Papapano përdorte si pjesë antologjike dhe zhvilloheshin në orët e mësimin në kohën kur mungonin tekstet e antologjisë. (Fondi QKMGJ).

Mësuesi Papapano i këndon lavdisë, trimërisë, historisë së vendit, duke shkruar se «Atdheu nuk është vetëm vendi ku u lindën, ku prehen të dashurit tonë dhe me të cilët na lidhin më të shenjtat dhe më fisnikët dashuri gjaku».

Mësuesi ngre në këto shkrime dashurinë për «vendi, pjellor me shumë se çdo tjetër dhe fort i bukur». Prej çunavet ai kërkon t'i shtojnë «pasurinë, dhe forcën Atdheut, duke kërkuar nga çdo djalë të derdhë, kur është nevoja, edhe gjakun për të».

Mendimet patriotike e pedagogjike i tregon nëpërmjet «katërshoreve» që nxënësit e tij i ruajnë akoma në bibliotekat e tyre. Duke ushqyer dashurinë për patriotët, Papapanoja shkruan në fletore: «Mendimet e punërat e njerëzve me karakter, veprat, e atdhetarëvet mbeten ndë kujtim dhe zëri i tyre arrin në veshët tonë i ardhur tej nga varret e tyre».

Në këtë pjesë antologjie, Papapanoja shfaq mendimin e drejtë se «emri e kujtimi i njerëzve të mëdhenj të një kombi janë nderi dhe pasuria e vërtetë e tij, një pasuri që asnjë prishje nuk mund ta humbasë».

Duke dashur të edukojë tek nxënësit e vet guximin, kurajon, etj., mësuesi shkruan: «Si komp lypset kurrë të mos ndjejmë dëshpërim, po ta kemi ngjeshur zemrën me kurajo, me guxim, e me shpresë dhe me virtytet që na i kanë lënë të parët për trashëgim. Ata me karakterin e tyre të fortë e trim mundën të shpëtojnë kombësinë, gjuhën, zakonet e vetiat nga katastrofa e rrebeshe, q'i kanë ardhur mbi krye Shqipërisë».

Në mësimin me titull «Detyrat», Papapanoja pasi shkruan për detyrat që ka secili ndaj vetvetes, trupit, të afërmeve, tregon se «secili duhet të mbahet i pastër, të jetë i përkorë në të ngrënë e në të pirë dhe në çdo anë tjetër». Ai shkruante se «duhet të stërvitej trupi me anë të gjimnastikës, të luftoheshin veset e zakonet e këqia». Kërkonte lexime veprash të bukura dhe njëkohësisht shfaq mendimin se «njeriu lypset të tregohet i zoti e të mos kursehet të bëjë thërror atë që ka me të dashur e me të shtrenjtë».

Pedagogu Papapano mendon që njeriu të punojë për të mirën e vet dhe për të mirën e të tjerëve. Ai shkruante: «Kur njeriu kupëton që një gjë lypset ta bëjë për të mirën e vet e të tjerëve, duhet të ecij drejt qëllimit, duke mos peshuar pengimet e rreziqet po vetëm të mendojë që e ka detyrë ta bëjë dhe ta bëjë mir' e të sosurë», Papapanua mendonte se ndjenja e detyrës duhet të rrënjoset në çdo rast dhe sidomos tek të rinjtë.

Ai e çmonte njeriun punëtor e të ndershëm se ky shkruante Papapanoja «është gjithnjë i vërtetë, flet e punon përhera të drejtën dhe kurrë nuk flet rrem». Duke dashur të forcojë mendimet e veta, këtë pjesë mësimi e përfundon me shprehjen: «E vërteta dhe e drejta është ajo që stolis fjalët e njeriut».

Ishte i apasionuar pas shëtitjeve dhe eskursioneve me qëllim edukativ dhe i këshillonte nxënësit të njihnin vendin e pasuritë e mbitokës dhe nëntokës, të njiheshin me fshatarët, të jetonin në mes bukurive të rralla të natyrës shqiptare.

Ai ushqente tek fëmijët dashurinë për At-

dheun, njëkohësisht luftonte paragjykimet fetare, mendimet idealiste, demagogjinë e klerikëve, të institucioneve fetare, duke i edukuar nxënësit e vet me dashurinë për «fuqinë e madhe të natyrës».

Në «antologjinë e vet» hartuar prej tij Papapanoja kishte radhitur poezi të Asdrenit. Nuk mungojnë pjesë si «Dallëndyshet», që ai i ka përdorur edhe si diktat në klasë, e ku duket dora e tij, që ka korrigjuar disa gabime ortografike.

Krahas lëndëve humanitare, mësuesi mundohet të japë disa njohuri të vlefshme mbi natyrën e vet, që të luftojë me anën e tyre mendimet e ndryshkura të fesë dhe të shkollës së vjetër.

Nga ana tjetër Papapanoja u bë njëkohësisht një mësues edhe për mësuesit e rinj të kohës. Këta ai u mundua t'i afrojë, të organizojë biseda shkencore e historike, të çelë për ta kurse kualifikimi, për t'i përgatitur pak a shumë që të punojnë drejt e mirë në fushën e arsimit.

Si mësues i një shkolle laike, popullore, kombëtare Papapanoja ka merita të veçanta. Për nxënësit e tij ai nuk kurseu asgjë. Ai u përpoq që ata t'i pajiste në njohuritë rreth gjuhës, gramatikës mësimdhënies në përgjithësi, por me sa mundej dhe me problemet shkencore, historike, shoqërore, duke u dalluar tërë jetën si një studiues i palodhur.

Papapanoja qysh kur ishte nxënës në Stamboll u ushqye me mendimet përparimtare të patriotëve tanë, nga të cilët mësoi gjuhën amtare. Rrethi familjar, sidomos i ati që dallohej në mes të kolonive shqiptare në Sofje, dhe pastaj në Bukuresht, e bën djaloshin Papapano të ndjekë rrugën e rilindasve. I ati i tij bashkëpunonte me patriotët e

Bukureshtit, me Nikolla Naçon e të tjerë, punon-
te me guxim për çlirimin e vendit.

Ai është autor i një abetareje me titullin «Shkëndilat e para»¹⁾ ku veç disa të dhënave për gramatikë, Papapanoja na jep pjesë leximi të shkruara kryesisht me qëllime patriotike. Dashuria për shkollën dhe për nxënësit shfaqet me shumë pasion nëpër faqet e librit «Shkëndilat e para», aty autori tregon dashurinë që ka për natyrën shqiptare, për të mirat e këtij vendi.

Pedagogu Papapano që nuk u nda kurrë nga nxënësit, të cilët i konsideronte si fëmijët e vet, gjallërohet sa herë që i shikon nxënësit e studentët e vet të shikojnë përpara dhe me shumë dashuri ai shkruan në këtë abetare: «Koha e pushimeve (verore) do t'u japë fuqi. Do të gëzoni erën e lirë të fushave, që do t'ju shëndoshë trupin tuaj. Zbavituni e dëfreni, po mos harroni dhe mësimin. Fjalini gjysmë ore ditën. Kështu do të kujtoni gjërat e nevojshme e të dobishme që keni nxënë tërë vitin. Shikoni pra dhe mos harroni porositë e mia. Në vjeshtë do të piqemi, do t'ju gjej më të rritur e më të shëndoshë».

Papapanoja donte e kërkonte që nxënësi të mos ndahej nga mësuesi, të mos ndahej nga librat, nga leximet. Ai ushqen me ngrohtësi ndjenjën e respektit më të madh ndaj mësuesit dhe prandaj shkruan në «Shkëndilat e para» edhe këto: «Për mua mësuesi është si një at i dytë dhe prandaj e dua me gjithë zemër. I bindem e nderoj, i jam mirënjohës». Mësuesi i vitit 1908 punoi me këtë

1) Vlorë, më 1919, fq. 64; origjinali ruhet në Gjirokastrë.

16



Abetare
Papapanos

l b

bi bo ba bu be bē by
ib ob ab ub eb eb yb

bo-ta, be-li, el-bi, bu ti, la bi,
u-bē el-bi: bi-ni u-jē e pi-ni:

bie de-le-ja në u-jē: bot u-ji.

byl-bi-ti në mal: ba-ba-i na do.

bo-ti me u-jē: bē-ni dy to-pa.

Abetare e Thoma Papapanos

pasion e me këtë vullnet edhe në moshën më të madhe, punoi për afro gjashtë dekada dhe këtë mësues të popullit nuk do ta harrojnë asnjëherë të gjithë ata që e patën pedagog, po nuk do ta harrojnë asnjëherë edhe të gjithë ata që do të lexojnë jetën dhe veprën e tij në shërbim të arsimit kombëtar.

Ky patriot konsekuent dhe dashamirës i një shkolle të përparuar në Shqipëri mbetet figurë e një rilindasi të shquar.

Thoma Papapanoja ishte i ndikuar veçanërisht nga shkrimet e Jani Vruhos, me të cilin pati edhe letërshtëmbim. Aty shohim goditjet kundër klerikëve antikombëtar. Në letrat e dërguara Jani Vruhos, Papapanoja çfaqet një patriot që godit shkollat me karakter fetar, të cilat, siç shkruante ai, «kanë verbuar gjer sot fëmijët e Shqipërisë»¹).

Synimi i Papapanos ishte shkolla laike, ky ishte laitmotivi i mësuesit patriot. Ai bënte përpjekje në tërë qarkun e Gjirokastrës për të larguar nga shkolla klerikët. Kërkonte që të ardhurat e kishës dhe të manastireve të përdoshin nga shkollat, si ajo e Labovës së Libohovës, etj. dhe «rroga e mësuesit të paguhej nga të ardhurat e fshatarit»²). Kjo kërkesë e përsëritur prej mësuesit patriot shkaktonte protesta nga ana e klerikëve të lartë myslimanë e të krishterë të Gjirokastrës, të cilët shikonin rrezikun e pakësimit të të ardhurave të tyre, të rrëmbyera nga populli fukara. Kërkonte gjithashtu me

1) QKMGJ. Fondi i Papapanos. Dosja nr. 4.

2) «Papapanua tregonte». Dorëshkrim i pabotuar (Epistolari).

këmbëngulje që disa arsimtarë që jepnin mësimin e fesë e që mbanin petka fetare të mos lejoheshin të hynin me atë veshje. Mësuesi kalonte pastaj edhe më tutje, duke kërkuar «largimin e hoxhallarëve e të priftërinjve nga shkollat, pasi mësuesit në krahasim me priftërinjtë dhe me hoxhallarët janë të pajisur me cilësi më të larta në pikëpamje diturie e ndjenjash kombëtare»¹).

Këto pikëpamje përparimtare të Thoma Papapanos shqetësuan, jo vetëm klerikët, por edhe autoritetet qeveritare, bile dhe Zogun. Papapanoja bëri përpjekje dhe pakësoi orët e mësimi të fesë në shkollën fillore në një periudhë kur kryemyftiu i përgjithshëm në Tiranë, ankohej në organet qeveritare se mësimi i fesë bëhej përmendsh, jo në bazë të tekstit, duke kërkuar që «kurani të mësohej nga librat ndë gjuhë arabishte»²).

Papapanoja së bashku me Ilia Dile Sheperin, bashkëpunëtor i tij në lëmin e arsimit, e të kulturës, i kundërvihen rrymës fetare në shkolla. Papapanoja shfaq mendimin «se po të besohet mësimi i fëmijëve të fesë muhamedane ndër hoxhë, duhet që ai i fesë së krishtere të besohet ndër priftër...» Por nga ana tjetër ai është i mendimit dhe për këtë ai ngul këmbë se «në këtë mënyrë nuk do të kemi shkolla kombëtare»³).

Pastaj ai argumenton historikisht se «zhvillimi

1) AQRPSSH. Fondi i Drejtorisë Arsimit Gjirokastrë, nr. prot. 398, dt. 23.3.1921. Shiko edhe raportin e Drejtorisë Arsimit Gjirokastrë nr. 466, dt. 4 nëntor 1920.

2) AQRPSSH. Fondi i Sheriatit nr. 78, datë 29.3.1920.

3) AQRPSSH. Drejtorja e Arsimit Gjirokastrë Nr. 466, dt. 4.XI.1920, kutia nr. 2.

i mësimimit të fesë në shkollat shqiptare ngjan me sistemin që përdorën turqit dhe grekët në të kaluarën në Shqipëri, me qëllim që të sillnin përçarjen në mes të dy elementëve»¹).

Ai ngre problemin e së kaluarës së hidhur, atë të ndarjes në mësim të nxënësve, ndërsa të krishterët ndahen veç, edhe nxënësit myslimanë e bëjnë mësimin e fesë veç. Prandaj Papapanoja ishte i mendimit se kjo nuk duhet të ndodhte. Për këtë problem ai shkruante: «Sa mallëngjim, sa gjë e keqe është kur shikon njeriu që nxënësit prej një gjaku, dhe që kanë një Atdhe, ndahen në mësimin e fesë, duke iu bërë këtyre mendja një çorbë arapi»²).

Duke u ndodhur para presionit të elementit konservator e reaksionar të qeverisë së kohës, përpara prefektëve e autoriteteve të tjera, Papapanoja shfaq mendimin që «fundi fundit mësimi i fesë të mbahet sa për formë»³).

Me shprehjen «mësuesit tanë», Papapanoja kuptonte mësuesit që ishin kundërshtarë të klerikëve, të politikës arsimore klerikale, që ndiqej nga qeveria. Papapanoja e bënte këtë politikë për të afruar elementin e lëkundur, që nuk ishte shpëputur akoma nga feja, të cilin shkolla, pa mësimin e fesë i dukej si një humbje e madhe, si një përmbysje e shkollës.

Papapanoja dallohet nga ana tjetër për një shkollë mikste në Gjirokastër dhe në mbarë ven-

1) «Fondi QKM, Gjirokastër»

2) AQRSSH Drejt. Arsimit Gjirokastër nr. 337, dt. 8.III.1921.

3) Po aty.

din. I mbështetur nga shokë të tij, ai vijoi pa ndërprerë të punonte në këtë drejtim. Kundër tij u ngritën tregtarë të mëdhenj si Xhevdet Selfo, që kundërshtuan shembullin e arsimitdashësit dhe patriotit të vjetër Hysen Hoxha me shokë për shkolla mikste¹⁾. Po kështu u kundërshtua ai nga pseudo-juristë, që protestuan për këtë gjë deri në Ministrinë e Arsimit, duke shkruar «se Papapanoja jep urdhëra mbi ndjekjen e shkollës nga vajzat, pa u mbështetur mbi frymën e zakonit të vendit dhe se ky urdhëron vajza 11 e 12 vjeçare të mësojnë tok me djem të kësaj moshë dhe me më të mëdhenj»²⁾.

Elementi i krymbur dhe reaksionar e godet Papapanon, duke shtruar çështjen se nuk mund të lejohet një vajzë 12 vjeçare të mësojë bashkë me një djalë, kur vajzat në këtë kohë janë të vluara (të fejuara). Një jurist me mendimë anadollake arrin ta cilësojë Papapanon «kasaballi» (qytetar), duke e akuzuar se «nuk di zakonet e vendit, zakonet e fshatit, duke shtuar se ky jep urdhëra që nuk mund të zbatohen kurrë»³⁾.

Materialet dokumentare të kohës tregojnë qartë edhe qëndrimin e Ministrisë së Arsimit, e cila bashkohej me këta elementë fanatikë e të prapambetur, duke porositur «se duhet të ruhet zakoni të vendit»⁴⁾, që nuk ishte veçse zakoni i prapambetjes

1) Fondi i Muzeut Historik të Gjirokastrës, Historiku i lagjes Manalat.

2) AQRPSSH: Fondi Ministria Ars. Dosja nr. 61, Berat, 25.1.1923.

3) Po aty.

4) AQRPSSH: Fondi Ministria Arsimit. Dosja nr. 61. 29.1. 1923.

shekullore, që u ruajt dhe u mbrojt edhe nga regjimi antipopullor i Zogut.

Puna e mësuesit patriot shikohet me sy të keq nga vetë ministri i Brendshëm Ahmet Zogu, i cili ishte kundërshtar i tërbuar i arsimit laik dhe miks. Vep-rintarinë e Papapanos ai e cilëson të rrezikshme, duke shtuar: «Informacionet që kemi na sigurojnë se inspektor z. Thoma Papapanoja me të vërtetë asht tue ba propagandë të damshme». Ahmet Zogu kërkonte gjithashtu transferimin e mësuesit nga Gjirokastra¹⁾.

Ministria e P. të Mbrendëshme ngulmon për shpërnguljen e Papapanos²⁾ nga detyra që kishte si inspektor arsimit në Gjirokastrë. Në këtë dokument shikojmë se kërkohet transferimi i tij dhe i një inspektori tjetër për «në veri» të Shqipërisë. Por as këto urdhra kategorike të Ahmet Zogut³⁾ nuk patën efektin e duhur, pasi qytetarët patriotë të Gjirokastrës, të cilët e kishin Papapanon mësues të fëmijve të tyre për vjete me radhë, protestuan për largimin e mësuesit, që tok me atin e tij gëzonin një simpati e respekt të veçantë në mbarë vendin tonë; babë e bir, Papapano-prifti (plaku) dhe mësuesi i shkollës «Liria» të vitit 1908.

Për të siguruar elementë që të punonin në fushën e arsimit, ai bëri përpjekje të njëpasnjëshme, duke përkrahur vajza të reja e me pasion që kërkonin të bëheshin mësuese në shkollat fillore

1) AQRPSSH. Fondi Ministria e P. të Mbrendëshme, nr. 567/1 Res datë 1 maj 1923.

2) Po aty, nr. 34. Res. datë 21.4.1923.

3) Po aty. Zyra sekrete nr. prot. 567/11. Res. datë 3.V.1923.

të qytetit e të fshatit. I mbështetur nga lëvizja demokratike e viteve 1921-24, nga puna e madhe e bërë nga Avni Rustemi, nëpërmjet «Lidhjes së mësuesve» të Gjirokastrës, Papapanoja dha kontributin e vet për zhvillimin e arsimit, në Kuç, Muzinë, Pecë dhe në fshatra të Delvinës.

Duke konstatuar se në krahinat e Gjirokastrës kishte mësues të zellshëm, të vullnetshëm, por që u mungonte një arsim i shëndoshë Papapanoja kërkon që këta të ndiqnin shkollën normale në Elbasan, për t'u bërë kështu luftëtarë aktivë për zhdukjen e analfabetizmit dhe të prapambetjes.

Rëndësi të veçantë u dha ai kurseve të kualifikimit para dhe pas vitit 1920. Në këto kurse afroi elementin e ri, gjer te tipografët, që punonin në shtypshkronjat e qytetit, të cilët me përkrahjen e tij u bënë mësues nëpër fshatra, në kohën kur zyra e arsimit të qarkut mbeti në duart e patriotëve me Papapanon në krye. (korrik 1920)¹.

Duke i hedhur një sy autobiografisë së shkruar nga Thoma Papapanoja del qartë se ai gjithë jetën ja kushtoi shkollës shqipe, dhe si një mësues patriot, progresist ai nuk pushoi së punuari për mëmëdhenë.

Duke kujtuar ditët e gushtit të vitit 1913 kur Thoma Papapanoja si anëtar i delegacionit të Qeverisë së Ismail Qemalit, që do të shkonte në disa vende të Evropës, për të zhvilluar bisedime diplomatike rreth kufijve të Shqipërisë, ai shkruan se «në mëbrëmjen e 13 gushtit 1913 në Vlorë shpër-

1) AQRPSSH. Fondi i Ministrisë së Arsimit, nr. 147, dt. 24.III.1920. Dosja nr. 22.

theu një manifestim i fuqishëm popullor me këngë e valle»¹⁾.

Një komision prej pesë a gjashtë vetash do të shkonte në Romë, Vienë, Berlin, Peterburg, Paris e Londër, për të biseduar dhe për të mbrojtur të drejtat etnike të Gjirokastrës, me rrethet e saj. Në këtë mision Qeveria e Vlorës vendosi të shkonin dhe dy përfaqësuesit e saj nga Gjirokastra.

«Përpara se të niseshim për në Itali, shkruan Papapanoja në kujtimet e tij, i bëmë një vizitë kryetarit të Qeverisë Provizore të Shqipërisë, Ismail Qemalit, për t'i kërkuar këshilla dhe porosira. Në Bari u bashkuam edhe me patriotin Lame Petri nga Saraqinishta e Lunxherisë, të cilin e kishim lajmëruar nga Vlora për këtë komision. Në Romë arritëm më 15 gusht 1913. Kishim përgatitur edhe një hartë etnografike të qarkut të Gjirokastrës si dhe një thirrje drejtuar popullit italian ku kërkonim, që ai të ngrinte zërin për të mbrojtur të drejtat etnike të popullit shqiptar. Kërkuam të priteshim në audiencë nga ministri i Jashtëm i Italisë, por ai nuk ndodhej dhe na priti një funksionar i lartë. Ky funksionar pasi i dorëzuan hartën etnografike dhe materialet e tjera, këmbë mbi këmbë na dëgjonte, dhe duke fërkuar duart, herë pas here thoshte vetëm një fjalë: «vediamo» (d.m.th. të shohim)²⁾.

Papapanoja tregon pastaj në kujtimet e veta sesi largohen nga Italia pa marrë asnjë përfundim pozitiv, flet për vajtjen në Vienë dhe për prit-

1) Nga dorëshkrimi «Papapano tregonte».

2) Po aty.

jen më 21 gusht 1913 nga ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, dhe për takimet e tjera që bënë me qeveritë e këtyre shteteve imperialiste, që nuk donin kursesi të mirën e Shqipërisë, por shikonin vetëm interesat e tyre grabitqare, dhe se të drejtat e kombit shqiptar do të fitoheshin vetëm me luftë, me gjak e me sakrifica.

Papapanoja ishte ndër të parët që mori pjesë në demonstratat e Vlorës së bashku me Polo Meksin, Namik Delvinën, Spiro Kolekën dhe demonstrues të tjerë, të cilët më 5 nëntor 1913 demonstruan nëpër rrugët e Vlorës dhe para banesave të delegatëve të huaj të Komisionit Ndërkombëtar për çështjen e kufijve.

Ish-nxënësve të tij u kujtohen shkronjat e bardha të shkruara aq bukur në dërrasë të zezë nga Papapanoja, kujdesi i veçantë i tij për të mos gabuar në shkrimin e gjuhës amtare. Ai i këshillonte vazhdimisht nxënësit që të mos e sakatojnë shkronjën shqipe, fjalën shqipe, për të cilat ishte derdhur gjak me armiq të.

Nga ana tjetër vetë temat e hartimeve që jepte Mësuesi i Popullit Thoma Papapano janë një provë tjetër e kujdesit të veçantë që tregonte ai për edukimin patriotik të nxënësve.

Pa u ndalur këtu në punën me hartimet shkollore të Papapanos, që ai i përdorte si lloj problemesh matematike, me qëllim që nxënësit të stërviteshin në shkrimin shqip, do të shënoj disa nga titujt e këtyre hartimeve. Për të ushqyer vullnetin për punë, për të luftuar plogështinë, ai u jepte nxënësve këto tema: «S'mundem», është gjithnjë fjala me të cilën duan të shkarkohen njerëzit

pa vullnet dhe të plogët». Duke dashur të luftojë zvarritjen e kryerjes së detyrës, ai jepte temën: «Detyrat e mia unë i di, po sa herë i harroj».

U kujtohen nxënësve të tij vargjet popullore, që ai i përdorte shpesh për të ngjallur dashurinë për folklorin, orët e gramatikës shqipe, mësimi rreth përemrave etj. Duke kujtuar këtë punë, vetë shoku Enver, duke hyrë pas shumë vjetëve në një orë mësimi të mësuesit të tij të vjetër, pasi e përqafoi, i thotë:

«Basho, tashti do ulem edhe njëherë në bangën e klasës sime, se më ka marrë malli... edhe ju do të na flisni një çikë për përemrat pronorë, që i donit aq shumë...».

I ndodhur përpara shokut Enver, Basho Thoma Papapanoja, i emocionuar, bën disa lëvizje me regjistër në dorë si i zënë ngushtë, pastaj po me buzë në gas, thotë:

«Tashti, shoku Enver, ju u bëtë mësuesi ynë dhe imi njëkohësisht, i gjithë popullit»¹⁾.

I tillë ishte mësuesi Thoma Papapano, qysh nga viti 1908 e deri sa vdiq në një ditë shtatori të vitit 1970. Pasioni i tij më i madh ishte të shërbente në arsim, të punonte për edukimin patriotik të nxënësve. Kaloi një jetë të tërë me shkollën, me hallet e saj, nuk u nda kurrë nga problemet e shkollës.

Mësuesi i shkollës së vogël «Liria» që preferoi të mbahesh me ndihmat e klubit «Drita», që për-buzi shpërblime të mëdha e rroga, vijoi edhe në

1) Mësuesi, 3 janar 1970, faqe 3.

shkollën e mesme të Gjirokastrës të punonte me atë afsh patriotik, po me atë vullnet e dashuri.

Puria e tij shembullore në edukimin patriotik ishte a njohur kudo në Shqipëri, aq sa në disa momente të vështira të shkollës sonë kombëtare, ai u kërkua nga mësuesit patriotë të Shkodrës që të shkonte edhe atje për të forcuar pozitën e gjimnazit, që luftohej nga klerikët, nga armiqtë e shkollës mikste, e shkollës me frymë laike.

Duke prekur punën e bërë me anën e abetarës, në letrën e fundit të tij, ai shkruan: «Nuk di të kem nguruar ndonjëherë midis detyrës dhe interesit, por edhe nuk mund të mohoj që gjatë punës sime 58-vjeçare për Shqipëri dhe arsime kombëtare të mos kam bërë dhe ndonjë gabim, po pa dashje dhe kur e kam kuptuar, e kam pranuar dhe sakaq e kam ndrequr»¹⁾.

I dalluar për modestinë e tij tërë jetën, modest u tregua ai edhe në kujtimet e pakëta që shkroi, pa pretendime, i thjeshtë siç ishte tërë jetën e tij.

Si mësues në klasë ai qe i përpiktë. Ishte shembullor në sjellje e këmbëngulës për të mësuar sa më mirë gjuhën amtare, për ta shkruar sa më bukur shkronjën shqipe, duke i dhënë rëndësi të veçantë edhe kaligrafisë. Në këtë pikë ai ishte vetë shembull me bukurshkrimin e tij.

Gjatë gjithë jetës, Papapanoja edhe nga paraqitja e jashtme ishte shembull. I pastër, i veshur thjesht, në mënyrë të tillë që shumë nga nxënësit kishin dëshirë ta imitonin. Ai ngjitej e zbriste

1) QKMGJ.

kalldrëmeve të qytetit muze, i nderuar nga qytetarët, punëtorët, nga fshatarët, nga mbarë qyteti, djemtë e vajzat e të cilit ai i pati mësuar dhe edukuar.

Për merita të larta në detyrën e tij fisnike të Komisarit të dritës, Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka dhënë Thoma Papapanos titullin e lartë të nderit: «Mësues i Popullit».

E mbylli jetën i gëzuar, duke i parë të realizuara ëndrrat e tij për një shkollë të re, shkollë të ngritur nga Partia, që e bëri njëkohësisht At-dheun një kantier pune e mësimi.

«Sa kam rrojtur — shkruante Papapanoja pak kohë para se të mbyllte sytë, — më sa kam mundur, kam punuar dhe kam luftuar, po jo me ndonjë pallë të çeliktë. Palla ime ka qenë abetarja e gjuhës shqipe, tehun të së cilës s'ka kush t'i mohojë fuqinë për të luftuar...»¹⁾

1) QKMGJ.

TREGUESI I LËNDES

	Faqe
Parathënie	3
Klubet — vatra të zjarra patriotike	7
Mësimorja shqipe «Liria»	17
Mësimorja shqipe e Labovës së Madhe	32
Mësimore të tjera shqipe	39
Shoqëria «Kandile»	49
Shoqëria «Vëllezëria»	51
Shoqëria «Drita» e Gjirokastrës	57
Shoqëria e grave gjirokastrite	60
Shoqëria teatrale	62
Klubi i opingarëve «Shpresa» dhe gazeta «Drita»	64
Shoqëria «Studenti»	71
Shoqëria «Shkëndia» në Libohovë	84
«Lidhja e punëtorëve» në Gjirokastrë	87
Lidhjet në ish-qarkun e Gjirokastrës	89
«Lidhja e grave të Gjirokastrës»	92
«Lidhja e mësuesve»	102
Rrethet letrare	105
Shoqëria «Kasa e kursimit për bujqit»	107
Shoqëria «Njeriu i ri» në Përmet	108